



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“ Teknikë e lartë dentare ”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “AKADEMIA IVODENT”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Nazmi Koçi

Dr. Shk. Mj. Elona Kongo

Janar 2020

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Ky raport vlerësimi i jashtëm u hartua si pjesë e procedurës së akreditimit periodik të Akademisë Ivodent. AI ka bërë kërkesë pranë ASCAL në datë 25.11.2018 për nisjen e procedurës së akreditimit periodik duke informuar gjithashtu se kishte bërë kërkesë pranë MASR për të mundësuar reduktim të Personelit Akademik bazuar në numrin e vogël të studentëve në tre vitet e fundit akademike. Akademia Ivodent ka realizuar së fundmi një marrëveshje me Nr 5969 prot, datë 06.06.2019 me qëllim përcaktimin e numrit të personelit akademik, me kohë të plotë, në njësitë bazë të kësaj Akademie.

Akademia Ivodent është emërtimi pas riorganizimit të Institucionit Plotësues Parauniversitar Privat "Ivoclar Vivadent & Partners". Ka nisur aktivitetin në vitin 2004 me një kurs dyvjeçar për përgatitjen e teknikëve dentare. Akreditimi i parë Institucional dhe i programit që aktualisht ofron është realizuar me Urdhërin nr 328, datë 15.08.2013 të MASR për një periudhë 6 vjeçare.

Në datë 06.08.2014 pezullohet veprimtaria me VKM Nr 540 për arësye ligjore. Ky pezullim u hoq me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 114 datë 15.03.2016 dhe Institucioni rifilloi aktivitetin duke u riorganizuar si Akademia Ivodent me strukturë dy departamente dhe një Qëndër: ai i Protetikës që ofron programin e vetëm të studimit Bachelor në "Teknikë e lartë dentare", Departamenti i Ortodoncisë dhe Qendra e Studimit të Teknikave.

Me Urdhër MAS Nr. 598, date 21.12.2016, miratohet Statuti i IAL në përputhje me LAL 80/2015 (sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr. 5, datë 02.09.2016). Në këtë Urdhër të MAS, IAL kalon nga statusi "Kolegj Profesional" në "Akademi".

IAL ka kaluar një proces vlerësimi dhe akreditimi të programit të studimit si dhe të akreditimit institucional, përpara pezullimit të veprimtarisë së tij. Me UMASH Nr. 328, datë 15.08.2013 akreditohet Institucioni "Kolegji Profesional Privat "Ivoclar Vivadent & Partners" dhe programi i ciklit të parë të studimit "Teknik i lartë dentar", në përputhje me Vendim Nr. 504, datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit. Kohëzgjatja e akreditimit, në bazë të legjislacionit të kohës në fuqi, ishte 6 vite, me afat vlefshmërie deri në 14.08.2019.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua nga ASCAL dhe ekspertët e vlerësimit të jashtëm Prof As. Nazmi Koçi dhe Dr Elona Kongo. Për realizimin e procesit krahas analizimit të DVV të vënë në dispozicion nga Agjencia nëpërmjet aksesit në sistemin elektronik, u realizua dhe vizita në Institucion sipas agjendës së përgatitur dhe dakordësuar me AI. Vizita filloi në datë 7/11/2019. Në Institucion na u paraqit një axhendë e përgatitur nga AI pa shumë ndryshime rrënjësore nga ajo e parashikuar, por në ndryshime në titullarët e Fakultetit të Teknikave Dentare dhe të Përgjegjësit të Departamentit të Protetikës. Takimi i parë i planifikuar të zhvillohej me Dekanen dhe Përgjegjës të Departamentit të Protetikës u zhvillua me Dr E.M në rolin e Dekanit të komanduar, pasi Dekania ishte jashtë vendit, konkretisht në Gjermani për trajnim në kuadër të vitit sabbatik. Drejtuesi i Departamentit të Protetikës ishte larguar jashtë vendit për arsye shëndetësore dhe u zëvendësua në takim nga Dr D. K, PAE pranë AI. Koordinatorës Institucionale ju bë e ditur që pas mbarimit të vizitës së parë të planifikuar që dokumentacioni që do të kërkonte GVJ për vizitën dy ditore të planifikuar, duhej të ngarkohej në sistemin AMS maksimumi brenda tre ditëve. Dokumentacioni i kërkuar nga GVJ ishte dokumentacion, që ashtu siç edhe e pohuan edhe drejtuesit e Fakultetit dhe të Departamentit, ishte ekzistues dhe do vihej në dispozicion brenda afatit. GVJ shprehet se dokumentacioni plotësues i kërkuar gjatë kryerjes së vizitës në AI, nuk u ngarkua i plotë dhe në kohën e duhur në sistem dhe për këtë arsye, disa prej përgjigjeve të kritereve sipas fushave, janë pa përgjigjen apo shtjellimin e duhur nga GVJ. GVJ gjithashtu thekson se pyetjes drejtuar drejtuesve të Institucionit (Dekanit të ngarkuar dhe zëvendësueses së Shefit të Departamentit) se si e konsideronin akreditimin e këtij programi, për herë të parë apo periodik, nuk ju dha përgjigje.

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi është Specialistia e ASCAL, Znj S. Kromidha. Më datë 18 Dhjetor 2019 nëpërmjet sistemit AMS por edhe me shkresë zyrtare është dërguar në AI Draft RVJ. Më datë 30 Dhjetor 2019 ka ardhë përgjigja nga AI në lidhje me Draft RVJ. Në këtë përgjigje Institucioni paraqiste disa komente. Këto komente Ju dërgohen me email GVJ, të cilët i panë me kujdes dhe kanë përgatitur edhe një MEMO. GVJ nuk ndryshon pothuajse asgjë nga Draft RVJ dhe për këtë jep edhe argumentin në MEMO. Ky material ndodhet në fund të Raportit të vlerësimit.

Për sa më sipër, Draft RVJ kthehet në Raport përfundimtar dhe firmoset nga GVJ.



Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Teknikë e lartë dentare”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i vetëm i studimit i ofruar nga AI synon përgatitjen e teknikëve të lartë dentarë, një profesion i cili nuk cënon interesat kombëtare pasi ky kontigjent profesionistësh mund të ushtrojë aktivitetin në laboratorët dentarë brenda dhe jashtë vendit. Dok 4. Rregullore programi studimi_TLD.pdf			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit në teknikë e lartë dentare që ofrohet aktualisht nga AI ka fillësat në vitin 2004 me një kurs dy vjeçar të teknikëve dentarë i ofruar nga Institucioni Plotësues Parauniversitar Privat “Ivoclar Vivadent&Partners” i cili në vitin 2010 u licencua si Kolegji Profesional Privat “Ivoclar Vivadent&Partners”. Ky program ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e programit të studimit duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike kulturore dhe kombëtare.			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Përmbajtja e programit të studimit përputhet me qëllimin kryesor të AI për paisjen e studentëve me diplomën: “Teknikë e lartë dentare”. Megjithatë në program mungojnë lëndë apo module që mundësojnë realizimin e plotë të misionit të AI si kryerja e kërkimeve të aplikuara në fushën e teknikës dentare dhe kryerja e studimeve dhe publikimeve në fushën e mjekësisë, fushë e cila del nga kompetencat e një Institucioni që ofron një program të vetëm studimi të lidhur ngushtësisht me fushën e Stomatologjisë. Aneks/Shtojce Nr., datë 2019-10-01 Dosja e programit të studimit 2018-2021, Akademia Ivodent			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ka elementë në programin e studimit që synojnë të jenë koherente duke ju përshtatur dinamikës së evoluimit të profesionit si psh Protezat mbi Implante lëndë e kategorisë C e cila zhvillohet ne vitin e III semestri i II dhe ka 6 kredite.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Aktualisht AI ofron vetëm një program studimi por në strategjinë e hartuar për vitin 2018-2023 parashikohet hapja e programeve të tjera të studimit. Aneks/Shtojce Nr49., datë 2019-10-01 Strategjia e zhvillimit të institucionit 2018-2023, Akademia Ivodent			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në nenin nr 4 të Statutit përcaktohet se AI ka si mision ofrimin e arsimit të lartë, programeve me karakter profesional, ndaj realizimi i këtij programi i cili është i vetmi që ofrohet aktualisht nga AI përputhet me drejtimin prioritar të AI. Aneks/ Shtojcë Nr 8, datë 2019-10-01 Satuti i Akademisë, Akademia Ivodent			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit ofrohet në një periudhe 3 vjeçare, me kohë të plotë, e organizuar në 6 semestra. Ky program studimi i ciklit të parë, ka në përbërje të tij 29 lëndë mësimore, 2 praktika profesionale dhe provimi i Diplomës. Të gjitha së bashku i sigurojnë studentëve 180 kredite të vlefshme për fitimin e diplomës në “Teknikë e lartë dentare”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Mbështetur në Rregulloren e Programit të studimit, neni 2, Misioni dhe Objektivat, ky program studimi ka si mision të tij përgatitjen e një gjenerate të re ekspertësh të shkencave dentare mjekësore me formim të lartë profesional të aftë që tju përgjigjen nevojave të kohës. Programi synon të përgatisë teknikienë me formim të avancuar profesional në fushën e teknikave dhe materialeve dentare. Po në këtë rregullore, paraqitet se programi garanton për studentët përgatitje të lartë teorike dhe praktike sidomos krijimin dhe formimin e avancuar profesional duke u fokusuar në aplikime të reja të teknikave të avancuar në shkencat dentare në përputhje me nivelin e këtij cikli studimi. Programi ka si objektiv përgatitjen e teknikienëve në nivel të lartë të teknikave dhe materialeve dentare. Modulet e materialeve përmbajnë 8 kredite në vitin e parë të studimeve, 6 kredite në të dytin dhe 6 kredite në të tretin. Lënda e materialeve dentare shtrihet në tre vitet e programit dhe ka 20 kredite krahasuar me 19 që ka praktika profesionale.

	Aneks/Shtojce Nr 4, datë 2019-10-01 Rregullore programi studimi, TLD, Akademia Ivodent			
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Mbështetur në Raportin e Vetvlerësimit, GVJ konstaton se vetë Institucioni është shprehur se ka bërë një studim tregu për vitin 2019. Në fakt, ky dokumentacion ka vetëm disa të dhëna, të dhëna të cilat GVJ mendon se nuk mund të jenë studim tregu. Aneks/shtojcë nr 38, datë 2019-10-01, Studimi i Tregut 2019 GVJ shprehet se në dosjen e vetvlerësimit me anekset përkatëse të saj nuk ka studim tregu të mirëfilltë për këtë program studimi. Ky studim u kërkua gjatë vizitës dhe GVJ ju prezantua se ky material është dhe do ngarkohet brenda ditës në sistem. Ky dokumentacion nuk ju vu në dispozicion GVJ.			
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Programi i studimit synon përgatitjen e teknikienëve me formim të avancuar profesional në fushën e teknikave dhe materialeve dentare. Të diplomuarit në këtë program mund të punësohen në qendrat laboratorike dentare, pranë klinikave dentare që disponojnë laborator, apo të hapin laboratorët e tyre. Ka në program lëndë edhe të formimit të përgjithshëm si Fiziologji, Higjenë të cilat i përkasin grup lëndëve të formimit të përgjithshëm pra jo të lidhura me profilin. Aneks/shtojcë nr 4, datë 2019-10-01 Rregullore programi studimi, neni 2.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	GVJ shprehet se Institucioni është organizuar si Akademi me dy departamente, Departamenti i Protetikës, Departamenti i Ortodontisë dhe një Qendër, Qendër të Studimit të Teknikave. Institucioni ka lidhur së fundmi një marrëveshje me MASR me Nr prot 5969, datë 06.06.2019 "Marrëveshje për përcaktimin e numrit të personelit akademik, me kohë të plotë, në njësitë bazë, në Akademinë "Ivodent". Kjo marrëveshje është lidhur me objektiv përcaktimin e procedurës dhe vendosjen e rregullave për numrin e personelit akademik, me kohë të plotë, në njësitë bazë të kësaj akademie dhe mënyrës së përzgjedhjes së tyre. Akademia, për të paktën tri vite akademike, nuk ka patur më shumë se 300 (treqind) studentë. Mbështetur në dokumentin e paraqitur në DVV, aktualisht, Akademia ka këtë personel akademik sipas Departamenteve:

	<p>Departamenti i Ortodoncisë–3 personel akademik (1 Prof As; 1 Phd; 1 Msc)</p> <p>Departamenti i Protetikës – 4 personel akademik (1 Prof Dr; 1 Dr dhe 2 Msc)</p> <p>Qendra e Studimit të Teknikave – 3 personel akademik (3 Dr)</p> <p>GVJ konstaton se emërtimi njësisë së tretë, njësisë bazë, është i ndryshëm në dy dokumenta të ndryshme të paraqitura në Dosjen e Vetvlerësimit.</p> <p>Kjo qendër në organigramë titullohet Qendra e Studimeve Teknike, ndërsa në Rregullorem e Fakultetit emërtohet Qendra e Shërbimeve Dentare (neni 6, neni 12 i Rregullores)</p> <p>Dok 18.1.Organigrama dhe personeli i AI.pdf, Dok 3. Rregullore Fakulteti_Ivodent.pdf</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i Studimit ofrohet nga Departamenti i Protetikës pjesë përbërëse e Fakultetit të Teknikave Dentare, me fushë të përgjithshme dhe specifike që përputhet me fushën akademike të njësisë kryesore. Diploma Bachelor në Teknikë e Lartë Dentare që jepet në përfundim të studimeve 3 vjeçare me 180 kredite është konform me kornizën e kualifikimeve, niveli 6.</p> <p>Aneks/Shtojcë nr 3 Rregullore Fakulteti Ivodent, datë 2019-10-01, neni 18, neni 20.</p> <p>Aneks/Shtojcë nr 25.1 Format Diplome TLD, datë 2019-10-01</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Njësia bazë që organizon këtë program studimi ka fushë akademike që i përshtatet profilit, dy njësitë e tjera përbërëse të Fakultetit nuk përputhen plotësisht me profilin e studimeve në Teknikë e lartë dentare. Programi i studimit organizohet nga Departamenti i Protetikës i cili së bashku me Qendrën e Kërkimit të teknikave dhe Departamentin e Ortodoncisë përbëjnë strukturën e Fakultetit të Teknikave Dentare. Fusha e përgjithshme dhe specifike e Fakultetit të Teknikave Dentare përputhet me programin e studimit Bachelor në Teknikë e lartë dentare.</p> <p>Aneks/shtojcë nr 3 Rregullore Fakulteti Ivodent, datë 2019-10-01 neni 18.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie</p>	<p>Akademia përbëhet nga 2 departamente dhe një qendër të zhvillimit të teknikave por programi i studimit realizohet vetëm nga Departamenti i</p>

bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Protetikës. Funkzioni dhe mënyra si bashkërendojnë dhe se çfarë realizojnë dy departamentet e tjera është vetëm se anëtarët e stafit aktivizohen në procesin mësimor.			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	Institucioni disponon disa marrëveshje me Institucione homologe por nuk ka konkretizime. GVJ konstaton se njerës prej marrëveshjeve jo vetëm i ka mbaruar afati por edhe nuk i përket këtij Institucioni. (Dokumenti 36.1 në AMS). Gjithashtu edhe marrëveshja sipas dokumentit nr. 6 të ngarkuar në sistem, pas kërkesës së bërë gjatë vizitës së GVJ në Institucion nuk i përket kësaj Akademie. 36.1 Marrëveshje_Ivoclar Ltd&ivodent.pdf Marreveshja me Dorina Mele Co.pdf			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nuk ka raporte që analizojnë përfitimet nga marrëveshjet.			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Në vitin akademik 2019 Institucioni ka parashikuar të fillojë organizimin e praktikave profesionale në laboratorë me të cilët ka marrëveshje, por nuk konstatohen të tilla. Pamvarësisht se sikurse u deklarua gjatë vizitës së GVJ në AI kjo praktikë do fillojë të aplikohet në vitin 2019 në AMS është ngarkuar dokumenti me nr 30.3 që dokumenton kryerjen e praktikës profesionale në periudhën 2018-2019.			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në vitin akademik 2018-2019 janë realizuar disa ëorkshope për studentët aktuale dhe ata të diplomuar. Nuk dokumentohet si përfshihen këto aktivitete në ngarkesën e procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit në “Teknikë e lartë dentare “organizohet në lëndë e module me kreditet përkatëse ku 1 (një) krediti i korespondojnë 25 orë mësimore të studentit. Në secilin vit akademik studenti mbledh 60 kredite. Në vitin e I akademik përfshihen 11 module me 720 orë studimi pa përfshirë orët jashtë auditorit. Në vitin e dytë 9 module dhe praktikë profesionale I –gjithsej 768 orë prej të cilave 120 orë i përkasin praktikës profesionale. Në vitin e tretë janë 824 orë cilat i përkasin 8 moduleve të këtij viti. Diploma ka 5 kredite por nuk përcaktohet sa orë ka. Përkatësisht në 3 vite studenti për tu diplomuar duhet të mbledhi 180 kredite përfshirë punimin e diplomës. Në përfundim të studimeve studenti jep 32 provime prej të cilave 29 janë module, dy janë praktikë profesionale dhe provimi i diplomës.
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	AI ofron vetëm 1 program studimi në fushën e teknikës së lartë dentare.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit ka një lidhje shumë të ngushtë me praktikën pra produkti është një teknik i lartë dentar me orientim vetëm praktik dhe jo akademik.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit pais studentët me kompetenca profesionale praktike në fushën e teknikave dentare, konkretisht të procedurave që kryen një teknik dentar në kryerjen e punimeve të ndryshme protetike.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Struktura e programit të studimit përputhet me elementet e parashikuara në ligjin 80/2015 dhe VKM nr 41 datë 24.01.2018 Elementet e strukturës së programit të paraqitura në syllabuse janë leksionet, seminarët, praktikat, dhe ëorkshopet.
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit është strukturuar në lëndë te grupeve A,B,C,D,E dhe respekton përqindjen e krediteve sipas kategorizimit me gërmë. Në grupin A lëndë bazë 15-20% Në këtë grup përfshihen lëndëet me kreditet përkatëse: 1. Anatomi 13 2. Materiale dentare ndihmëse 4 3. Anatomi 3 4. Mikrobiologji 3

5. Koncepte të përgjithshme mbi protetikën dentare 6
6. Higjenë 3
7. Fiziologji dhe Histologji 3

Grupi B lëndë karakterizuese 50-55%

Në këtë grup përfshihen me kreditet përkatëse:

1. Teknika e modelimit të kurorave me dyll 13
2. Materiale dentare e biopërshtatshmëri 4
3. Proteza totale e thjeshtë 6
4. Proteza totale biofunktionale 6
5. Proteza parciale e thjeshtë
6. Proteza fikse në metal 8
7. Materiale dentare me biopërshtatshmëri II 6
8. Teknika dhe metoda në protezimin dentar 6
9. Materiale dentare me biopërshtatshmëri III 6
10. Teknina dhe metoda në protezimin dentar 6
11. Materiale me biopërshtatshmëri III 6
12. Protezat e kombinuara me elemente në formë teleskopi 6
13. Protezat e kombinuara me atashmente 8
14. Protezat fikse pa metal 8

Grupi C lëndë ndërdisiplinore 12-15%

Në këtë grup përfshihen me kreditet përkatëse:

1. Proteza e skeletuar 6
2. Ortodonci 2
3. Aparate që përdoren në teknologjinë dentare 6
4. Ortodoncia e lëvizshme 2
5. Protezat mbi implante 6

Grupi D Plotësuese 10-15%

Në këtë grup përfshihen:

1. Gjuhë angleze 4
2. Art modelimi 4
3. Praktikë profesionale 1 6
4. Pratykë profesionale 2 16

Grupi E Detyrime përmbledhëse 5 %

Provimi përfundimtar 5%.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Teknikave Dentare është njësia kryesore i cili përbëhet nga dy departamente dhe një qendër kërkimore shkencore. Programi i Studimit ofrohet nga Departamenti i Protetikës. Në sajë të marrëveshjes me MASR njësia ka PA të reduktuar deri sa të ketë nën 300 studentë. Referuar dokumentit nr 16 në sistemin AMS, Dosja e Programit të Studimit 2018-2021 faqe nr. 15 dhe asaj çfarë u konfirmua gjatë vizitës, kapaciteti maksimal për student në vit është 24 që korespondon me vendet e punës në tre laboratorët. Gjithashtu referuar dokumentit nr. 31 në AMS për funksionimin normal të Institucionit numri maksimal i studentëve nuk duhet të kalojë 72 studentë. Bazuar në këtë document AI nuk mund të ketë mbi 300 studentë. Që prej vitit 2016 AI deklaroi 50 kuota të reja pranimi referuar aneksit nr. 68.</p> <p>Aneks/shtojce nr 16 Dosja e Programit të Studimit 2018-2021, faqe nr 15 datë 2019-10-01</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB faqe nr 12 Fakulteti çdo vit cakton një kordinator i cili përgjigjet për ecurinë e praktikave profesionale. Gjatë vizitës GVJ pyeti se kush është kordinatori dhe si e organizon punën për monitorimin e praktikave profesionale. Përgjigja ishte se nuk kanë një kordinator, parashikojnë ta fillojnë këtë procedure në këtë vit akademik kur pritet edhe të fillojnë realizimin e praktikave profesionale në laboratorët me të cilët disponojnë marrëveshje.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Referuar detyrimeve të nenit 25, pika 4 e ligjit 80/2015 AI ka nënshkruar një marrëveshje me MASR dhe përjashtohet nga detyrimi për numrin minimal të PAE. Në bazë të marrëveshjes që AI ka me MASR stafi akademik përbëhet nga 10 PAE dhe 7 PAK..</p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Programi i vetëm i studimit realizohet nga Departamenti i Protetikës. Ky Departament ka në përbërje 4 PAE prej të cilëve 2 me gradë konkretisht 1 Prof.Dr (me fushë akademike studimi kimist), 1 Dr (mjek stomatolog) dhe 2 Msc (mjeke stomatologe).</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nuk ka evidenca që dokumentojnë realizimin e gjithë detyrave të Departamentit të Protetikës për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit Akademik. GVJ konstaton se mungojnë grupet mësimore, mungon miratimi në syllabuse prej drejtuesit të Departamentit. Drejtuesi i Departamentit K.T rezultoi se ka lidhur kontratën e punësimit me këtë Akademi në datë 1/1/2018.</p> <p>Referuar aneksit 17 Statistika Përmbledhëse 2016-2020, K.T rezultoi PAE pranë Departamentit të Protetikës. Në aneksin 67 Deklarimi i kapaciteteve pritëse 2017-2018 K.T nuk figuron stafi i Departamentit të Protetikës por PAE në Departamentin e Ortodoncisë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Dokumentacioni i përgatitur nga AI për organizimin e programit të studimit është i plotë dhe përfshin: kurrikulën e programit, dhe ndarjen e lëndëve sipas kategorisë me ngarkesën përkatëse të shprehur në përqindje, planin mësimor, syllabuset e lëndëve. Sikurse paraqitet në dokumentin nr. 16 të ngarkuar AMS, AI ka përgatitur dosjen e programit të studimit për periudhën 2018-2021 ku përshihen informacione të përgjithshme për Institucionin, plani mësimor me ndarjen e lëndëve sipas kategorive dhe kreditet përkatëse. Aneks/shtojcë nr 16 Dosja e Programit të Studimit 2018-2021 pdf, datë 2019-10-01
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Në zbatim të kërkesave të VKM nr 41 dt 24.01.2018 plani mësimor i programit të studimit është organizuar në lëndë e module të cilat grupohen në semestra. Për secilin prej moduleve paraqitet numri i krediteve dhe raporti leksion/seminar/laboratore/praktika. Kategorizimi i lëndëve me kreditet përkatëse është: A. Lëndë bazë 35 kredite B. Lëndë të formimit karakterizues 91 kredite C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese 22 kredite D. Lëndë Plotësuese 27 kredite E. Detyrime Përmbyllëse 5 kredite
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi ka strukturë 3 vjeçare me 6 semestra, dhe 180 ECTS,60 kredite për secilin vit. Aneks/shtojcë nr 16 Dosja e Programit të Studimit 2018-2021 pdf, datë 2019-10-01
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor hartohet duke u bazuar në kurrikul dhe përmban: Emërtimin e moduleve të grupuara dhe renditura në semestra Detyrimet sipas moduleve ku përfshinë seminarët, detyra kursi, projekte, praktikë. Numri i krediteve për çdo modul dhe ndarja e orëve leksion/seminar, laboratorë. Informacioni në lidhje me orët jashtë auditorit, frekuentimi dhe mënyra e vlerësimit të dijeve nuk përfshihet. Aneks/Shtojcë nr 16.2 Plani mësmor 18_21 TLD, date 2019-10-01
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të	Si në rregulloren e programit edhe atë të Fakultetit ka informacione për kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit.

<p>pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit, neni nr 3, <i>pranimi në këtë program studimi do të bëhet për studentët me përzgjedhje sipas kritereve:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a. <i>Kandidatë që kanë mbaruar shkollën e mesme, brenda dhe jashtë Shqipërisë</i> b. <i>Kandidatë që kanë mbaruar apo ndjekur programe universitare në fusha të tjera</i> c. <i>Student që kanë ndjekur programe studimi universitare në (fakultete të tjera) dhe që kërkojnë të transferohen pranë fakultetit tonë.</i> <p><i>Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Akademisë, institucioni mund të vendosë kritere specifike në varësi të aplikimeve, specifikave dhe udhëzimeve nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.</i></p> <p>Mbështetur po në Rregulloren e programit të studimit, neni 6, pika 1 dhe pika 3, <i>Procedurës së ekuivalentimit i nënshtrohen studentët që kanë mbaruar apo kryer pjesërisht programe universitare në fusha të tjera të ngjashme me këtë program studimit, pas rregjistrimit pranë sekretarisë së akademisë dhe kërkesës për njohjen e studimeve të kryera.</i></p> <p><i>Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidatët në studimet universitare të kryera bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit, i ngritur nga Dekani i Fakultetit të Teknikave Dentare.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për të gjitha lëndët që përmban programi i studimit vërehet formati i sillabusit i ndërtuar bazuar në VKM 41/2018. Kështu të gjitha sillabuset përmbajnë të dhëna në lidhje me titullarin e lëndës, kreditet dhe shpërndarja e orëve për leksione, seminare, orë laboratorike dhe praktika. Sillabuset përmbajnë edhe mënyrën e vlerësimit dhe literaturë por nuk përmbajnë miratimin e drejtuesit të Departamentit dhe ngarkesën jashtë auditorit. Ajo çfarë vërehet në sillabuse është sasia e orëve si të leksioneve edhe të seminareve që nuk korrespondojnë me ngarkesën semestrale apo vjetore. Lënda Aparate që përdoren në teknologjinë dentare e zhvilluar në semestrin e II të vitit të I ka në total 72 orë me shpërndarje 24 orë leksione; 12 orë seminare, 6 orë detyrë/project, 10 orë laborator dentar, 20 orë praktikë. Një lëndë vjetore që zhvillohet në vitin e I Koncepte të përgjithshme teorike mbi protetikën dentare ka 6 kredite me 72 orë në total, 44 orë leksione/ 22 orë seminare/ 6 orë detyrë projekt.</p> <p>Në planin mësimor vërehet një ndarje e tillë e ngarkesës: 12 orë leksione/6 orë seminare/ 25 orë praktikë/5 orë detyrë/20 orë laborator</p> <p>Aneks/Shtojcë nr 16.2 Plani mësimor 18_21 TLD, date 2019-10-01 Aneks/shtojcë nr 30 Syllabuset e lëndëve TLD, datë 2019-10-01</p>

<p>Kriteri 7. Përbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Referuar RVB faqe 14 dhe asaj që na u tha gjatë vizitës që GVJ zhvilloi në Insitucion, programi i studimit ku përfshihen syllabuset dhe literatura ka pësuar përmirësime të vazhdueshme. Ndryshimet në program korrespondojnë me domosdoshmërinë e përshtatjes me legjislacionin. Ka vetëm një ndryshim të programit të studimit. Anëtarët e stafit nuk janë të qartë në lidhje me ndryshimet e programit dhe as nuk dokumentohen përmirësimet e përvitshme. Nuk ka evidencë për ndryshime të tjera të programit. Aneks/shtojcë nr 16.1 Raport i ndryshimeve të programit TLD 2018, datë 2019-10-01 Aneks/shtojcë nr 16.1 Raport i ndryshimeve të programit TLD 2018, datë 2019-10-01</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Duke respektuar VKM nr 41 dt 24.01.2018 programi i studimit organizohet në 3 vite akademike, 6 semestra, me ndarje 60 kredite në vit, në total studenti mer 180 kredite.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Modulet kanë emërtime të lidhura me profilin. Gjatë tre viteve të studimit, studentët njihen me llojet e protezave të lëvizshme parcialet apo të plota, protezat e skeletuara, ato me atashmente apo ato mbi implante.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Në vitin e parë lëndët me numrin më të madh të krediteve janë Anatomia Dentare dhe Teknika e modelimit të kurorave me dyll, me nga 13 kredite secila. Këto lëndë e njohin studentin me anatominë e dhëmbëve dhe i mundësojnë aftësi të mira në realizimin e punimeve të ndryshme protetike me të cilat njihen në vitet në vijim.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Një numër të madh kreditesh, 20 kredite, kanë lëndë të lidhura me materialet dentare me të cilat studentit do ti duhet të punojë, por këto lëndë nuk mund të kenë sasi pothuajse të barabartë me praktikën profesionale që ka 19 kredite. Dhe nga biseda me studentët u paraqit që preferonin të kishin më shumë praktikë. Referuar RVB faqe nr 15 ky program studimi përafëron me programe të ngjashme ndërkombëtare por nuk përmendet cilit program dhe cilit shtet..</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë</p>	<p>Në kushtet që programi i përfshin të gjitha lëndët e lidhura me punimet protetike që parashikohen të bëhen nga njëlaborant dentar</p>

arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	kjo krijon mundësi punësimi të studentëve. Numrin më të vogël të krediteve e zë lënda e Ortodoncisë dhe kjo është një kufizim për ata studentë që dëshirojnë të realizojnë aparate të ndryshme ortodontike.			
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Programet e lëndëve nuk kanë pësuar përditësime. Literatura është kryesisht cikël leksionesh të cilat AI jua ve në dispozicion studentëve disa prej të cilave si Fizilogji, Histologji, Ortodonci janë krijuar për vitin akademik 2017-2018. Nuk kishte kopje në bibliotekë.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Është një program i lidhur ngushtësisht me aspektin profesional përkatësisht me realizimin e punimeve të ndryshme protetike.			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Në përfundim të studimeve në këtë program studimi studentët mund të punësohen në laboratore dentare. Sa i përket vijimit të studimeve në cikle të dyta në fusha të përafërta me këtë program, studentëve do tju duhet ti nënshtrohen ekuivalentimit të krediteve të mara.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Programi i studimit nuk ka ndryshuar përmbajtje. Gjatë vizitës u pohua që ndryshimi do fillojë këtë vit në lidhje me lëndën e Ortodoncisë por ajo lëndë nuk ka pësuar rishikime apo modifikim të krediteve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Për realizimin e programit të studimit, AI angazhon personel akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. PAE dhe PAK janë të profileve kimist dhe mjek Stomatolog. Lektorët e lëndëve të lidhura ngushtësisht me programin janë MSc. Pothuajse i gjithë stafi është në funksion të këtij programi studimi, pasi siç edhe e kemi theksuar, është programi i vetëm që ofron aktualisht ky Institucion. Referuar dokumentit nr 17 në DVV, Stafi në Departamente paraqitet si më poshtë: Departamenti I Ortodoncisë - 3 PAE prej të cilëve 2 me tituj Prof As dhe Dr si dhe 1 MSc. Departamenti i Protetikës - 4 PAE prej të cilëve 1 Prof Dr; 1 Dr; 2 Msc, si dhe 4 PAK (1 Prof. Dr dhe 3 Dr).

	<p>Qendra e Studimit të teknikave - 2 PAE me titull Dr dhe 2 PAK me titull Prof.</p> <p>Stafi i angazhuar në programin e studimit për të tre vitet e fundit akademike nuk ka pësuar ndryshime. Është po I njëjti staf dhe paraqitet si më poshtë:</p> <p>9 PAE – 1 Prof Dr; 1 Prof As; 4 Dr dhe 3 Msc 4 PAK – 1 Prof Dr; 3 Dr</p> <p>Ngarkesa minimale për kategorinë PAE është 28 orë e I.M me titull Prof, kurse ngarkesa maksimale 424 orë M. Ngj me titull MSc.</p> <p>Referuar dokumentit nr 17 në tabelën e tiulluar “Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit 2010-2020” parashikohen 108 orë mësimore për K.L PAE në lidhje me të cilën GVJ gjatë vizitës u informua se ishte larguar nga AI.</p> <p>Aneks/Shtojcë nr 17 Statistika përmbledhëse 16_20, datë 2019-10-01</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Drejtesja e Fakultetit është me titull Prof. As por ajo ka shkëputur marrëdhëniet me Insitucionin në këtë vit akademik. Dy drejtuesit e Departamenteve janë me titull Dr. Drejtuesi i Departamentit që ofron programin e studimit është i huaj nuk flet shqip por përkthehet në leksione nga asistentët.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit neni 6 Departamenti organizohet në grupe mësimore por nuk dokumentohet cilët janë.</p> <p>Aneks/Shtojcë nr 3 Rregullore Fakultetit, datë 2019-10-01</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Disa lëndë të programit të studimit mbulohen nga personel akademik fusha akademike e të cilëve nuk përputhet me Stomatologjinë.</p> <p>Konkretisht lëndët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Materiale dentare me biopërshtatshmëri, Aparate që përdoren në teknologjinë dentare, Teknika dhe metoda në protezimin dentar mbulohen nga Dr G.K. kimist, - Materiale Dentare ndihmëse Prof I.M. kimist - Materiale dentare me biopërshtatshmëri II mbulohet nga Dr A.M kimiste
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB faqe 17 i cili i referohet rregullores së Fakultetit të Teknikave Dentare dhe konkretisht neneve 66,67,68, 69 ky Fakultet harton programin e praktikës profesionale dhe cakton stafin që ngarkon për ndjekjen e praktikës. Gjatë vizitës së GVJ në Institucion na u tha se kjo mënyrë e realizimit të praktikave në Institucione të tjera me të cilat duhet të ketë një marrëveshje do fillojë të aplikohet këtë vit akademik, por rezulton që praktika jashtë institucionit të jenë kryer edhe më përpara. Pamvarësisht se Institucioni plotëson nevojat dhe kërkesat për të realizuar praktikën në Institucion referuar RVB faqe 18 është përfshirë në rregullore kryerja e praktikave në Institucione me të cilat aktualisht Institucioni nuk ka marrëveshje.</p> <p>Nuk realizohen punime diplome apo veprimtari të tjera në të cilat të jetë angazhuar personeli i AI.</p>

	Aneks/shtojcë nr 30.3 Shembull i realizimit të praktikës, datë 2019-10-01			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Aktualisht pranë AI janë angazhuar 4 personel nd/akademik Bsc, të cilët sikurse na u referua gjatë vizitës që GVJ zhvilloi në Institucion asistojnë gjatë mësimit duke ofruar edhe përkthim për PAE TH.K i cili është i huaj dhe nuk flet shqip.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	X			

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1				
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Mësimdhënia realizohet me leksione, seminare, praktika. Stafit akademik ofron ndihmë në raste të veçanta për studentët. GVJ konstaton se AI nuk ka udhëzues të veçantë për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative.			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Në mënyrë periodike, 2 herë në vit, realizohet monitorimi i mësimdhënies së personelit akademik dhe atij nd/akademik. Krahas pyetësorit në fund të çdo semestri gjatë vizitës GVJ ju komunikua se realizohen edhe intervista me studentët. Rezultatet e pyetësorëve analizohen nga Departamenti dhe Fakulteti.			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ ju komunikua se Institucioni nëpërmjet pyetësorëve analizon performancën e personelit akademik. AI ka patur një rast mosrinovim kontrate të një personeli nd/akademik të cilit nuk i kanë rinovuar kontratën pasi u konstatuan ankesa nga studentët. Gjatë vizitës së GVJ u kërkua të njiheshim me procedurën konkrete por nuk u ngarkua në AMS.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në AI është NJSBC e cila realizon pyetësorët me studentët dy herë në vit referuar RVB faqe 19 rezultatet i bën publike nëpërmjet analizës vjetore dhe diskutohen në mbledhje të hapur në departament dhe pas miratimit përcillet në dekanat. Realizimi i një procedure të tillë nuk dokumentohet me procesvebale të mbledhjeve të departamentit.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Nuk ka evidenca të lidhura me nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
-----------------	-------------------------------	--	--	--

<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton se Format e mësimdhënies janë konform Udhëzimit nr 41/2018. Format e mësimdhënies dhe ngarkesa përkthës në orë totale në auditor janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Leksione 662 orë Seminare 256 orë Detyrë/projektet 68 orë Laboratorë 406 orë Praktikë lëndore 480 orë <p>Praktikë profesionale 440 orë</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Referuar RVB faqe 20 të qënurit një Institucion i vogël e bën mjaft të lehtë komunikimin dhe ndërveprimin me studentët.</p> <p>Aktualisht AI ka 59 studentë me ndarje sipas viteve akademike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti I = 27 studentë - Viti II = 16 studentë - Viti III = 16 studentë
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Objektivi kryesor i programit është përgatitja e teknikëve për të realizuar punime të ndryshme protetike për këtë arsye, sikurse GVJ ju komunikua gjatë vizitës në Institucion, gjatë procesit mësimor, stafi ndërthur komponentët teorik me ato praktikë. A.M përmendi procesin e derdhjes së allçisë gjatë leksionit me të njëjtën tematikë. GVJ konsideron shumë të rëndësishme rëndësinë e praktikës në këtë profil studimi por kjo nuk duhet të çënojë rëndësinë e përgatitjes teorike aq më tepër që është e vështirë realizimi i këtyre procedurave për shkak të paisjeve që duhen, të cilat nuk i përkasin një salle leksioni.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Krahas leksioneve klasike Institucioni ka përfshirë edhe video ilustruese të procedurave të ndryshme laboratorike. Jo të gjithënga personeli akademik kanë lidhje të ngushtë me profilin e programit tëstudimit dhe kjo sipas drejtuesve gjatë vizitës së GVJ është e lidhur me mungesën e profesionistëve të fushës në vendin tonë.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GBJ konstaton se Institucioni është i gatshëm të asistojë studentët në përvetësimin e njohurive praktike. Realizimi i pyetësorëve në fund të cdo semestri akademik mundëson marrjen e opinionëve që studentët kanë për mësimdhënien.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Nuk dokumentohet aplikimi i metodave interaktive. Anëtarët e stafit janë të gatshëm të asistojnë dhe konsultojnë studentët në raste kur ata hasin vështirësi..</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e</p>	<p>Në procesin mësimor inkurajohet autonomia dhe puna e pavarur e studentëve, por ata janë vazhdimisht të monitoruar e mbikqyrur nga personeli akademik ose ai ndihmës.</p>

marrëdhëniet të respektit të ndërsjellë mes tyre.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ gjatë vizitës në Institucion pa me kujdes infrastrukturën në funksion të programit. Hapësirat janë të rregullta dhe të pastra. Në vite ka pasur përmirësime të infrastrukturës. Aktualisht kanë 4 laboratorë: 1) Laboratori funksional me sipërfaqe 54 m ² , 2) Laboratori i protezës fikse me 57 m ² , 3) Laboratori i protezës së lëvizëshme 15 m ² 4) Laboratori i teknikave dixhitale 28 m ² . Gjithashtu Institucioni ka edhe sallë leksionesh që ka sipërfaqe 33 m ² , sallë për seminare 35 m ² .
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Laboratorët janë të paisur me të gjitha aparaturat e domosdoshme për një laborator dentar. Ndër paisjet që disponojnë përfshihen: 3 furra porcelani, mikroskop, aparat pastrimi sablozë, 5 mikromotora, trimera, furrë për derdhjen e metalit, aparat për skanimin e modeleve, 2 kompjutera për dizenjimin e modeleve etj.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Institucioni ka mbulim me Wi-Fi.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura e detyruar është kryesisht cikël leksionesh për shumicën e lëndëve. Gjatë vizitës së GVJ nga drejtuesit na u tha se Institucioni jua siguron tekstet studentëve.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka është vënë në funksion në vitin 2019. Nuk ka një listë të librave që disponon. U kërkua gjatë vizitës por nuk u ngarkua në AMS. Referuar RVB faqe 26 dhe asaj që na u tha gjatë vizitës në bibliotekë gjenden kopjet fizike të cikleve të leksioneve por gjatë vizitës në bibliotekë nuk patëm mundësi të shohim ndonjë kopje të ciklit të leksioneve.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli	Institucioni ka një kontratë me biblioteken online Hinari nëpërmjet së cilës studentët dhe stafi akademik mund të kenë akses nëpër revista të

akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	ndryshme, kryesisht të karakterit mjekësor. Në lidhje me këtë kontratë, GVJ konstaton se afati i përfundimit të kësaj kontrate është më 31 Dhjetor 2025. Aneks/Shtojcë nr 11.1 Library online, datë 2019-10-01			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Krahas zhvillimit të laboratorëve dhe praktikave studentët kanë në dispozicion paisjet e laboratorëve për detyra kursi apo Ëorkshop-et e ndryshme të organizuara.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nuk përdoren të tilla platforma pasi mësimi nuk zhvillohet në distancë			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Kanë mbulim me ËI-Fi por nuk përdorin sistem të brendshëm komunikimi për akses në dokumentacionin elektronik.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Referuar Rregullores së FTD, neni 70, Departamenti i Protetikës mund të aplikojë edhe mbrojtjen e diplomes me temë. AI nuk aplikon mbrojtjen e temave të diplomave për diplomimin e studentëve. Gjatë vizitës GVJ ju komunikua se mbrojtja bëhet me provim teorik dhe praktik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ konstaton se përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies është një objektiv prioritar i AI, por nuk ka struktura të posaçme për këtë qëllim.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	AI ofron vetëm një program studimi por GVJ konstaton se nuk vërehet të realizojë procedura te posaçme të dokumentuara të rritjes së vetëdijes të PA apo studentëve për cilësinë e programit. Në RVB faqe 27 përmenden kontrole të departamentit por nuk

	dokumentohet kjo procedurë sikurse nuk morëm përgjigje për pyetjen nëse pedagogët lajmërohen para këtyre kontrolleve.			
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Metodat e mësimdhënies janë përputhje me VKM nr 41/2018. Metodat e mësimdhënies janë: leksionet, seminarët, praktikat dhe laboratorët.			
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në saj edhe të mbështetjes nga Institucioni, GVJ vëren se ka pjesëmarrje të stafit akademik dhe nd/akademik në aktivitete shkencore si konferenca e trajnime si brenda dhe jashtë vendit.			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Referuar RVB faqe nr 27 Insitucioni parashikon mbështetje financiare për pjesëmarrje në aktivitete shkencore dhe hartimin e teksteve apo leksioneve të shkruara por nuk dokumentohet ofrimi i aktiviteteve të trajnimit të personelit akademik për të përmirësuar aftësitë në mësimdhënie..			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	PA dhe ai nd/akademik janë përgjegjës kryesorë të zbatimit të programit për realizimin e objektivave që konkretizohen me aftësimin e studentëve për të realizuar punime prototipe të ndryshme.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në RVB faqe 28 thuhet: <i>Në mënyrë periodike Fakulteti i Teknikave Dentare analizon punën kërkimore dhe mësimore duke nxjerrë në pah arritjet dhe mangësitë si dhe përcakton ecurinë për të ardhmen, diskutohen përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie.</i> GVJ nuk ju vu në dispozicion ndonjë evidencë të mbledhjeve të Departamentit edhe pse u kërkua gjatë vizitës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në Rregulloren e programit të studimit, vlerësimi i studentit paraqitet si vijon: <i>Vlerësimi i studentit mbështetet në vlerësimin gjithëvjeter (përkatësisht semestral) të punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, rezultateve laboratorike, praktikave profesionale etj.</i> <i>Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës/modulit duhet të bëhet sipas modulit të detajuar nga departamenti (gjithsej 100 pikë), por mbetet në kompetencë të</i>

	<p><i>pedagogut përgjegjës të lëndës përcaktimi i peshës specifike për secilin component të mësimdhënies (leksione, seminare/ushtime, laboratorë dhe provim përfundimtar.</i></p> <p>Nëpër syllabuset e lëndëve dhe në rregulloren e programit të studimit përfshihet mënyra e kontrollit të dijeve por studentët nuk i njohin mirë. Kjo gjë u vërejt gjatë takimit që pati GVJ me studentët që frekuentojnë këtë program studimi</p> <p>Aneks/shtojcë nr 4 Rregullore Programi studimi TLD, date 2019-10-01</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar RVB faqe 29 në fillim të semestrit pedagogët njohin studentet me përmbajtjen e lëndës. Sillabuset përmbajnë informacion në lidhje me metodologjinë e vlerësimit por studentët nuk i njohin plotësisht ato.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Krahas testimeve për nivelin e përgatitjes teorike që kryhen me provime të ndërmjetme dhe provim përfundimtar, studentët testohen edhe në nivelin praktik të realizimit të punimeve të ndryshme prototike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Të gjitha modulet e lëndëve qoftë semestrale apo vjetore kanë vlerësim 20% të provimit të ndërmjetëm.</p> <p>Aneks/shtojcë nr 30 Syllabuset e lëndëve, datë 2019-10-01</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstaton se Sistemin elektronik institucioni nuk e ka aplikuar në periudhën që përfshin këtë vlerësim të jashtëm. GVJ Ju komunikua gjatë vizitës që këtë sistem e kanë parashikuar ta përdorin në të ardhmen</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ nuk pati mundësi të njihet me proces verbale apo procedurë tjetër të lidhur me komisionet e ngritura për provim.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ nuk ju paraqitën fletë provimi të kodifikuara.</p>

të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.				
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	I vetmi dokument që GVJ pati mundësi të shohë ishte një procesverbal notash pa komente, pa nota jo kaluese, dhe me firmë të vetëm një pedagogu.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Për të shmangur plagjiaturën apo kopjimin AI bazohet në rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Programit në lidhje me provimet. Bazuar në nenin 55 të Rregullores së Fakultetit "Studenti paraqitet në provim me librezën e studentit. Në mungesë të saj dhe për raste të vecanta mund të pranohet një dokument tjetër identifikimi. Pas dhënies së tezës, në provimin me shkrim nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik të Akademisë, me përjashtim të drejtuesit të Departamentit, të drejtuesit të Fakultetit apo persona të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të asistuar rregullsinë e kryerjes së provimeve.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në vartësi të formës së provimit me shkrim apo me gojë vlerësimi bëhet me një sistem notash nga 4-10. Rezultatet shpallen konform afateve të përmendura në rregullore.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas nenit 59 të Rregullores së Fakultetit: Ankesa për rezultatin e provimit <i>Ankesa i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit dhe për dijeni Dekanit dhe bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit (për parregullsitë gjatë zhvillimit të provimit) dhe në momentin e marrjes së përgjigjes së vlerësimit (për kontestimet që lidhen me vlerësimin). Ankesa depozitohet në Departament të Përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogu është i detyruar të kthejë përgjigje maksimumi brenda ditës së nesërme.</i> Edhe pse nga vizita me studentët u konstatua se nuk kishin dijeni për ndonjë rast kontestimi të notës në rregullore përshihet një procedurë e tillë.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ konstaton se Studentëve ju njihet e drejta e kontestimit të notës brenda 48 orëve. Kërkesa shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe më pas shpallet nota përfundimtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Duke qenë një profil i lidhur ngushtë me punimet protetike programi përfshin kryesisht lëndë të lidhura me këto punime duke filluar me llojet e ndryshme të protezave të plota dhe parçiale e me punimet e porcelanit dhe protezat mbi implante.			
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në program nuk përfshihet lënda e Informatikës. Ka vetëm një lëndë të lidhur me aparatet që përdoren në teknologjinë dentare.			
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në syllabuse përfshihen kompetencat dhe aftësitë e pritshme nga secili modul por në përfundim nuk ka analizë në lidhje me arritjen e këtyre objektivave.			
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Nuk dokumentohet si realizohet.			
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nuk dokumentohet realizimi i praktikave të tilla nga PAE dhe PAK por kanë organizuar disa ëorkshop me lektorë të huaj.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Përgjithësisht vërehet një koordimim midis tematikave të leksioneve dhe seminareve apo praktikave me qëllim që studenti pas njohurive teorike të realizojë procedurat laboratorike.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	AI duke patur një numër të vogël studentësh ka lehtësi në komunikimin e shtuar te PA me studentët.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nuk dokumentohen raste të tilla konkrete që të ketë nisur nga idea e studentit dhe të jetë konkretizuar me ndonjë punim shkencor.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nuk kanë patur ndonjë rast të mbështetjes financiare për studentët për kryerjen e punimeve apo studimeve kërkimore.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nuk ka raste të eksperiencave të tilla..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Sipas RVB faqe nr 33, referuar Rregullores së FTD, kreu XIX nenet 70,71 Akademia disponon procedurën e nevojshme për mbrojtjen e diplomës dhe provimit përfundimtar, ku studentët pas përfundimit me sukses të ciklit të studimit ju lind e drejta për tu diplomuar.</p> <p>Nuk kanë procedurë per provimin e diplomës. Përgjigja ndaj pyetjes së GVJ se si diplomohen studentët, ishte se studentët paraqiten me punim.</p> <p>Aneks/Shtojcë nr 3 Rregullore FTD, datë 2019-10-01</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Referuar Rregullores së FTD neni 70:</p> <p><i>Departamentet përcaktojnë listen e temave të diplomave në fillim të semestrit të parë të viti të tretë.</i></p> <p><i>Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga Dekani i Fakultetit.</i></p> <p><i>Neni 71</i></p> <p><i>Brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet u bëjnë njohur studentëve të viti të fundit të programit. Nëpërmjet Sekretarisë mësimore, informohen studentët reth organizimit të provimit të formimit.</i></p> <p>Nuk ka evidencë të mënyrës si asistohen studentët për përgatitjen e punimit të diplomës.</p> <p>Aneks/Shtojcë nr 3 Rregullore FTD, datë 2019-10-01</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar nenit nr 11 të Rregullores së programit të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Mbrojtja e diplomës/provimi bëhet para një komisioni të ngritur nga Dekani i Fakultetit, pasi studenti ka shlyer të gjithë detyrimet e tjera, të parashikuara edhe nga Statuti dhe Rregullorja e akademisë.</i> - <i>Vlerësimi i provimit të diplomës nga komisioni bëhet me notë.</i> <p>Nuk ka asnjë dokument që të reflektojë përbërjen e komisionit të provimit të diplomës. Në regjistër dhe në sekretari datat e diplomimit ishin të ndryshme.</p> <p>Aneks/shtojcë nr 4 Rregullore e Programit të studimit, datë 2019-10-01</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Në RVB faqe nr 34 citohet: “<i>Departamenti i Protetikës në fund të viti të tretë orienton studentët duke bërë të ditur listen e pyetjeve për provimin përfundimtar e cila miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Gjithashtu në semestrin e dytë të vitit të tretë në</i></p>

	<i>orën e fundit të secilës lëndë, pedagogët orientojnë studentët reth temave që mund të pyeten në provim”.</i> Nuk dokumentohet si ndihmohen studentët për përgatitjen e provimit.			
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nuk kanë praktika të tilla pune.			
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nuk aplikojnë mbrojtjen e një teme për diplomim, por studentët testohen me anë të provimit përfundimtar			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	<i>Bazuar në Regulloren e programit të studimit, neni 11 pika 2: Vlerësimi i provimit të diplomës nga komisioni bëhet me notë.</i> Procedura nuk u arrit të verifikohet. Aneks/Shtojcë nr 4 Rregullore e Programit të Studimit, datë 2019-10-01			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	AI pais studentët me Diplomë dhe suplement sipas formatit të miratuar nga MASR.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Krahas diplomës dhe suplementit studenti paiset edhe me kopjen e plotë të programit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Në sekretari ruhen për një afat të pacaktuar dosja e regjistrimit të studentit, lista e notave me të cilat mund të pajiset studentin në rast kërkese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë jo publik i emërtuar Akademia Ivodent, ka mbledhur dhe ruan çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik që është i angazhuar me implementimin e programit në fjalë. Zyra e burimeve njerëzore këto të dhëna i ka grumbulluar dhe i aktualizon çdo vit për anëtarët e personelit akademik që meret me implementimin e këtij programi studimi dhe për personin përgjegjës që meret me organizimin e punës, angazhimin e të gjithë anëtarëve të personelit akademik sipas semestrave dhe viteve akademike. Personi përgjegjës për realizimin e këtij program është A.M, me profesion Kimist, pasi drejtuesja e mëparshme K. L është larguar nga institucioni për një afat jo të shkurtër. Të dhëna të tilla në këtë institucion janë grumbulluar e ruhen edhe për personelin ndihmës mësimitor dhe për atë administrativ. Grumbullimi dhe ruajtja e të dhënave si dhe përditësimi çdo vit i tyre në këtë institucion bëhen sipas legjislacionit në fuqi e akteve nënligjore në zbatim të tyre, sipas Statutit të institucionit dhe Rregullores së programit të studimit. Zyra e burimeve njerëzore ndjek përmbushjen e detyrimeve kontraktore të punëmarrësve në përputhje me kërkesat e kodit të punës dhe atë të etikës profesionale. Punonjësit janë të paisur me kontrata pune me afat 1 vjeçar me të drejtë përsëritjeje, pra që përsëriten çdo vit. Në këto rrethana, kontratat që patëm rastin të shyrtojmë janë të lidhura në vitin 2019 edhe për PAE. Në nenin 11 të saj kontrata ka parashikuar se ajo mund të zgjidhet në çdo kohë kur punëmarrësi dëshiron të largohet edhe para përfundimit të saj. Në këto raste ai njofton me shkrim punëdhënësin dy muaj para largimit. Ky nen i kontratës për veçorinë e punës në institucion, na duket tepër i liberalizuar. Meqenëse punëmarrësi mund të mos e respektojë as afatin dy mujor të njoftimit paraprak (dhe kështu ka ndodhur), kjo e ve institucionin para faktit të kryer dhe largime të tilla në mes të procesit mësimitor kanë dëmton atë. Dokumentacion të plotësuar dhe kontrata pune janë lidhur edhe me personelin e marrë me kontrate (PAK).</p> <p>1. Statuti_Akademise_ivodent.pdf 4. Rregullore programi studimi_TLD.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar procedura të qarta për rekrutimin e personelit akademik. Ato janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e institucionit dhe në Rregulloren e programit të studimit. Për arsye të ngarkesës jo të madhe mësimore, pasi AI ka një numër disi të</p>

	<p>limituar studentësh, këto rekrutime nuk ka qenë nevoja të jenë të shpeshta. Shpesh rekrutimi i personelit akademik ka qenë i determinuar nga nevoja e specialitetit të ngushtë të fushës, çka i ka detyruar drejtuesit të mos jenë strikt në respektimin e procedurave. GVJ ju komunikua se pas riorganizimit të institucionit kanë patur dy largime të pa parashikuara në kontrata dhe janë detyruar të marin dy punonjës me komandim deri në kthimin e atyre që kanë qenë rekrutuar me parë sipas procedurave.</p> <p>1. Statuti_Akademise_ivodent.pdf 3. Rregullore Fakulteti_Ivodent.pdf 4. Rregullore programi studimi_TLD.pdf</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni ka hartuar procedura dhe kritere specifike për rekrutimin e personelit. Këto janë jo vetëm të qarta por dhe të harmonizuar me kërkesat e ligjit dhe aktet nënligjore. Ato janë të fiksuara në dokumentacionin e institucionit, në Statut dhe Rregulloren e njësisë kryesore dhe të programit të studimit. Për natyrën e punës këto kërkesa janë të përgjithshme, por edhe specifike që lidhen me karakterin dhe profilin e programit të studimit që ofrohet. Për një kohë jo të shkurtër, që ka lidhje me një pezullim të mëparshëm dhe riorganizimin e institucionit, nuk janë bërë rekrutime të reja. Kështu nuk u bë e mundur që të shqyrtojmë ndonjë praktikë konkrete rekrutimi të 2-3 viteve të fundit.</p> <p>1. Statuti_Akademise_ivodent.pdf 3. Rregullore Fakulteti_Ivodent.pdf 4. Rregullore programi studimi_TLD.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në AI procedurat e rekrutimit të personelit janë të qarta e të dokumentuara, të mbështetura në kritere të përgjithëshme dhe specifike. Është bërë përpjekje që ato të respektohen në përgjithësi lidhur me kriteret e përgjithëshme. Për vetë historikun e institucionit nuk ka qenë përherë e mundur që të plotësohen kriteret specifike që kërkohen për personelin akademik të këtij program studimi. Nga diskutimi i vëmendshëm i këtij problemi u konkludua se nuk ka qenë për herë e mundur të sigurohen specialistë të fushës përkatëse dhe nënspecialitete që kanë lidhje direkte me këtë program studimi, siç janë specialistët e protetikës dentare. Kjo ka bërë që disa lëndë të specialitetit të jepen nga specialistë të fushave të përafërta si stomatologë të përgjithshëm, mjekë të përgjithshëm dhe disa herë specialistë të fushës së Kimisë. Kriteret e përgjithëshme, lidhur me shkallen e kualifikimit të personelit dhe titujt shkencore janë plotësuar më mirë e kjo sidomos për PAK.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

Standardi IV.2**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimet e MASR dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit të mësipërm, Akademia Ivodent ka përgjegjësinë e plotë për cilësinë e personelit të ngarkuar për implementimin e këtij programi studimi. Ajo ka përgjegjësinë kryesore për sigurimin e kuadrit sipas kërkesave të ligjit, kualifikimit e trajtimit të tij të vazhdueshëm. Ajo duhet ta sigurojë atë sipas kërkesave që lidhen me profilin e studimeve që ka kryer, nënspecialitetin që ka dhe titullin ose gradën shkencore që zotëron, gjithmonë brenda fushës së programit të studimit që ka ofruar. Institucioni AI është angazhuar dhe përgjithësisht ka arritur të krijojë mjedis të përshtatshëm dhe kushte pune e studimi dhe mundësi të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Janë organizuar dhe funksionojnë njësitë e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive teorike dhe praktike si laboratore, salla leksionesh, mjedise pune e studimi (Aneksi 37). Të gjitha këto krijojnë mundësi normale pune për atë numur studentësh që ndjek aktualisht programin e studimit të Ciklit të parë Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”, gjithesej 59 studentë (viti I = 27 studentë, viti II = 16 studentë dhe viti III = 16 studentë). Për të qenë të gatshëm për të plotësuar kushtin e specifikuar si institucion i arsimit të lartë me deri 300 studentë, AI duhet të marrë masa të tjera plotësuese.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni AI është i angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe formimin e mëtejshëm profesional e shkencor të personelit që mbulon dhe është pjesë e implementimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”. Duke qenë se një nevojë e tillë është edhe kërkesë individuale e pjesëmarrësve në stafin akademik të këtij programi, institucioni mbështet dhe përkrah çdo iniciativë të PAE dhe PAK për pjesëmarrje në të gjitha aktivitetet shkencore e promovuese që realizohen sidomos në rafsh kombëtar, por sa herë është e mundur edhe në atë ndërkombëtar. Pjesëmarrja në konferencat kombëtare që zhvillohen periodikisht së paku një herë në vit dhe që janë akredituar për profesionistët e specialitetit nga Qendra Kombëtare e Edukimit në vazhdim (QKEV), janë ndjekur nga personeli akademik dhe për pjesëmarrje ata janë vlerësuar edhe me kredite.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm	Institucioni ka bërë përpjekje për të organizuar aktivitete lidhur me metodat inovative të mësimdhënies dhe përmirësimit të cilësisë së mësimit lidhur me anën teorike dhe praktike të tij. Leksionet e hapura, format e bashkëbisedimit e të komunikimit periodik midis

<p>profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>personelit, por dhe me studentët pjesmarrës si dhe kërkesa për të bashkëpunuar sa më shpesh e më mirë me klinikën dentare e kanë bërë më atraktiv të mësuarit dhe nxënjen e njohurive të reja të teknikës dentare. Janë bërë përpjekje për të azhurnuar personelin akademik, por edhe studentët me materialet dhe teknikat e reja që futen në përdorim. Një gjë e tillë është vlerësuar që sidomos personeli akademik dhe ndihmës akademik të marrë informacionin e duhur dhe në kohë që të ketë mundësinë për ta dërguar te studentët në kohë dhe me cilësinë e qartësinë e nevojshme. Ka përpjekje për të vënë në përdorim sistemin e marjes së masave dixhitale dhe duke bashkëpunuar me një institucion tjetër të mbyllet sistemi i skanimit dhe përfundimit të punimit. Këto për momentin janë në fazën e diskutimit dhe pritet që të lidhen marrveshtjet përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni AI dëshmon angazhim të burimeve njerëzore për përbushjen e qëllimit dhe të objektivave të këtij programi studimi. Në këtë program janë angazhuar specialistë e profesionistë me shkallë të ndryshme kualifikimi, me moshë e eskperiencë të ndryshme të cilat harmonizohen e bashkëveprojnë në dobi të realizimit të tij. Një pjesë e mirë e personelit akademik kanë eksperiencën e nevojshme pedagogjike, pasi vinë nga fusha e arsimit, kryesisht me specialitet kimist, ku kanë kontribut të dukshëm në atë fushë. Lidhur me specialitetin e stomatologjisë, pjesmarja e tyre në këtë program studimi, sidomos ajo e specialistëve të ngushtë të fushës së protezave dentare duhet të ishte më e mirë. Sidoqoftë, bashkëveprimi i specialistëve të fushave të ndryshme, kimistë, mjekë të përgjithshëm, stomatologë të përgjithshëm e ka zbutur disi problemin, shoqëruar kjo dhe me përkushtimin e organizatorëve, ka bërë që studentët të ndjehen në rrugen e duhur për realizimin e programit (Aneksi 33).</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me</p>	<p>Institucioni arsimor AI, ka siguruar mjediset mësimore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore që zhvillojnë mësim. Duke qenë se numri i studentëve është relativisht i kufizuar dhe vetem viti i parë kalon numrin 20, mësimi sipas viteve mësimore edhe në praktikë zhvillohet në një grup. Në</p>




<p>natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>RVB është përdorur disa herë termi “institucion i vogël”, por GVJ mendon se institucionet arsimore maten me standarte pavarësisht numrit të studentëve që frekuentojnë.</p> <p>Sipas vlerësimit të vetë institucionit (në f. 38 të RVB), procesi mësimor edukativ në këtë institucion, zhvillohet në një sipërfaqe të përgjithëshme prej 676 m² në dispozicion të një kontigjenti prej rreth 60 studentësh dhe rreth 20 vetë prsonel akademik. Gjatë detajimit të sipërfaqeve është raportuar se në dispozicion të procesit mësimor edukativ janë: salla leksionesh me kapacitet 17 studentë që ka sipërfaqe 33 m², salla e seminareve 35 m², salla e konferencave me 25 vende që ka sipërfaqe 30 m² dhe biblioteka me sipërfaqe 30m², të gjitha këto së bashku në një sipërfaqe prej 128 m². GVJ nuk ka bërë matje dhe i konsideroi të mirëqena të dhënat e vetë institucionit. Mjediset u kontrolluan në vend dhe u gjetën të paisura sipas funksionit, të mirëmbajtura dhe në gjendje pune (Aneksi 37).</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore, salla e leksioneve, laboratorët janë të paisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Ato garantojnë kushte optimale pune, ndriçim natyral dhe me energji elektrike, ajrosje dhe kubaturë të mjaftueshme e sipas kërkesave të nevojshme dhe janë të mirëmbajtura. Në këto kushte ato mundësojnë realizimin e procesit mësimor si nga ana teorike dhe ajo praktike. Kushtet e krijuara në laboratore, paisja me aparatura dhe baza materile në përdorim bëjnë të mundur zhvillimin e mësimimit në kushte normale, marjen e informacionit dhe të teknikave të reja e të kohëve më të fundit. Kjo e bën të mundur realizimin e teknikave dhe teknologjive të kohës në fushën e mësimdhënies dhe të mësim nxënies.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët në këtë institucion (po ashtu sipas të dhënave të vetë institucionit), janë organizuar si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Laboratori funksional me siperfaqe 54 m², 2) Laboratori i protezës fikse me 57 m², 3) Laboratori i protezës së lëvizëshme 15 m² 4) Laboratori i teknikave dixhitale 28 m². <p>Sipërfaqja e laboratoreve në dispozicion të programit është në total 154 m². Dimensionet u konsideruan të mirëqena dhe inspektimi që u krye në vend u bë lidhur me plotësimin e kushteve që përmbushen nga ana e tyre në funksion të procesit mësimor. Rezulton se ato janë në kushte optimale pune dhe ishin në gadishmëri e funksion të plotë. Paisjet e laboratoreve janë sipas kërkesave të programit. Bashkëpunimi me kompaninë Ivoclar dhe kompani të tjera të njohura është një avantazh i këtij institucioni lidhur me paisjen cilësore me aparatura e materiale cilësore e të kohës. Lidhur me siperfaqet në dispozicion të programit mund të bëhet një objeksion i tillë: Nëse sipërfaqja totale është 676 m²,</p>

	<p>sipërfaqja në funksion të procesit mësimor (labororet, sallat dhe biblioteka) është 282 m². Mbetet që diferenca prej 394 m² të jetë sipërfaqe ndihmëse. Një raport i tillë, ku rreth 60% të sipërfaqes e zënë hapësirat ndihmëse do të ishte më mirë të ishte i inversuar në favor të sipërfaqes në funksion të procesit mësimor. Në sipërfaqe ndihmëse ishte llogaritur edhe një hapësirë midis pallateve, me sipërfaqe afro 300 m², për të cilën na u tha se përdoret nga studentët në kohën e lirë dhe për argëtim. Për sipërfaqen në dispozicion të procesit mësimor dhe numrin e studentëve që vijojnë studimet në këtë program, raporti rezulton të jetë 5 m² për një student. Edhe shpërndarja e sipërfaqes sipas laboratorëve mund të ishte më proporcionale, pasi pavarësisht peshës specifike në programin e studimit, në laboratore do të zhvillojë mësim i njëjti numur studentësh psh si në protezë fikse dhe në atë të lëvizëshme do të jetë po ai grup studentësh dhe sipërfaqja dhe kushtet duhet të jenë optimale njësoj.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një laborator të teknologjisë së informacionit të paisur me programe profesionale që shfrytëzohen prej studentëve. Është e nevojshme të thuhet se përveç personelit mësimor, në këtë institucion është i punësuar me kohë të plotë një specialist IT që ndihmon në mirëmbajtjen e tyre dhe aksesimin nga ana e studentëve në këto programe. Në Institucionin AI ofrohet qasja në botën online nëpërmjet ębsite zyrtar të tij ku përditësohen të dhënat e përditëshme të jetës arsimore në akademi (Aneksi 37).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Në këtë institucion ka infrastrukturë të nevojshme, mjaftueshëm për numrin e studentëve që ka regjistruar dhe që vijojnë në të tre vitet e studimit. Kushti i Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” që përcakton se për Institucionet e tipit Akademi duhet të jenë të përgatitur për të përballuar një numur deri në 300 studentë, momentalisht nuk plotësohet. Mjediset për zhvillimin e praktikave profesionale dhe praktikave e veprimtarive të tjera janë të posaçme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit për këtë kontingjent studentësh që vijojnë aktualisht studimet.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni AI ka vënë në dispozicion të studentëve të tij një Bibliotekë të paisur edhe me rreth 10 kompjutera dhe vende pune ku studentët mund të lexojnë dhe të studiojnë. Biblioteka ka kushte normale dhe orar të aksesueshëm nga studentët. Ka lidhje me internet dhe mundësinë e përdorimit online të një bibliotekë të huaj të fushës së mjekësisë. U kërkua që të aksesohet ndonjë revistë e huaj e profilit të stomatologjisë dhe e fushës së protezave dentare gjë që nuk u arrit të realizohej. Është në traktativa për të siguruar bashkëpunim me rrjetin akademik shqiptar dhe shfrytëzimin e online të fondit të tyre, por ende kjo nuk është realizuar. Institucionit ju kërkua një listë e tuajve të librave dhe revistave që ka në inventar dhe e numrit të tyre, por kjo nuk u arrit të sigurohej (Aneksi 11).</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Literatura hard copy që disponohet në bibliotekën e institucionit është modeste. GVJ nuk pati rastin të aksesonin tekste bazë apo dhe tekste ndihmës të mjaftueshëm në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj. Gjatë intervistës, GVJ ju referua se mësimet zhvillohen kryesisht me leksione të shtypura dhe këto administrohen në sekretarinë e institucionit. Aksesit që Akademia ka online në bibliotekën e huaj Hinari i përket fushës së mjekësisë, ndaj dhe u kërkua një listë e revistave të specialitetit të stomatologjisë dhe kryesisht e Protetikës dentare që mund të shfrytëzohen prej saj dhe që ka lidhje direkte me këtë program studimi. Kjo listë GVJ nuk ju vu në dispozicion .</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni AI ka krijuar kushte normale studimi në bibliotekë dhe akses të barabartë për të gjithë studentët që duan ta shfrytëzojnë atë. Shfrytëzimi i bibliotekës online, bile dhe disa facilitete të tjera për studentët ofrohen pa pagesë. Orari bibliotekës është i përshtatshëm për studentët, ajo mund të frekuentohet jo vetëm gjatëq orarit të mësimit, por dhe pas tij pasi qëndron e hapur deri në orën 18.00 pas dite. Në RVB (f.41) sqarohet se Akademia është në përpjekje për të realizuar bashkëpunimin me rrjetin akademik shqiptar me qëllim shfrytëzimin pa pagesë nga studentët e Akademisë të bibliotekave online që disponon ky institucion. Pavarësisht shkallës së realizimit të objektivave të këtij institucioni në këtë fushë, asetet që ka mundur të sigurojë deri tani ky institucion i ofron për studentët e tij pa pagesë.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e Akademisë është e paisur me programe kompjuterike, aktualisht ka kapacitet për 10 vende dhe ka internet free gjatë gjithë kohës. Ajo është e aksesueshme nga studentët që nga ora 8.00 e mëngjezit, ka ndriçim dhe ajrosje normale. Në bibliotekë është i punësuar një punonjes i cili ka njohuri të thelluara në fushën e IT dhe është mundësia që ti asistojë studentët gjatë kërkesave apo pengesave me të cilat hasen. Në këtë institucion pranohet nga stafi akademik dhe ndihmës se mundësia për të aksesuar online revista</p>

	të huaja është vetëm në fushën e mjekësisë dhe po bëhen përpjekje për të shkuar drejt profilit të ngushtë që lidhet me programin e studimit.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Në institucionin AI ka plane dhe bëhen përpjekje për të bërë të mundur shtimin e zërave të bibliotekës dhe tirazhin e tyre. Duhet pranuar se biblioteka ka nevojë të organizohet e të pasurohet me tekste e libra në funksion të programit të studimit. Ajo duhet të largohet nga imazhi i një biblioteke private dhe të marrë formën e një biblioteke institucioni të arsimit të lartë me tekste bazë e ndihmës dhe revista të fushës së protezave e të teknikave dentare. Në Syllabuset e lëndëve përshkruhen tekste bazë të nevojshëm për studentët, kryesor dhe ndihmës dhe institucioni duhet ti siguroje ato për bibliotekën e tij. U pa dashira e mirë për ti zgjidhur këto probleme, por rruga sapo ka filluar. (Aneksi 11).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e Akademise me inventarin dhe kapacitetet që ka, është në dispozicion të studenteve të saj në orare të përshtatshme. Ajo është e hapur si gjatë orarit të mësimit por edhe jashtë tij. Studentët mund ta shfrytëzojnë atë nga ora 8.00-18.00 të çdo ditë mësimi. Ajo ka vende pune e studimi për 10 studentë, çka për numrin e studentëve që frekuentojnë sot nuk e zgjidh plotësisht problemin. GVJ mendon se për pretendime të mëtejshme ajo duhet të riorganizohet si lidhur me kapacitetet e saj e vendet e studimit, ashtu edhe lidhur me kompletimin me tituj të librave e revistave të shtypura e të pranishme fizikisht ose dhe ato online. Përveç numrit të pranishëm të librave e revistave lypet të përmirësohet struktura e tyre duke i shërbyer specifikisht programit të protetikës dentare (Aneksi 11).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni Akademia Ivodent nuk ka një sistem të centralizuar të menaxhimit institucional për shkak të numrit të kufizuar të studentëve dhe se është në fillesat e tij me programin e riorganizuar të studimit Bachelor në "Teknikë e lartë dentare". Një fakt i tillë u konstatua gjatë kontrollit në institucion dhe është pranuar prej tij edhe në RVB (f.42). Është në hapat e para implementimi i strategjisë ku shërbimet teknologjike vihen në shërbim të personelit akademik dhe të studentëve. Ka të dhëna të dokumentuara dhe

	<p>informacion të mjaftueshëm lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre (Aneksi 19/3). Ky dokumentacion ruhet e mirmbahet sipas kërkesave të ligjit në Sekretarinë mësimore dhe i përket periudhës që nga pranimi e regjistrimi i studentëve dhe pasurohet në vazhdimësi. Studentët kanë aksesin e nevojshëm lidhur me të dhënat e përparimin e tyre gjatë gjithë procesit të realizimit të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administro informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të institucionit shtrihet dhe funksionon edhe lidhur me të dhënat për personelin akademik, atë ndihmës akademik dhe personelin administrativ të angazhuar në realizimin e këtij programi. Kanë filluar kontakte me RASH (rrjeti akademik shqiptar) për futjen e shërbimit të sekretarisë mësimore, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe aksesin në libraritë online. Aktualisht për këtë proces përdoren mënyra tradicionale si për të dhënat që lidhen me studentët, ashtu edhe për ato të stafit akademik dhe ndihmës të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit siguron informacion e dokumentacionin e nevojshëm për studentët në çdo periudhë të studimit përmes sekretarisë mësimore. Dokumentacioni i kërkuar prej tyre ofrohet në kohë dhe kur është e nevojshme shërbehet e printohet pa pagesë nga ana e institucionit. Gjithashtu të dhënat që lidhen me personelin akademik dhe atë ndihmës ruhen e aktualizohen nga ana e zyrës së burimeve njerëzore dhe përmbajnë informacionin e duhur për të gjithë stafin akademik e personelin administrative. Të dhënat konfidenciale ruhen sipas udhëzimeve të dhëna. Personeli ka aksesin e nevojshëm lidhur me të dhënat që administrohen nga ana e institucionit AI.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Funksionon sistemi i informacionit online nëpërmjet faqes së Institucionit AI, çka u jep mundësi studentëve që të logohen në kohë reale përmes internetit në çdo kohë dhe kudo që ndodhen. Secili student e ka mundësinë ku të logohet dhe të marrë informacionin e duhur personal. Po ashtu u jepet mundësia studentëve që të realizojnë forma të komunikimit interaktiv dhe të shkëmbejnë informacion me stafin akademik e atë ndihmës. Nga ana e studentëve përdoren gjerësisht rrjetet sociale facebook, instagram, ehats up dhe viber çka ju mundëson komunikim e informacion të shpejtë lidhur me programin e studimit dhe aktivitetet e jetën e institucionit.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Akademia Ivodent realizon monitorim të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe jep informacion të mjaftueshëm e real për organet drejtuese të Akademisë si dhe për drejtuesit e saj. Informacioni lidhet edhe me të gjitha procedurat e nevojshme që shoqërojnë aktivitetin në këtë institucion duke përfshirë faqen zyrtare të tij ku ka të dhëna lidhur me procedurat e pranimit, regjistrimit, kostot e studimit dhe mënyrën e organizimit dhe</p>

	menaxhimit të Akademisë. Përveç faqes së institucionit, puna është e organizuar që studentët të kenë informacion dhe komunikim të vazhdueshëm, të drejt për drejtë me stafin akademik dhe atë administrative (Aneksi 37). Kjo mënyrë direkte komunikimi ofron mundësi për raporte interaktive në mardhëniet midis pedagogëve dhe studentëve. Studentëve u krijohet mundësia e informacionit të shpejtë për gjithë ecurinë e procesit të të mësuarit në këtë institucion, rezultatet e arritura në kontrollet e ndryshme të dijeve, të provimeve, por dhe u jep atyre hapësirë diskutimi me stafin lidhur me interesat e personalizuara që kanë.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacioni që jepet në faqen e internetit të institucionit është i publikuar në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze siç konfirmohet edhe në RVB. Në faqen zyrtare ka të publikuara të dhëna informuese që lidhen me organizimin e institucionit, me programin e studimit dhe kurrikulën e tij, me stafin akademik dhe atë ndihmës e administrativ. Në të jepen njoftime të ndryshme që lidhen me procesin mësimor e ecurinë e tij, por edhe njoftime të tjera për aktivitetet e ndryshme që organizohen në funksion të tij apo në kohën e lirë. Aktivitetet dhe informacioni që jep institucioni publikohet në faqen e tij eeh.ivodent.edu.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Krijimi dhe administrimi i burimeve financiare të institucionit AI është disi kompleks. Thuhet se shoqëria ka hartuar një plan të detajuar që e mbështet institucionin në këtë drejtim. Pezullimi i realizuar përkohësisht nga MASR dhe numri i kufizuar i studentëve nuk i kanë dhënë mundësinë e duhur këtij institucioni për të patur burime të mjaftueshme financiare nga të ardhurat që lidhen direkt me aktivitetin e tij. Këtë fakt e kanë njohur hartuesit e RVB dhe e pranoi me sinqeritete vetë Rektori i Akademisë. Ai paraqiti si një nga mundësitë e financimit edhe Kompaninë e njohur Ivoclar Vivadent e cila ka marrëdhënie me këtë institucion, e ndjek dhe mbështet atë dhe ka qënë mbështetja e saj që në krye të herës që ka nxitur hapjen e një shkolle për laborantë dentar që në fillimet e aktivitetit të Kompanisë sonë me sistemin dyvjeçar. Me një veprim të tillë ajo ka patur si synim të promovojë materialet që prodhohen e tregtohen prej saj dhe teknikat e përdorimit të tyre

	edhe në vendin tonë. Përveç pohimit me gojë të Rektorit, në Institucion nuk ka ndonjë kontratë të rinovuar lidhur me këtë problem.
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e paraqitura në RVB dhe informacionet që na u dhanë gjatë ballafaqimit në institucion, AI ka ngritur një strukturë që është Bordi i Administrimit të Institucionit i cili krahas detyrave të tjera ushtron edhe atë për hartimin e zbatimin e buxhetit në nivel të institucionit. Ky proces që fillon nga njësitë bazë, bën të mundur sigurimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e programit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” (Aneksi 4). Nuk është kreu i qartë buxheti i nevojshëm për financimin e burimeve njerëzore, pasi një pjesë e personelit akademik dhe atij ndihmës e administrativ është në raporte familjare, meqenëse një biznes i tillë është konceptuar që në krye të herës si një biznes kryesisht familjar. Mirëmbajtja e mjediseve, paisjeve dhe aparturave është realizuar përgjithësisht mirë për çka ka dhe traditë nga një shkollë e mëparshme e laborantëve dentarë që ka funksionuar pranë kësaj kompanie. Biblioteka ka nevojë të pasurohet më tej me libra e Revista të profilit të protezave dentare. Po kështu biblioteka online që ishte drejt finalizimit të saj duhet të siguroj akses të shpejtë jo për të gjithë literaturën mjeksore (pasi është një oqean), por për libra e revista të stomatologjisë, kryesisht të fushës së protetikës që është specifike e lidhet me programin e studimit në fjalë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni ka planifikuar të kryej auditim financiar në përfundim të vitit akademik, pasi viti shkollor 2019-2020 është viti i parë ku janë kryer regjistrime që lidhen me implementimin e programit të riorganizuar 3 vjeçar të nivelit Bachelor. Pas miratimit të stautit të ri i cili është hartuar në zbatim të kërkesave të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” në Republikën e Shqipërisë, i gjithë procesi i administrimit financiar bëhet sipas kërkesave të ligjit (Aneksi 4). Auditimin e brendshëm financiar e kryen audit i shoqërisë dhe pasqyrat financiare të institucionit pritet të bëhen publike çdo vit. Ky institucion pretendon se ka qenë në proces mbikqyrës nga MASR, prandaj Akademia i është nënshtruar një procesi monitorimi financiar të vazhdueshëm, janë dhënë informacione e kryer raportime edhe lidhur me këtë problem në mënyrë periodike (Aneksi 31, 31/1).</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Cikli i plotë i studimeve në Programin Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” është hapur në vitin akademik 2019-2020 dhe pritet të përfundojë pas 3 viteve të plotë akademike. Një analizë e plotë sipas kërkesave të këtij kriteri pritet të bëhet aty nga Qershori i vitit 2022. Financimi i këtij programi studimi realizohet kryesisht nga tarifat e studentëve dhe nga të ardhurat e Kompanisë Ivodent shpk. Pretendohet se ka mbështetje edhe nga Kompani ndërkombëtare të fushës së materialeve dentare, por GVJ nuk pati mundësi të</p>

	aksesonim ndonjë dokument të shkruar lidhur me këtë problem. Raporte dhe analiza financiare vjetore të institucionit, plani i mbështetjes financiare për një cikël të plotë studimi, tarifa e shkollimit janë hartuar nga AI dhe i janë bashkëngjitur RVB në anekset e tij.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Me dokumentacionin që ka paraqitur dhe raportimet që u bënë gjatë verifikimit në teren, Institucioni AI ka hartuar një politikë transparente lidhur me sigurimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare të nevojshme për realizimin normal të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Numri i studentëve të regjistruar për ndjekjen e këtij program studimi ka tendencë rritjeje dhe Akademia raporton se ka situatë financiare të qëndrueshme. Informacion më i plotë e i besueshëm për situatën financiare do mund të sigurohet në fund të ciklit të plotë të studimeve Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” (Aneksi 7/1, 19).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni AI ka hartuar Rregulloren e Institucionit dhe një Rregullore të veçantë që lidhet me programin e studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”. Hartimi i rregullores së programit të studimit përmban procedurat e fillimit, vijimit deri në përfundimin e ciklit të plotë të studimeve në këtë program. Kërkesat e Rregullores së programit të studimit janë të hartuara konformë kërkesave të ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”, Udhëzimet e MASR dhe të ASCAL. Ato janë konformë akteve nënligjore në fushën e arsimit dhe me aktet e vetë Institucionit që ofron programin. Politikat e hartuara në këtë drejtim synojnë të paisin studentët me dije bashkëkohore e të qëndrueshme në fushën e teknikave të protezimit të dhembëve. Studentët në këtë program diplomohen pasi kanë kryer të gjitha detyrimet teorike dhe praktike të studimeve të ciklit të parë. Në përfundim të tyre ata i nënshtrihen një provimi të përgjithshëm përfundimtar i cili kryhet pas një punimi praktik të diplomës. Në përfundim të të gjitha këtyre kërkesave studentët paisen me diplomë Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”(Aneksi 25/1).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politika e institucionit sipas rregullores së këtij programi studimi të ciklit të parë, bën të mundur që në të pranohen e vijojnë pa kushte penalizuese të gjithë ata kandidatë që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe janë shpallur fitues të maturës shtetërore. Në nenin 4 të Rregullores është përcaktuar: Për regjistrim studenti duhet të paraqesë këto dokumenta:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Diplomë e shkollës së mesme origjinale, 2. Dokumentin e identifikimit, 3. Raportin mjekësor që dëshmon aftësinë e kandidatit për studime, 4. Dy fotografi. <p>Me fillimin e studimeve kandidati paiset me librezën e studentit. Pranimi i kandidatëve bëhet në respektim të kapaciteteve të institucionit dhe të kuotave të miratuara. Në këtë program studimi mund të pranohen edhe kandidatë që kanë ndjekur më parë cikle të tjera studimi. Ata pranohen pasi kanë paraqitur dokumentacionin e studimeve të mëparshme. Në këtë rast vlerësimi dhe njohja e krediteve për arsimin e kryer më parë bëhet me vendim të njësisë bazë të Institucionit e cila pranon studentin sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj dhe në atë të programit të studimit. Këto kritere janë të garantuar dhe zbatohen në mënyrë të drejtë e të</p>

	barabartë për të gjithë ata studentë që regjistrohen dhe ndjekin programin e studimeve Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” (Aneksi 3).
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Politikat e institucionit AI janë transparente lidhur me kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe të ndjekjes së studimeve në këtë program studimi. Ky program studimi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Studenti në përfundim të këtij program studimi duhet të grumbullojë 180 kredite. Transferimi i krediteve nga një program tjetër studimi, njohja e studimeve të kryera në ndonjë program të plotë apo të pjesshëm studimi janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit. Procedurat dhe rregullat për këtë proces janë të qarta e të kuptueshme për studentët dhe të interesuarit. Ky informacion që është i aksesueshëm për ata që kanë interes është transparent dhe i mundshëm për tu aksesuar nga publiku edhe në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të këtij institucioni (Aneksi 3).
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	GVJ mendon se për vetë karakterin e studimeve në këtë program nuk është e nevojshme të ketë kritere specifike shtesë për kandidatët përveç atyre që u prezantuan në kriterin nr.1 të këtij standarti. Nëse do të duhet të vendosej ndonjë kriter i veçantë, do të ishte e preferuar që kandidatët të kishin aftësi të spikatura në punë me dorë dhe prirje disi artistike e njohuri për ngjyrat dhe përmasat e objekteve. Duke qenë se ky profesion ka karakter të dukshëm manual, por ai përfitohet gjatë 3 viteve studimi ku kryhen orë të obligura të praktikës profesionale, e kush dëshiron edhe te praktikave jashtë orarit të mësimit e studimit, këto prirje e aftësi të veçanta përfitohen gjatë të ushtruarit dhe praktikave mësimore e profesionale. Për këto probleme ka qartësi dhe në një farë mënyre u bëhet e ditur kandidatëve që në fillim apo në orët e para të programit se natyra e punës së tyre kërkon durim dhe ushtrim të vazhdueshëm.
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme janë hartuar dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të MASR për arsimin dhe maturën shtetërore në Republikën e Shqipërisë. Kriteret specifike për këtë program studimi nuk janë parashikuar, kështu mundësia për tu regjistruar dhe për ta kryer atë është e lirë dhe varet nga preferencat e kandidatëve. Mundësia e regjistrimit në të dhe e ndjekjes së këtij programi studimi është e mundur edhe për studentë të huaj që dëshirojnë ta kryejnë atë, me kushtin e vetëm që duhet të zotërojnë gjuhën shqipe. Aktualisht në këtë program nuk ka studentë të huaj. Ka disa studentë të regjistruar nga trevat shqipfolëse sidomos nga Kosova, të cilët ndjekin këtë program studimi dhe janë të kënaqur me zgjedhjen që kanë bërë (Aneksi 3).
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në	GVJ ju komunikua se para fillimit të këtij program studimi, Institucioni AI ka bërë një punë të veçantë propoganduese e

<p>lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>sqaruese me kandidatët për studentë, bile dhe me familjet e tyre. Kjo përmbledh një informacion të mjaftueshëm për përmbajtjen e këtij programi studimi, për regjistrimin e përvetësimin e tij, për kushtet e studimit në këtë institucion deri edhe për vendet dhe mundësinë e punësimit të atyre që zgjedhin e studjojnë në këtë program. GVJ shprehet se Akademia Ivodent e ka kryer këtë detyrë në disa mënyra. Së pari ajo ka angazhuar në këtë proces disa anëtarë të stafit akademik të cilët i ka trajnuar paraprakisht me të dhënat kryesore të institucionit dhe të programit të studimit. Ata janë shpërndarë në shkollat e mesme në Tiranë e në rrethe, bile edhe në trevat shqipfolëse në vëndet e rajonit dhe kanë dhënë informacion lidhur me programin e sqarime plotësuese sipas kërkesave të të interesuarve. Kështu është bërë promovim i institucionit dhe i programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”. Së dyti informacion i mjaftueshëm jepet lidhur me institucionin dhe programin e studimit në fjalë edhe në faqen zyrtare të Akademisë në adresën: (www.ivodent.edu.al) Ndërkohë Akademia Ivodent e promovon programin e studimit edhe nëpërmjet rrjeteve sociale dhe të medias (Aneksi 37).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ konstaton se pas regjistrimit në këtë program studimi, studenti e ka në dispozicion informacionin e duhur që lidhet me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik në çdo vit studimi dhe kalimin nga njëri vit në tjetrin deri në përfundim të studimeve. Një burim i qartë informacioni lidhur me këtë problem është Rregullorja e studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”. Edhe pedagogët e lëndëve e stafi akademik e administrativ paraqesin herë pas here kërkesat dhe detyrimet e studentëve lidhur me procedurat e përparimit të studentëve gjatë vitit dhe në vazhdim gjatë 3 viteve akademike. Një punë të diferencuar në këtë drejtim bën sekretaria mësimore e Fakultetit të Teknikave Dentare në AI. Në dispozicion të studentëve për të dhënë informacionin e nevojshëm që lidhet me përparimin e tyre akademik është edhe një zyrë për mbështetjen e studentëve e cila bashkëpunon periodikisht dhe sjellë informacionin e nevojshëm për përparimin e tyre dhe gjithë</p>




	mbarvajtjen e procesit të realizimit të këtij programi studimi (Aneksi 4).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Procedura për njohjen dhe kriteret e kualifikimeve të mëparshme janë bërë të qarta për studentët e AI. Procedurat që ndiqen lidhur me këtë proces janë të specifikuar në rregulloren e institucionit dhe sidomos në rregulloren e programit të studimit. Në këtë program studimi ka studentë që kanë kryer më parë programe të tjera të arsimit të lartë shqiptar. Ata janë regjistruar dhe vijojnë studimet në këtë program sipas procedurave të hartuara në rregullore e të bëra transparente për të interesuarit. Kualifikimet e mëparshme apo studimet e pjesëshme njihen nga ana e institucionit, shqyrtohen nga komisione të posaçme, konvertohen në kredite dhe shërbejnë për vlerësimin e modulit, të lëndës apo të lëndëve të kryera me parë (Aneksi 10,22/1).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni informon studentët lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve të tyre në fillim të programit dhe vazhdimisht në vijimësi të tij. Në rregulloren e programit të studimit është qartësuar se detyrimet e studentit duhen përmbushur në të gjitha aspektet e procesit mësimor, në leksione e seminare, ndërsa në praktikat profesionale ato duhet të përmbushen në masën 100% për të fituar të drejtën e vlerësimit teorik të dijeve të tyre. Kontrolli i dijeve bëhet për çdo temë, modul apo lëndë, në mënyrë teorike, me pyetsorë, me zhvillime ushtrimesh në lëndët teorike, por dhe me punime praktike që kryhen vazhdimisht deri në përvetësimin e plotë të programit. Lidhur me këto kriteret dhe procedurat që ndiqen për rivlerësimin e dijeve, përveç informacionit në rregullore, jepen informacione periodike në çdo lëndë e disiplinë deri në përfundim të programit (Aneksi 3,4).
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kontigjenti i studentëve që ndjek programin e riorganizuar të studimeve Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” është në vitin e parë të realizimit të tij. Kështu informacioni lidhur me këtë problem nuk ishte i qartë. Në RVB është theksuar se: “kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës janë përcaktuar qartë në Rregulloren e Fakultetit të Teknikave Dentare, por programi i studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” nuk parashikon punimin e temës së Diplomës nga studentët” (f.48). Duke qenë se në këtë Fakultet ky program studimi është i vetmi program që është ofruar aktualisht, atëhere lind pyetja për kë janë rregullat e qarta në rregullore. Në rregullore është parashikuar se Dekani i Fakultetit përcakton temat e diplomës si dhe udhëheqësit e Diplomave, por RVB thotë se nuk ka tema diplome për këtë program. Nga diskutimi me studentët dhe personelin akademik u konsiderua si më e arsyeshme që për këtë program studimi të ketë një punim praktik diplome dhe pas tij një provim teorik formues. Ky problem

	mbetet ne diskutim për tu zgjidhur përfundimisht në të ardhmen (Aneksi 3).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Para fillimit të çdo viti akademik, por edhe në mënyrë periodike, institucioni AI publikon të dhëna e jep informacion lidhur me programin e studimit që ofron, kriteret për tu regjistruar e procedurat e tij, mundësitë e përgatitjes e të formimit profesional dhe informacionin e fundit lidhur me mundësinë e punësimit të atyre që e ndjekin atë. Në institucion ka pjestarë të stafit akademik që janë trajnuar dhe në grupe pune kanë kryer takime në institucione arsimore parauniversitare dhe kanë dhënë informacionin e duhur lidhur me përmbajtjen dhe zhvillimin e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” (Aneksi 22/1). Informacioni i dhënë përfshin të dhëna për institucionin, infrastrukturën e tij, mjediset, auditoret, labororet, licensimin e programit, kompanitë bashkëpunuese etj. Informacioni përmban edhe një formular të nevojshëm për aplikimin e kandidatëve dhe dokumnetcionin e nevojshëm për ata që dëshirojnë të regjistrohen. Informacioni për këtë problem përfshin edhe të dhëna për sistemin e Bolonjës, lëndët dhe kreditet e nevojshme, stafin akademik dhe atë administrativ e ndihmës të Institucionit dhe të programit të ofruar. Kjo është patur parasyshtë të zhvillohet edhe në hapsirat shqipfolëse jashtë trojeve të shtetit shqiptar (Aneksi 22, 22/1).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informacion i qartë ju bëhet studentëve lidhur me programin e studimit në fjalë jo vetëm në periudhën para ardhjes e regjistrimit të tyre në të. Ky informacion zhvillohet në detaje edhe pas regjistrimit të kandidatëve, kryhet në vijimësi e në mënyrë periodike. Studentët e vitit të parë që kanë pranuar të behën pjesë e programit të Akademisë Ivodent, në ditët dhe javën e parë kanë marrë informacion real lidhur me Institucionin dhe janë njohur nga afër me të. Ata janë prezantuar me ambjentet e institucionit, sekretarinë, labororet, sallën e informatikës etj. Gjithashtu atyre u është bërë një prezantim i lëndëve që do të zhvillojnë në vitin e parë, pedagogët që do ti zhvillojnë ato dhe syllabuset për çdo modul e lëndë të veçantë. Ky informacion përfshin të dhëna edhe

	lidhur me mënyrën e vlerësimit të dijeve në vazhdimësi të zhvillimit të programit dhe sesionet e provimit e mënyra e zhvillimit të tyre si dhe mënyra e vlerësimit të dijeve gjatë tyre.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Dokumentacion i shkruar lidhur me informacionin që u jepet studentëve rreth programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” konsiderohen rregulloret e institucionit dhe ato të programit të studimeve. Ky institucion ka të botuara broshura publicitare mbi veprimtarinë e AI dhe të kompanisë që e mbështet atë. Gjatë kontrollit në Institucion nuk u bë e qartë emri i pedagogut tutor të vitit të parë edhe gjatë intervistës me studentët atij kursi, u insistua që detyrën e tutorit e kryejnë pedagogët e praktikave profesionale dhe kjo gjëndet si procedurë normale.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ shprehet se në këtë institucion ka informacion edhe lidhur me mundësinë e punësimit pas përfundimit të studimeve. Duke patur përvojën e mëparshme të vizitës në nstitucion u insistua në praninë e ndonjë studimi lidhur me tregun e punës, metodologjinë dhe rezultatet e një studimi të tillë. Kjo temë është bërë një farë sllogani që të gjithë e përmendin, por realisht nuk e kanë. Megjithatë, është e natyrshme që diskutime të tilla të ketë, pasi në fund të fundit ky program, apo dhe programe të tjera studimi bëhen me qëllimin që të mundësohet një punësim i shpejtë i atyre që e kanë kryer me sukses atë. Në RVB nga dëshira për ta zgjeruar mundësinë e fushave ku mund të punësohen kandidatët pas përfundimit të studimeve në këtë program, është sugjeruar edhe punësimi në spitale (f.16). Ndonjë rast i tillë nuk u konstatua. Por bashkëpunimi me Klinika e laboratore i ka dhënë akses institucionit të ketë informacion lidhur me vëndet bosh në institucionet e shërbimit dentar. Kjo ka bërë që shkalla e punësimit të laborantëve që kanë studjuar në këtë institucion të jetë e mire.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve që janë regjistruar për të ndjekur studimet në programin Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” u jepet informacion i qartë e i vazhdueshëm lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. Kjo bëhet si nga strukturat administrative, por edhe nga ato akademike në vazhdimësi. Informacioni i nevojshëm jepet edhe lidhur me logjistikën dhe gjithë infrastukturën e institucionit. Po ashtu ka informacion dhe shkallë të mirë gadishmërie lidhur me shërbimet e nevojshme për të cilat kanë nevojë studentët. GVJ kërkoi sqarim edhe lidhur me kohën e ofrimit dhe tarifat e dokumentacionit të kërkuara nga studentët dhe që lidhet me këtë program studimi. Na u sqarua se si ky lloj dokumentacioni, ashtu edhe riprovimet e studentëve në AI ofrohen pa pagesë nga Institucioni. Është përdorur si një mekanizëm stimulimi për studentët duke ofruar për ata me rezultate të mira në studime gjatë këtij programi edhe mundësia e

	punësimit në labororet dhe shërbimet brenda vetë kësaj kompanie. (Aneksi 22,22/1).			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Informacioni lidhur me programin e studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” jepet me mënyra alternative. Institucioni AI nuk ka një sistem të centralizuar të informacionit dhe kjo pranohet edhe nga haruesit e RVB (f.51). Por Institucioni përdor për këtë qëllim faqen e tij të internetit, emailët dhe rrjetet sociale. Kështu informacioni pretendohet të jetë i plotë dhe të përcillet në kohë të studentët apo të interesuar të tjerë. Adresa e Akademisë Ivodent është (www.ivodent.edu.al).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.	GVJ evidenton se Akademia Ivodent me cilësinë e Institucionit të Arsimit të lartë ka hartuar dhe disponon dokumentacion dhe statistika vjetore lidhur me studentët që vijnë në programin e studimeve Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”. Ky dokumentacion u verifikua edhe në regjistrin hard copy në sekretarinë e institucionit. Ai ka informacion për çdo student duke filluar që nga të dhënat në procesin e regjistrimit dhe gjeneralitetet, adresa e banimit e të dhëna të tjera të nevojshme, por edhe informacion lidhur me ecurinë gjatë procesit të studimeve dhe shkallën e suksesit të realizimit të tyre. Numri i studentëve të regjistruar me programin e riorganizuar të Akademisë për këtë vit është 27 studentë. Të dhëna ka edhe lidhur me studentët e regjistruar më parë, shkallën e nivelit të përparimit të tyre. Në këtë institucion disponohen të dhëna edhe lidhur me studentët që kanë studjuar më parë dhe kanë përfunduar studimet me shtimin e mëparshëm me kohë me të kufizuar (Aneksi 10,22/1). Në këtë program studimi janë gjithësej 59 studentë viti I = 27 studentë, viti II = 16 studentë viti III = 16 studentë.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para	Në programin e studimit të ciklit të parë, i cili ka filluar këtë vit akademik numri i studentëve ka tendencë rritjeje dhe është konstant. Deri në momentin e vizitës së GVJ në institucion me datat 7-8/11/2019, mësimi vijon normalisht dhe nuk ka ndonjë

<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>student të larguar nga procesi mësimor. E rëndësishme është të kuptohet se edhe në të kaluarën nuk ka patur studentë që të jenë tërhequr nga programi. GVJ nuk administroi ndonjë rast që të kishte studentë të larguar para përfundimit të programit, i cili të lidhet me përmbajtjen apo cilësinë e implementimit të programit. Në raste të rralla, kur një fenomen i tillë ka ndodhur, kjo ka ardhur për arsye familjare, ndryshim vendbanimi apo arsye shëndetësore dhe jo për shkaqe që lidhen me programin a cilësinë e mësimdhënjes.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë që ofron këtë program studimi të ciklit të parë Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”, disponon të dhëna lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit. Këto të dhëna janë të administruara që nga pranimi i studentëve dhe gjatë gjithë procesit mësimor deri në fazën e tanishme të realizimit të programit. Të dhënat lidhur me ecurinë e studentëve gjatë realizimit të këtij programi studimi administrohen në sekretarinë e institucionit dhe ruhen sipas kërkesave të ligjit e të akteve nënligjore që rregullojnë këtë proces.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore dhe ato personale të studentëve ruhen dhe menaxhohen nga ana e institucionit sipas kërkesave të ligjit dhe në përputhje me kërkesat e rregullores së brendshme të Akademisë. Aktualisht Akademia nuk ka një sistem të centralizuar të informacionit (RVB, f.52), por informacioni në lidhje me studentët ruhet fizikisht edhe në programe kompjuterike alternative. Të dhënat janë të sigurt dhe të verifikueshme nga persona të autorizuar. Në ruajtjen e të dhënave zbatohet parimi i konfidencialitetit dhe kërkesat e legjislacionit për këtë problem. Informacioni i nevojshëm mund të vihet në dispozicion pas një kërkesë me shkrim ose përmes posedimit të një account-i nga studenti. Të gjithë studentët disponojnë librezën e studentit ku kanë informacionin bazë lidhur me ecurinë e përparimit të tyre dhe cilësinë e zotërimit të programit (Aneksi2, 10/1).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia bazë që ofron programin e studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”, pritet të hartojë në përfundim të semestrit dhe të vitit akademik raporte analitike lidhur me cilësinë e studentëve dhe ecurinë e tyre gjatë përvetësimit të këtij program studimi. Kjo bën të mundur edhe krahasimin e rezultateve të studentëve në hyrje dhe gjatë vijimësisë së programit deri edhe në përfundim të tij. Gjithashtu Institucioni ka informacion lidhur me ecurinë e mëtejshme të studentëve që kanë studjuar këtu me sistemin e mëparshëm, para riorganizimit të programit aktual. Kjo flet për një traditë pozitive në ruajtjen e raporteve me</p>

	studentët e diplomuar dhe ecurinë e tyre në tregun e punës (Aneksi 14,15).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregulatore të vetë IAL-ve.	Institucioni Arsimit të Lartë Akademia Ivodent ka parashikuar e përfshirë studentët në realizimin e këtij programi, kryesisht përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të tij. Kjo gjë është realizuar sipas kërkesave të Ligjit 80/2015 (neni 54 e 55 të tij) “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH” (Aneksi 1). Në institucion funksionon Këshilli studentor i Akademisë si organ i pavarur i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Ky Këshill inkurajon e promovon pjesmarjen e studentëve në organet vendimmarrëse dhe në veprimtaritë e ndryshme mësimore e kërkimore. Të gjitha këto janë të fiksuara edhe në kërkesat e statutit të Institucionit të AI.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në bazë të dokumentacionit që disponon Institucioni e realizon përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, por ky mbetet gjithnjë një problem i hapur, bile dhe në këtë rast. Nga takimet që pati GVJ me me studentët ku u bënë ballafaqime e diskutime rastesh dhe u dhanë mendime lidhur me përmirësimin e cilësisë së programit dhe të permbajtjes së tij, qëndrimi tyre ishte aktiv dhe konstruktiv njëkohësisht. GVJ mendon se ka vend të diskutohet më shumë midis mundësisë formale të angazhimit të studentëve në realizimin e programit e cila në dokumenta është e pasqyruar dhe mundësisë reale të tyre e cila shpesh ka vend për diskutim. Nëse studentët trajtohen si pjesë e pandarë e plotësisht të këtij programi dhe u hapet horizont e u propozohen varjante gjatë diskutimeve, pjesmarja e tyre në to jo vetëm do të jetë aktive, por me përfitime konkrete e frutdhënëse (Aneksi 1).
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit,	Në hartimin e programit të studimit përgjithësisht është patur parasysh ngarkesa akademike e studentëve me tendecë shmangien e mbingarkesave të mundëshme. Por edhe shpërndarja e lëndëve e moduleve gjatë semestrave e vitit akademik dhe sidomos hartimi i orareve ditore mund e duhet të jetë më i vëmendshëm për të shmangur grumbullimin e lëndëve më të vështira në ditë të caktuara. Lypset shpërndarje me harmonike e lëndëve të përgjithëshme me ato të

<p>përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>profesionit, e lëndëve teorike me praktikat profesionale për të patur një shpërndarje sa më harmonike të ngarkesës ditore, javore apo me tej të studentëve gjatë plotësimit të programit. Kur shpërndarja e ngarkesës realizohet sa më uniforme edhe marrja e informacionit do të vijë më uniforme dhe do të jetë më e qëndrueshme. Konsulta me studentët lidhur me procedurat e parashikuara lidhur me përparimin e tyre gjatë implementimit të këtij programi, janë realizuar. Por ky mbetet një problem i hapur që kërkon më tej efikasitet e fleksibilitet. Njohja e studimeve të mëparshme, të plota apo të pjesëshme, në këtë program studimi është e parashikuar qartë dhe e realizuar sipas kërkesave të ligjit e akteve nënligjore lidhur me të (Aneksi 1)..</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni AI garanton me dokumentacion të shkruar përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe të përmirësimit të programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”. Gjatë takimit me studentët në këtë institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm mori vrejte prej tyre që mendojmë se janë në dobi të përmirësimit të programit. Ata konsideruan të arsyeshme mundësinë e dhënjes së njohurive edhe nëfushën e menaxhimit shëndetësor e të biznesit në aktivitetin e laboratorëve dentare ku do të jenë të ardhmen pjesmarrës ose drejtues të tyre. Nga ana e studentëve shihej e arsyeshme edhe mundësia e dhënjes së disa njohurive bazë në fushën e etikës dhe të deontologjisë mjeksore. Ne i konsideruam të arsyeshme mendimet e tyre, pasi profesioni që ata marrin përmes këtij programi ka nevojë për njohuri profesionale, por edhe të karakterit organizativ dhe etik të punës në laboratore. Një gjë e tillë mund të realizohet duke bërë përmirësimet të mëtejshme të programit të studimit, ndoshta duke vendosur edhe lëndë me zgjedhje dhe kemi bindjen se studentët do ti preferojnë e ndjekin ato. Plotësimi i kësaj ideje mbetet një detyrë për Institucionin në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ evidenton se studentëve u është dhënë mundësia për të dhënë mendim lidhur me cilësinë e vlerësimit të dijeve studentëve u është garantuar në dokumentacionin e Institucionit. Studentët e AI e konsiderojnë objektiv vlerësimin e dijeve dhe procedurat e ndjekura për realizimin e tij. Rezultatet edhe mund të kontestohen nga ana e tyre dhe të ballafaqohen sipas rastit. E drejta e riprovimit është e mundur dhe për këtë institucioni nuk ka aplikuar tarifë shtesë. Vërejtjet lidhur me vlerësimin jo objektiv të dijeve nga ana e studentëve mund të bëhen direkt dhe në ballafaqim me pedagogun përkatës, por ato mund të bëhen edhe përmes anketave anonime të cilat plotësohen nga studentët si rregull dy herë në vit. Modeli i një ankete të tillë na u vu në dispozicion dhe ai përmban pyetje edhe lidhur me kriteret dhe objektivitetin e vlerësimit të dijeve. Vlerësimet e dijeve të studentëve pasqyrohen në regjistrat hard copy dhe ruhen në sekretarinë mësimore të A.I(Aneksi 3,4,8).</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni arsimor A.I ka procedura të përcaktuara që shërbejnë për informimin e janë në shërbim të studentëve lidhur me të dhënat e programit të studimit dhe ecurinë e tij. Ky institucion ka të ngritur një njësi të posaçme pranë sekretarisë mësimore që shërben për orjentimin e këshillimin e tyre si dhe komunikimin e raportet me personelin akademik (Aneksi 10) Zyra për shërbimin ndaj studentëve është e ngritur në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregulloret e IAL sidomos ajo e Fakultetit të teknikave dentare dhe ajo e programit të studimit. Në RVB është përcaktuar se realizimi i tutoriatit në nivel njësië bazë mundëson komunikimin e drejtpërdrejtë të studentit me pedagogët e tij. Nga konsulta e zhvilluar me studentët që vijojnë këtë program studimi rezultoi se nuk e kishin qartësinë e duhur mbi rolin e tutorit dhe nuk raportuan një pedagog të caktuar si tutor, por theksuan se këtë rol e luan pedagogu i praktikës ose i lëndës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni e ka të organizuar dhe funksionale sistemin për informim të studentëve që këshillon ata lidhur me objektivat e programit dhe ndjek përparimin e tyre gjatë gjithë vitit akademik Kështu realizohet këshillimi dhe asistenca e nevojshme për çdo problem që lidhet me implementimin e programit të studimit në fjalë. Përveç zyrës përkatëse dhe komunikimit direkt me personelin e ngarkuar është përdorur edhe interneti si një mundësi konkrete e reale e komunikimit midis studentëve e personelit akademik dhe atij administrativ. Sa i përket komunikimit të jashtëm AI u ofron studentëve dhe të interesuarve të tjerë mundësinë e komunikimit përmes faqes së saj zyrtare, përdorimit të telefonit, adresat e emailit dhe publikime të tjera figurative të afishuara në ambjentet e Akademise Ivodent(10,37).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale</p>	<p>Informacioni i dhënë për studentët nuk kufizohet vetëm në procesin mësimor. Zyra e këshillimit të studentëve dhe sekretaria mësimore e institucionit, kryesisht këto, por jo vetëm këto, u japin informacion të vazhduar studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Teknikë e lartë dentare" lidhur me kompletimin e plotë të programit, detyrimet përmbyllëse të tij, orjentimet lidhur me kryerjen e praktikave profesionale jashtë institucionit e deri tek</p>

<p>në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>provimi i formimit dhe punimi praktik i diplomës (Aneksi 2). Ky informacion përfshin edhe gjithë të dhënat që disponohen lidhur me tregun e punës e mundësinë e një punësimi të shpejtë të atyre që përfundojnë këtë program studimi. Përveç të gjithë mënyrave që u përmendën dhe janë në dispozicion të studentëve për informimin real e në kohë të tyre, duhet pranuar se edhe mundësia e takimeve dhe e kontakteve direkte e studentëve me personelin dhe drejtuesit e Akademisë është lehtësisht e realizueshme dhe ofrohet pa pengesa.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Informimi dhe raportet me studentët përfshijnë periudhën e studimeve, por shtrihen dhe pas saj. Kjo çështje nuk u përket studentëve të këtij program pasi ata janë në vitin e parë të ndjekjes së tij. Përvoja e institucionit lidhur me ecurinë e studentëve që janë diplomuar në këtë institucion në programe studimi të mëparshme është pozitive. Ruhen raporte e mardhënie të rregullta me të diplomuarit në këtë institucion dhe ndiqet ecuria e sukseset e tyre në punë. Ata ftohen në aktivitete të ndryshme dhe aktivizohen në to me interesimin e institucionit ku kanë studjuar. Ata janë asistuar edhe në mënyrën e kërkimit të një vendi pune, hartimin e kërkesës, të një CV, të letrave e korespondencave me institucione punëmarrësi dhe marjen e vendimeve finale lidhur me karrierën e tyre profesionale (Aneksi 22). Një praktikë e tillë dhe një komunikim i këtij lloji, ndonjëherë dhe jo shumë protokollar, kanë bërë që shkalla e punësimit të studentëve që kanë studjuar në këtë institucion në programet e mëparshme të studimit në të, të ketë qenë e mirë. Pritet gjithashtu që edhe për kontigjentet që studjojnë në programin e studimeve Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” të jetë e mirë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni i arsimit të Lartë AI, ka politika që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, bazuar në nenin 103, pika 1, të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH” dhe aktet nën ligjore që shoqërojnë atë. Ai ka tentuar të hartojë procedura që bëjnë të mundur sigurimin e brendshëm të cilësisë në këtë program studimi. Përmbajtja dhe thelbi i tyre si dhe mundësitë e organizimit konkret të këtij procesi janë të përcaktuara edhe në Statutin e institucionit dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”, përkatësisht në nenet 9,10 e 11 të saj (Aneksi 1). Ky institucion ka hartuar edhe një rregullore të posaçme për funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të cilësisë të cilën e ka aprovuar në senatin akademik dhe nënshkruar nga Kryetari i tij Z. I.M. në Tetor të vitit 2018 (Aneksi 8).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>AI në zbatim të kërkesave të ligjit e të udhëzimeve të MASR ka ngritur dhe e ka funksionale atë, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi drejtohet nga E. N. me profesion kimiste. Antarët e saj kanë mandate 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Lëvizjet e paparashikuara të personelit akademik kanë bërë që struktura e saj të ndryshojë në afate më të shkurtra kohore. Në rregullore janë të përcaktuara hapat që duhen ndjekur për SBC, por ka edhe formulime të përgjithëshme si “NJSBC - ja rregullisht fton çdo fakultet dhe çdo department për të zhvilluar kërkime për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë” (neni 7). Kuptohet se janë fraza të shkëputura nga udhëzime e akte nënligjore për këtë problem dhe që nuk janë koherente për këtë institucion që ka vetëm një fakultet. Në RVB (f.55) thuhet se gjatë vitit akademik 2019-2020 akademia do të vleresojë performancën e personelit akademik në lidhje me zbatimin cilësor të programit të studimit, pra pranohet se është një detyrë që pritet të realizohet. Në NJSCB është i aktivizuar edhe një student i vitit të tretë i cili ka vazhduar studimet me programin e mëparshëm. Nuk u konstatua që në këtë proces të rëndësishëm të jetë aktivizuar ndonjë ekspert i jashtëm siç udhëzimet për këtë problem e parashikojnë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të</p>	<p>Institucioni AI i përdor instrumentat e nevojshëm për sigurimin e cilësisë. Në zbatim të plotësisht të kriterëve ligjore për akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë në</p>




<p>akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>RSH, i ka ndjekur procedurat e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit institucional. Në vitin 2009 Kolegji “Ivoclar Vivadent@Partners” është licensuar me VKM 178 datë 19.2.2009. Është akredituar nga APAAL (sot ASCAL) me vendimin e KA (sot Bordi i Akreditimit) dhe Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (sot MASR) nr.328, datë 15/08/2013 (Aneksi 26). Institucioni është riorganizuar në formën e Akademisë me emrin Ivodent me Urdhërin e Ministrit nr. 598 datë 21/12/2016 (Aneksi 1/1). Kjo Akademi aktualisht ka organizuar zhvillimin e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” dhe kërkon akreditimin e programit të studimit. Procedurat e akreditimit të jashtëm të programit të studimit janë krejtësisht transparente.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësisve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Procedurat që duhet të ndjekë institucioni për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të hartuara dhe pasqyrohen në dokumentacionin e hartuar për implementimin e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”. Hapat për realizimin e tyre në praktikë janë në proces, pasi ky program i riorganizuar është në fillim të tij. Gjatë vizitës në Institucion na u dha mundësia që të verifikojmë disa anketime të cilat thuhet se realizohen dy herë gjatë një viti akademik (Aneksi 8). Në anketat e plotësuara nga studentët ka pyetje të rëndësishme që lidhen me cilësinë e mesimdhënjes, aftësitë dhe përkushtimin e stafit akademik dhe atij ndihmës në realizimin e programit, objektivitetit në vlerësimin e dijeve etj. Plotësimi i këtyre anketave është bërë anonim dhe kjo ruhet në sekretarinë e institucionit. Një anketim i tillë është kryer një herë për këtë vit dhe mendohet të kryhet përsëri para përfundimit të vitit mësimor 2019-2020. Konkluzionet i janë bërë të ditura stafit dhe personave të interesuar. Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit është një detyrë në proces dhe mendojmë se edhe kjo vizitë me ekspertë të jashtëm mund të ndikojë pozitivisht në këtë proces.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të shtuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin</p>	<p>Institucioni e ka të përcaktuar e dokumentuar detyrën për rishikimin dhe përmirësimin e programeve mësimore të studimeve të ciklit të parë. Një gjë e tillë është e obliguar në këtë program</p>

<p>e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>studimi për faktin se teknikat e përgatitjes së protezave dentare ndryshojnë, përsosjen vazhdimisht e në kohë relativisht të shpejtë. Po ashtu edhe materialet dentare në përgjithësi e ato të përgatitjes së protezave veçanërisht shtohen e përmiresohen me shpejtësi. Kjo e bën të domosdoshme rishikimin dhe përmirësimin e këtij programi studimi. Propozimet për këtë proces vinë nga stafi akademik, nga vetë studentët dhe iniciohen edhe gjatë aktiviteteve jashtë institucionit apo shkëmbimit të përvojave me aktorë të tjerë të kësaj fushe (Aneksi 16,16/1). Edhe diskutimi i fundit i kryer në institucion me GVJ-në, nxori disa probleme të rëndësishme lidhur me mundësinë e përmirësimit të programit të studimit që po realizohet aktualisht.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni AI i ka të dokumentuara mekanizmat dhe proceset që përdoren për plotësimin e këtij program studimi të ciklit të parë, përmirësimin dhe rishikimin në mënyrë të vazhduar të tij në dokumentacionin e hartuar në njësinë bazë e atë kryesore të tij, por edhe në dokumantacionin e këtij programi studimi. Për shkak se realizimi i këtij programi është në hapat e tij të para dhe këtë vit akademik është viti i parë i imlementimit të këtij programi pas riorganizimit të tij, plotësimi i këtyre kërkesave është në fillesat e tij. Mbetet të verifikohen deri në fund të këtij viti mësimor e në vitet e tjerë akademike zbatimi i plotë i këtyre mekanizmave e proceseve që përdoren për mbikëqyrjen dhe rishikimin e përmirësimin në vazhdimësi të programit të studimit. Një nga përmirësimet më esenciale i është bërë këtij programi studimi me vetë propozimin e studentëve lidhur me shtimin e orëve për praktikën laboratorike, çka është marrë në konsideratë dhe e përparon programin me të tillë programe bashkëkohore. Rishikimi i programit të studimit pritet të bëhet brenda tremujorit të parë të vitit 2020 dhe deri në fund të muajit mars të po këtij viti të vihet në dijeni MASR për mundësinë e implementimit të ndryshimeve të propozuara në vitin e ardhshëm akademik (Aneksi 14,15).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni AI përdor metodologji të qartë për vlerësimin e programit dhe instrumente matëse për të vlerësuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e tij. Në këtë kompleks masash bëjnë pjesë puna për rekrutimin e stafit akademik dhe atij ndihmës, sigurimi i literaturës adekuate bazë dhe plotësuese, paisja dhe mirë funksionimi i bibliotekës, rezultatet dhe kalueshmëria e studentëve në çdo modul dhe kryerja e detyrave praktike ditore dhe javore nga ana e tyre. Ka instrumenta matës të përcaktuara lidhur me vlerësimin dhe cilësinë e zbatimit të programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”. Ne e konsiderojmë ende në proces riorganizimin e programit të studimit dhe në momentin aktual është e mundur të verifikohet qartësia e saktësia e hartimit të dokumentacionit, ndërsa zbatimi dhe implementimi praktik i tij është në process dhe</p>

	kërkon kohën e nevojshme për të konkluduar lidhur me impaktin e tij në praktikë .			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Te gjitha rezultatet e vlerësimeve të bëra në këtë program studimi, rezultatet që arrihen në procesin mësimor edukativ, në rezultatet që arrijnë në vijimësi studentët gjatë kontrolleve periodike që kryhen gjatë vitit e në fund të tij, u bëhen të njohura drejtuesve të njësisë bazë dhe asaj kryesore. Kështu programi është i monitoruar në disa drejtime dhe nga disa aktorë lidhur me kohën dhe cilësinë e realizimit të tij. Autoriteteve u bëhen të ditura edhe vëzhgimet lidhur me infrastrukturën dhe problemet që lindin gjatë realizimit vjetor të programit apo propozimet që bëhen për ndryshimet dhe përmirësimin e tij. Kjo bën që ata të marrin masat e nevojshme për plotësimin e kërkesave që shfaqen gjatë realizimit të programit dhe po ashtu të reflektojnë në kohë dhe të mbajnë raporte pune me organet e prore në dobi të përmirësimit cilësor të punës dhe në afatet e duhura (Aneksi 14,15).			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Rezultatet e arritura janë të dokumentuara e të njohura nga aktorët e interesit dhe strukturat drejtuese të institucionit. Ato janë të dokumentuara sipas kërkesave. Rezultatet e pritshme janë të projektuara, por ata priten të konfirmohen në vijimësi dhe natyrisht do të gjejnë pasqyrimin e duhur në raportet e vlerësimit dhe dokumentacionin final në fund të semestrit e të vitit akademik. Një sërë mangësishë që pranohen në Institucion dhe të tjera që u konstatuan gjatë vizitës së GVJ u pranuan paraprakisht. Ato u morën si detyra për tu korigjuar e përmirësuar në të ardhmen. Është rasti të vihet në dukje dhe ky fakt që u diskutua me stafin akademik të institucionit se në RVB është pasqyruar një ndjenjë vetkënaqësie e tepruar dhe vetëvlerësimet e grupit që ka hartuar raportin për të gjitha standartet dhe kriteret janë mbivlerësuar dhe janë paraqitur të gjitha të përmbushura plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër	Akademia Ivodent e monitoron në mënyrë të vazhdueshme realizimin e programit të studimit Bch. në “Teknikë e lartë dentare” lidhur me përmbushjen e standarteve të cilësisë. Pjesë e këtij monitorimi janë vlerësimet e komunikimet ditore e javore me pedagogët e lëndës dhe stafin akademik e ndihmës, por edhe

<p>të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>analizat që bëhen herë pas here në njësinë bazë që është përgjegjëse për realizimin e programit Një funksion me specifik luan në këtë drejtim edhe njësisia e sigurimit të brendshëm të cilësisë për të cilën është hartuar edhe një rregullore përkatëse. Në këtë rregullore janë precizuar mënyrat dhe rregullat e funksionimit të NJSBC si dhe detyrat që kryen e instrumentat që përdor për ti realizuar ato. Në analizat e bëra si ajo e vitit të kaluar, një kapitull të veçantë e zë kapitulli mbi sigurimin e cilësisë (Aneksi 30,16/2). Edhe Raporti i vlerësimit të brendshëm që është hartuar në kuadër të akreditimit të programit që po realizohet aktualisht, ka një kapitull që lidhet me sigurimin e cilësisë ku bëhet një analizë optimiste e këtij problemi. Pra problemi i sigurimit të cilësisë në realizimin e këtij programi nga ana e këtij institucioni është i trajtuar në dokumentacionin që ai posedon, plotësimi i tij është një sfidë e përditëshme dhe mbetet i hapur.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni AI i ka të përcaktuara në rregulloren përkatëse të funksionimit të NJSBC në nenet 11,12e 13 të saj, metodat dhe instrumentet që përdor për sigurimin e cilësisë. Për këtë qëllim kanë shërbyer edhe pyetsorë e intervista individuale që kryhen me studentët, të cilët vazhdojnë studimet apo dhe që i kanë kryer më parë ata. Janë përdorur edhe anketime me pyetje konkrete lidhur me përmbajtjen e programit, mënyrat e mësimdhënjes, performancën e stafit, bazën materiale, literaturën etj të cilat janë plotësuar në mënyrë anonime nga studentët dhe ruhen në mënyrë konfidenciale. Një anketim i tillë është kryer edhe në fillim të këtij viti akademik dhe pritet të zhvillohet një i dytë nga mesi i semestrit të dytë (Aneksi 8). Të dhënat e anketimit të kryer janë perpunuar e analizuar nga njësisia bazë dhe strukturat e institucionit dhe kanë shërbyer për përmirësimin e punës në të ardhmen. Nga përvoja e më parshme rezulton se nga anketimi i studentëve dhe vërejtjet që ata kanë bërë është larguar nga ky institucion një specialist Italian i cili ishte marrë për të kryer praktika profesionale. Edhe të dhënat statistikore që disponojnë njësitë përbërëse të Institucionit kanë shërbyer për të bërë analizë e në funksion të përmirësimit të cilësisë. Dokumentacioni mësimor si regjistra, proces verbale provimesh, formularë që përmbajnë të dhëna për kalueshmërinë, vijueshmërinë e programit nga studentët, rezultatet dhe notat mesatare janë përdorur nga NJSBC dhe njësisia baze si indikatorë të vlerësimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të mbarëvajtjes dhe realizimit të programit të studimit dhe të cilësisë së implemtimit të programit, institucioni ka përdorur edhe metoda të drejtpërdrejta vlerësimi. Këto përfshijnë vëzhgime direkte të mësimdhënjes nga persona kompetentë që janë në përbërje të akademisë, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave praktike dhe të detyrave me</p>

<p>auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>shkrim që kryejnë studentët. Kështu cilësia e mësimdhënjes është e monitoruar në vazhdimësi. Lidhur me vlerësimin didaktik të procesit mësimdhënës GVJ mendon se është një problem i të gjitha shkollave të profilit mjeksor në përgjithësi dhe AI, pasi pedagogët në këtë rast mund të jenë profesionistë të zot, por jo aq mësimdhënës të zot. Nga interesimi i GVJ gjatë vizitës në institucion mësuam se janë bërë leksione nga pedagogë të fushës së mësimdhënjes 1-2 herë në vit dhe pritet të bëhet edhe këtë vit një miniseminar me një specialist të fushës së pedagogjisë. Janë planifikuar të bëhen edhe leksione të hapura e pastaj diskutim e debat për këtë problem. Gjykimi mbi cilësinë e kurikulës dhe mundësinë e përmirësimit të saj është një problem që mbahet në vëzhgim në mënyrë të vazhduar, por që i nënshtrohet freskimit dhe përmirësimit të tij së paku një herë në vit me rastin e fillimit të vitit akademik (Aneksi 8,22?1). Vëzhgimet në auditor gjatë kryerjes së seminareve apo praktikave laboratorike profesionale janë të shpeshta dhe konsiderohen pjesë e detyrës ditore të stafit akademik. Gjatë vizitës në institucion GVJ rekomandoi që të shikohet edhe mundësia e përgatitjes së punimeve për pacientë realë pasi kjo është një mundësi e mirë që nxit angazhimin moral e teknik të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Përveç metodave të drejtpërdrejta të kontrollit të cilësisë është synuar të bëhen edhe metoda të tërthorta që japin informacion lidhur me kualitetin e mësimdhënjes e të mësimnxënjes. Këto mundësi të tërthorta kanë patur si target jo vetëm kontigjentet e studentëve që janë në vijim të këtij programi studimi, por edhe ata që e kanë përfunduar atë dhe përballen me zbatimin praktik të tij. Kjo është një rezervë dhe mundësi e madhe që ndonëse është shfrytëzuar nga ana e institucionit, nuk duhet të mbetet në kornizën e kureshtjes për fatin e atyre që janë diplomuar në të, por në grumbullimin e një informacioni të plotë e të dobishëm për ecurinë e këtij programi dhe fatin e atyre që janë në procesin e studimit, bile dhe të atyre që do ta kenë kenë fat në të ardhmen. Ka raporte dhe informacione mbi ecurinë e studenteve të diplomuar në këtë institucion dhe interesat e vrejtitet e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit, sidomos mësimdhënjes lidhur me të. Intervistat me personelin akademik dhe atë ndihmës akademik e administrativ, janë një burim i përditshëm informacioni lidhur me ecurinë e këtij programi studimi. GVJ mendon se realizohet në mënyrë të kënaqëshme edhe mundësia e informacionit nga persona jashtë institucionit ku janë punësuar ata që kanë kryer studimet më parë në këtë institucion. Kjo i krijon mundësinë institucionit dhe drejtuesve të tij që “të shihen në pasqyrë” lidhur me punën që kanë kryer vite më parë dhe të nxjerrin konkluzione e të marrin masa për përmirësimin e cilësisë</p>

	së mësimdhënjes në këtë program studim (Aneksi 14,15). Kontakte të tilla ky institucion ka kryer dhe një mundësi e tillë egziston, pasi kompania ka dhe një aktivitet tjetër dhe kontakte të përditëshme me aktorë të interesit në fushën e materialeve dentare dhe të përgatitjes së protezave dentare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni AI ka përfshirë në procedurat e SBC-së hallkat organizative dhe ato akademike të tij që nga departamenti, fakulteti dhe rektorati. Këta faktorë të brendshëm janë pjesë e sigurimit të cilësisë dhe e vlerësimit periodik të saj. Procedurat dhe mjetet që kanë përcaktuar faktorët e brendshëm të sigurimit të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentacion dhe në rregulloren e programit të studimit dhe atë të NJSBC-së (Aneksi 32). Ka përpjekje që këto procedura dhe mjete të realizohen me sukses. Në fazën e realizimit të programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” ku ndodhet aktualisht, janë hapat e para të zbatimit të këtyre mekanizmave, por dokumentacioni i shkruar nga duhet të ecet është përgjithësisht i plotë. Në raste të veçanta janë ngritur edhe grupe pune për probleme të veçanta me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të vetë strukturave të institucionit që më pas kanë raportuar e dhënë mendime për zgjidhjen a përmirësimin e tyre. Ky proces ka filluar që në fazën e përzgjedhjes së stafit e pritet të vazhdojë deri në fazën finale të implementimit të programit. Lidhur me aktivizimin e faktorëve të jashtëm në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm ka përpjekje, por ato janë të rastësishme dhe sporadike. Në aktivitete të ndryshme ku ka pjesëmarrje të aktorëve të interesuar, janë kërkuar dhe janë dhënë mendime lidhur me cilësinë e përgatitjes së kontigjenteve të mëparshme dhe propozime për përmirësimin e saj dhe ka vëmendje për ti kthyer ato në programe pune e realizuar më tej në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Institucioni i ka përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët e deri te studentët e palët e tjera të angazhuara në realizimin e këtij programi. Këto detyra janë të sqaruara në rregulloren e hartuar me këtë rast të programit të studimit, por sidomos atë të NJSBC-së që është ngritur kryesisht për këtë qëllim. Për arsye të problemeve të brendshme të institucionit dhe</p>

	<p>largimeve të pa parashikuara që kanë ndodhur, kompozimi dhe përbërja e NJSBC ka qenë jo e stabilizuar dhe nuk janë respektuar kriteret që njih rregullorja për këtë problem. Institucioni ka garantuar ushtrimin e përgjegjësive të antarëve sipas kërkesave të rregullores përkatëse. Në përberje të NJSBC-së bëjnë pjesë drejtuesja e saj, 4 antarë dhe një përfaqësues i studentëve. Ka patur kujdes për zgjedhjen e tyre në mënyrë që antarët e njësisë të jenë me eksperiencën e duhur profesionale e pedagogjike dhe me integritet personal e rezultate në punë (Aneksi 8). Drejtuese e NJSBC-së në këtë vit akademik është zgjedhur E. N. e cila është specialiste e fushës së Kimisë.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në praktikën për sigurimin e brendshëm të cilësisë të këtij programi janë përfshirë njësia bazë dhe ajo kryesore të institucionit AI që ka ofruar këtë program studimi. Përveç aktivitetit të njësisë së veçantë që është ngritur për këtë qëllim, që është NJSBC-ja, me sigurimin e cilësisë u është dhënë akses edhe faktorëve të tjerë kryesisht të brendshëm dhe ndonjë herë edhe të jashtëm. Në këtë proces janë përfshirë pjestarët e stafit akademik dhe ndihmës akademik dhe atij administrative dhe vetë studentët të cilët kontribuojnë në të gjitha rastet e mundshme në drejtim të përmirësimit të programit e realizimit cilësor të tij. Në përberje të NJSBC-së është zgjedhur edhe një student i vitit të tretë, por që ndjek programin e parë, atë para riorganizimit të tij (Aneksi 8). Mekanizmat kryesorë që janë përdorur në këtë institucion për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së realizimit të tij kanë qenë të dhënat e mbledhura nga meknizmat e reagimit dhe grupet e vlerësimit, grupet e interesit dhe intervista individuale që grumbullohen në çdo rast të mundshëm. Po ashtu janë shfrytëzuar të dhënat statistikore që diponojnë njësitë përbërëse të Akademisë lidhur me studentët dhe ecurinë e tyre gjatë realizimit të programit. Rezultatet e arritura dhe të gjitha të dhënat dokumentare që lidhen me procesin mësimor edukativ dhe formimin profesional e shkencor të studentëve, vihen në dispozicion të njësisë bazë dhe përdoren për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Personeli akademik dhe vetë studentët janë të përfshirë në proceset e vazhdueshme dhe ciklike të vlerësimit të cilësisë dhe kjo është e fiksuar edhe në rregulloret përkatëse që institucioni ka hartuar për këtë qëllim. Për mënyrën e organizimit të vlerësimit të cilësisë, pjasmarjen masive të grupeve të interesit, metodave dhe indikatorët që përdoren për këtë qëllim, të gjitha këto të fiksuar në rregulloren e programit të studimit dhe atë të NJSBC-së e akte të tjera, GVJ mendon se e bëjnë objektiv vlerësimin e dijeve dhe evitojnë mundësinë e diskriminimit, apo të pabarazisë së studentëve. Në këtë drejtim asnjë e dhënë nuk doli gjatë vizitës në</p>

	<p>Institucion, ndërkohë e kam bindjen se këtu askush nuk është i interesuar që të ketë fenomene të tilla dhe të krijohen pakënaqësi sidomos me studentët që sot janë nxënës, por nesër do të jene kolegë, ndonjeri edhe brenda vetë stafit të Akademisë (Aneksi 8,16).</p> <p>Stafi akademik, ndihmës akademik dhe ai administrativ është një vlerësues i përhershëm i sigurimit të cilësisë së programit, është autor dhe aktor i këtij procesi. I përfshirë në proceset e sigurimit të cilësisë, ai është edhe në procesin e vlerësimit të vetvetes dhe pozicionin e vlerësimit të tij nga studentët dhe aktorë të tjerë jashtë institucionit. Thënë më shkurt ai është në sitën e vlerësimit të studentëve dhe jo vetëm, por GVJ mendon se nuk është i pa vlerësuar e i diskriminuar në këtë institucion, si pjesë e realizimit të programit në fjalë. Për ata që kanë probleme me vetveten dhe me realizimin e programit me propozimin edhe të studenteve, institucioni ka mbajtur qëndrim deri në largimin e tyre, por kjo është në meritë dhe nuk duhet konsideruar diskriminuese.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Pjesmarja e bashkëpunëtorëve të jashtëm në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë të programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” është një problem i diskutueshëm. Nëse eksperte të jashtëm konsiderohen disa pedagogë që hartojnë kurrikula dhe japin mësim në këtë institucion, kjo vlen të sqarohet. Ata janë të jashtëm pasi punojnë edhe në ndonjë institucion tjetër, por kur bëhen pjesë e stafit si PAE ata janë tashmë personel i brendshëm për programin e studimit. Bashkëpunimi nëpër aktivitete me ekspertë të jashtëm sigurisht që edhe ka egzistuar, por jo në formën e një pune të programuar qartë e me afate, dhe me objekt analizën e cilësisë së programit apo cilësinë e realizimit të tij. Thirrja e ekspertëve të jashtëm për të shqyrtuar programin e studimit, cilësinë e hartimit dhe implementimit të tij sigurisht që është një sfidë. Pa vënë në diskutim aftësitë e dëshirën e askujt për të realizuar me sukses një program studimi, përfshirë edhe këtë program, një ekspert që vjen nga jashtë dhe është i pa mësuar me të metat me të cilat një i brendshëm edhe mund të ambjentohet, do të reagojë më shpejt e efektivisht. Ekspertë të tillë duhet të thirren shpesh, si ata të fushës së profesionit por edhe të fushës pedagogjike, ku institucione të tilla kanë praktikisht vështirësi. Në RVB (f.61), vetë hartuesit e dokumentit janë shprehur se <i>“rekomandohet të ketë ekspertë të jashtëm që ofrojnë informacione dhe orientime përkatëse mbi zhvillimet aktuale të programit, partnerë programi nga institucione me të cilat ka marrveshje bashkëpunimi (nëse ka)”</i>. Pra vetë institucioni e vë në diskutim praninë e marrëveshjeve të tilla me ekspertë të jashtëm dhe në një gjykim të paanshëm kur hartuesit e brendshëm të dokumentit thonë “nëse ka”, çdo lexues</p>

	i jashtëm e ka të drejten ta lexojë se “nuk ka”. Pra është një çështje që kërkon të përmirësohet në dobi të cilësisë së këtij programi studimi që Institucioni AI po realizon aktualisht, por dhe një kërkesë që do të vlente për çdo program studimi (Aneksi 16,17).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaritë e Institucionit në drejtim të sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” kanë synuar të jenë transparente. Ato përfshijnë të gjithë faktorët e brendshëm të cilët synojnë realizimin e këtyre politikave dhe masave në drejtim të përmirësimit të cilësisë që janë në kontakt me to, janë pjesë e ekzekutimit të tyre dhe të njohur realisht me to. Ato janë bërë publike për studentët dhe gjithë të interesuarit në mënyrë direkte e reale, por janë publike e të aksesueshme në çdo kohë edhe në sistemin online. Pyetsorët që janë pjesë e anketave të cilat bëhen me studentët si rregull dy herë në vit dhe zakonisht në fund semestri, përfshin pyetje për të gjitha lëndët dhe pedagogët e aktorët e tjerë në institucion. Pyetsorët janë përpunuar e aktualizohen çdo vit dhe u vihen në dispozicion drejtuesve dhe palëve të interesuara (Aneksi 8,8/1). Kjo mënyrë transparente e komunikimit ka ndikuar në sigurimin e ruajtjen e cilësisë së programit dhe ka shërbyer për të marrë masa konkrete deri në pezullime nga puna të ndonjë pjestari të stafit akademik, siç edhe ka ndodhur në të kaluarën.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni AI i ka shpallur e bërë publike rezultatet e përfuara nga monitorimet dhe vlerësimet e programit. Ato janë vënë në dispozicion të stafit, të studentëve, të administratës dhe aktorëve të tjerë të interesuar për këtë problem. Rezultatet që ka grumbulluar NJSBC-ja lidhur me punën e pedagogëve u janë komunikuar personalisht pedagogëve dhe janë ruajtur si të dhëna konfidenciale. Njësia e mësipërme ka informuar rektoratin dhe drejtuesit e programit për rezultatet që kanë dalë nga anketimet me studentët apo kontrollet që janë zhvilluar me synim marjen e masave për përmirësimin e performancës së institucionit dhe të njësive pjesmarrëse në implementimin e programit të studimit që është ofruar e po implementohet aktualisht (Aneksi 1/1, 8). Një nga propozimet e kohëve të fundit i bërë nga studentët ka qenë edhe

	<p>përmirësimi i raportit teori/praktikë, i cili është marrë në konsideratë nga ana e institucionit. Duhet vënë në dukje se në këtë institucion ka një ndjenjë vetkënaqësie, të cilën GVJ e konsideron të dëmshme pasi pengon hapjen e horizonteve për tu përmirësuar e çuar punët përpara. Këtë GVJ e pa gjatë vizitës në Institucion, por edhe në faktin se në RVB në të 6 fushat e tij, për të gjitha standartet e kriteret dhe rreth 150 pyetjeve që përman raporti e grupi i punës u ka dhënë përgjigje, në vetëvlerësim janë gjykuar si të përmbushura plotësisht, pra janë vlerësuar maksimalisht nga vetë institucioni.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Është synuar që rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programit të ofruar të shoqërohen me masa konkrete për përmirësimin e gjëndjes. Strukturat që meren me cilësinë e programit janë treguar të ngathta në evidentimin e problemeve që kanë nevojë të korigjohen e përmirësohen. Nga shqyrtimi i RVB gjen pak të dhëna të tilla që tu hapin horizont organeve drejtuese. Në f.58 të raportit thuhet <i>'ose e aspekteve që kanë nevojë të përmirësohen'</i>, por më tej dhe askund, nuk citohet asnjë aspekt i tillë. Është i evidentuar fakti se këtë vit NJSBC ka përgatitur raportin institucional të vlerësimit të brendshëm të cilësisë me statistika dhe analizë të punës së bërë e shoqëruar me ndonjë sugjerim për përmirësimin e punës në të ardhmen. Ky raport u është adresuar organeve drejtuese të Akademisë dhe pritet të shoqërohet me masa konkrete. Raporti është shpallur publikisht dhe thuhet se janë në pritje edhe të vrejtimeve dhe propozimeve të reja nga aktorë të tjerë të interesit (Aneksi 14,15).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni AI e ka vlerësuar efektivitetin e strukturave dhe veprimtarive që meren me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ai ka të hartuar një rregullore përkatëse lidhur me veprimtarinë e NJSBC-së e cila është e hartuar qartë e me procedura dhe instrumente konkrete që bëjnë të mundur vlerësimin e cilësisë. Natyrisht që ka patur vështirësi në zbatimin e plotë të kësaj rregulloreje. Përbërja dhe struktura e kësaj njësie janë konformë rregullores përkatëse e kërkesave të ligjit, por mobiliteti i kuadrit dhe levizjet herë herë jo të kontrolluara e të papritura të personelit akademik e kanë cënuar disi rregullshmërinë dhe kontinuitetin e veprimtarisë së kësaj njësie. Raportet që ka paraqitur njësia e cilësisë janë bërë pjesë e analizave të brendshme në institucion. Një pjesë e analizës së kryer është paraqitur edhe në Raportin vjetor që Institucioni ka dërguar në MASR, sipas formatit të kërkuar prej saj (Aneksi 31,31/1). Këto masa dhe të tjera që pritet të meren në vijim e kanë përmirësuar cilësinë e këtij programi. GVJ mendon se një proces i tillë nuk duhet konsideruar i përfunduar dhe ka nevojë për plotësime të tjera. Edhe ky proces vlerësimi I programit është</p>

	për të një mundësi shumë e vlefshme për të rritur standartet dhe performancën e institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni AI ka organizuar veprimtari periodike me personelin akademik dhe ndihmës dhe me studentët, në funksion të përmirësimit dhe sigurimit të një cilësie të qëndrueshme të programit të studimit që po realizon aktualisht. Një punë e tillë ka synuar së pari në trajnimin e pedagogëve dhe njohjen e tyre me objektivat e programit të studimit dhe rregulloret e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë (Aneksi 19). Në këtë proces janë përfshirë si pjesë integrale e këtij problemi edhe studentët që ndjekin këtë program studimi, por në raste të veçanta edhe ata që kanë studjuar më parë në këtë institucion. Po bëhen përpjekje që detyra për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit të shëndrrohet në kulturë institucionale dhe detyrë e përditëshme e të gjithë aktorëve që meren me implementimin e këtij programi studimi. Një problem i veçantë ku është fokusuar puna e strukturave drejtuese e njësive të institucionit është kualifikimi i diferencuar që u bëhet pedagogëve të rinj, sidomos me metodikat dhe njohuritë e mësimdhënjes e konceptet pedagogjike e psikologjike të këtij procesi. Me gjithë punën e bërë në këtë drejtim problem i sigurimit dhe i ruajtjes së cilësisë, ashtu si edhe realizimi i sukseshëm i programit të studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare”, janë një sfidë në proces e institucionit arsimor Akademia Ivodent. Dhe ky proces do të kerkojë kontribute të tjera materiale e njerzore në të ardhmen për të sigurur një konsolidim afatgjatë të fizionomisë së institucionit arsimor dhe të cilësisë së programit që ka ofruar dhe po realizon aktualisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Akademia Ivodent.”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi ofrohet në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të Institucionit Akademia Ivodent dhe në plotësim të kërkesave të ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë e Kërkimin shkencor në RSH “dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.
2. Është një program studimi në hapat e tij të para, por mbështetet mbi një traditë të mëparshme të ofrimit të studimeve profesionale dy vjeçare për laborantë dentar, të hapur në vitin 2004 si Institucion arsimor jo publik plotësues pararuniversitar në atë kohë.
3. Ka infrastrukturë laboratorike të ngritur që në programin e mëparshëm të studimit për laborant dentar dhe mbështetet nga Kompania Ivodent e cila kryen biznes edhe në fushën e materialeve dentare duke mbështetur kështu edhe programin e studimeve që ofrohet.
4. Ka marrëdhënie bashkëpunimi reciprok me kompani të vendit dhe të huaja në fushën e bashkëveprimit për qëllime biznesi dhe në atë të mësimdhënjes.

Pika të dobta:

1. Programi i studimit i ofruar nga ky institucion nuk është plotësisht i harmonizuar për tu dhënë vendin e vet disiplinave që mbulojnë, llojet e punimeve laboratorike që përdoren me shpesh.
2. Ka nevojë të rishikohet shpërndarja e orëve në çdo semestër e vit akademik, në mënyrë që të ketë ngarkesë sa më proporcionale të orëve mësimore për një kredit, bazuar edhe në shkallën e vështirësisë së informacionit që jepet.
3. Në program mungojnë lëndët me zgjedhje dhe dhënja e njohurive edhe në fushën e menaxhimit shëndetësor e të biznesit dhe të etikës e deontologjisë mjeksore.
4. Struktura e stafit akademik nuk plotëson kriteret e specialitetit dhe të nënspecialiteteve që lidhen me fushën e studimit që ofrohet si dhe kriteret për tituj e grada shkencore në këtë fushë studimi.
5. Biblioteka e AI ka nevojë të plotësohet me tituj të librave mësimor që lidhen me programin e studimit që ofrohet në sasi të mjaftueshme e që ti përgjigjet numrit të studentëve që frekuentojnë programin. Kjo vlen edhe për Revistat mjeksore të fushës së studimit që ofrohet. Edhe aksesit i librave e revistave on line që pretendohet të sigurohet duhet të jetë pikërisht për literaturë që lidhet me fushën e protezave dentare dhe me pak për fusha të tjera të mjeksisë.

Rekomandime:

1. Të rishikohet përmbajtja e programit për të harmonizuar më tej raportet midis disiplinave të specialitetit dhe ato teori-praktikë.
2. Në program të vendosen lëndë me zgjedhje ku të jepen njohuri për disa fusha të tjera që kërkohen nga studentët si menaxhim shëndetsor ekonomik, i laboratorëve dentar, njohuri me statistikën mjeksore dhe kërkimin shkencor, etikë dhe deontologji mjeksore etj.

3. Të bëhen përmirësimet e nevojshme sipas ligjit në përbërjen e stafit akademik dhe strukturën e Institucionit.
4. Të pasurohet biblioteka e Institucionit me libra hard copy që lidhen me programin e studimit, gjithashtu edhe biblioteka on line të sigurojë akses për libra e revista të stomatologjisë, kryesisht të fushës së protezave dentare që lidhet me programin.

Conclusions of the Evaluation of the study program Bachelor degree in "Higher Dental Technique" of Higher Education Institution "Ivodent Academy."

Strengths and affirmations:

1. This study program is offered in accordance with the mission and development strategy of the Ivodent Academy Institution and in accordance with the requirements of Law 80/2015 "On Higher Education and Scientific Research in the Republic of Albania" and its implementing legislation.
2. The program is in its early stages, but builds on a previous tradition of offering two-year studies for dental technicians, opened in 2004 as an additional non-public pre-university educational institution at the time.
3. Has a laboratory infrastructure set up in the previous dental technician study program and is supported by the Ivodent Company which conducts business in the field of dental materials thus supporting the study program offered.
4. There is mutual cooperation with domestic and foreign companies in the field of interaction for business and teaching purposes.

Weaknesses:

1. The study program offered by this institution is not fully harmonized to give its place to the disciplines that cover it, the types of laboratory work most frequently used.
2. There is a need to review the allocation of classes each semester and academic year in order to have a proportionate teaching load for a credit, based on the degree of difficulty of the information provided.
3. The program lacks elective courses and knowledge in the fields of health and business management and ethics and medical deontology.
4. The structure of the academic staff does not meet the criteria of specialty and sub-specialties related to the field of study offered and the criteria for titles and degrees in this field of study.
5. The AI library needs to be supplemented with textbook titles related to the study program offered in sufficient quantity to respond to the number of students attending the program. This also applies to medical journals of the field of study offered. Even the access to books and journals that are claimed to be secured should be precisely for literature related to the field of dental prostheses and less for other areas of medicine.

Recommendations:

1. Review the content of the program to further harmonize the relationship between the disciplines of specialty and those of theory-practice.



2. The program should include elective courses that provide knowledge on some other areas required by students such as health management, dental laboratories, knowledge of medical statistics and research, medical ethics and deontology, etc.
3. Make necessary improvements according to law in the composition of the academic staff and the structure of the Institution.
4. Enhance the Institution's library with hard copy books related to the study program, as well as the on-line library to provide access to dentistry books and journals, mainly in the field of dental prostheses related to the program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit Bachelor në
 “Teknikë e lartë dentare”

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT		X		
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT		X		
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE		X		
VLERËSIMI TËRËSOR		X		

MEMO

Mbi materialin “Komente mbi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të Programit të Studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” të Akademisë Ivodent, në kuadrin e akreditimit periodik”.

Kjo MEMO është hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm.

Me Materialin me titull: “Komente...” i dërguar nga AI, GVJ u njoh në datën 30/12/2019. Ai bën fjalë për disa komente që Institucioni i arsimit të lartë AI ka bërë lidhur me Draft RVJ, të cilin, ne si grup i vlerësimit të jashtëm, të thirrur e asistuar nga ASCAL, kemi hartuar lidhur me kërkesën e tij në kuadrin të akreditimit periodik. GVJ e shqyrtoi shumë kujdes materialin e institucionit dhe në paanshmeri të plotë, por dhe me përgjegjësi të plotë të kryerjes së kësaj detyre shumë të rëndësishme, po paraqesim mendimet tona si më poshtë:

Më datën 15 Tetor 2019, pasi ishim ftuar më parë nga Agjensia dhe ishim dakortësuar me të, u ftuam dhe ju nënshtruam një trajnimi të veçantë lidhur me programin e studimit të ofruar nga AI dhe detyrat e ekspertit të vlerësimit të jashtëm, procedurat, vizitën në Institucion, agjendën e veprimeve deri në hartimin e Draft RVJ e mëtej. Më pas na u vu në dispozicion RVB, të cilin e studjuam me kujdes dhe morëm informacion mbi punën e kryer dhe si e vlerësonte atë vetë Institucioni. Bashkë me raportin patëm në dispozicion edhe dokumentacionin shoqëruar të paraqitur në anekset përkatëse.

Pasi e shqyrtuam të gjithë dokumentacionin që na u ofrua, me mjaft vemendje dhe duke patur kohën e nevojshme në dispozicion, më datën 7 dhe 8 Nëntor 2019, kryem vizitën në institucion dhe pamë në teren të gjitha ato që na ishin informuar më parë me dokumentacion, pra ishim të përgatitur e të njohur paraprakisht me situatën lidhur me programin e ofruar për studime të ciklit të parë në AI, objekt i kërkesës për akreditim. Veç dy eksperteve të jashtëm, në përbërje të grupit ishin dy punonjës të ASCAL-it. në rolin e ekspertit teknik.

Ne pamë në teren të gjitha çështjet që ishin trajtuar në RVB dhe morëm kontakt me të gjithë grupet e interesit dhe me studentët. Axhenda që u zhvillua në dy ditë u respektua pikë për pikë sipas hartimit e miratimit të mëparshëm. Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Institucionit ishte përgjithësisht i mirë, vërejtjet dhe sugjerimet tona nuk u kontestuan nga askush. U kërkuar disa dokumenta shtesë të cilat na u thanë se janë gati dhe për arsye të ndryshme u la se do të na i dërgonin me njëherë on-line.

Pas shqyrtimit të situatës në Institucion dhe dokumentacionit të poseduar deri më datën 8 nëntor 2019, GVJ filloi hartimin e Draft Raportit, për të cilin na u theksua në AI se është në interes të institucionit të hartohet pa vonesë. Grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm nisi menjëherë punën për të përgatitur RVJ dhe është shprehur për çdo standart dhe kriter të veçantë në të, pa u ngutur, pa i tepruar problemet, por dhe pa i fshehur ato pasi kjo do të ishte një përgjegjësi e rëndë për ne dhe dëm i madh për arsimin e lartë dhe të ardhmen e studentëve. Ne bëmë përpjekje të paraqesim disa probleme të cilat ekzistojnë pa diskutim, por ti paraqesim të ambalazuara me kujdes e dashamirësi. Bile midis tyre zgjodhëm një pjesë, ato më pikantet, për të lënë hapësirë që disa të tjera të plotësohen e korigjohen në proces.

DRAFT RVJ, i hartuar nga ne, i diskutuar me përgjegjësi jo një herë, u dërgua në ASCAL dhe prej këtu në Institucionin AI. Pas disa ditësh, pikërisht më 30 dhjetor 2019, na u dërgua nga Agjensia një material i këtij Institucioni në formën e komenteve lidhur me vlerësimin tonë në raportin e paraqitur.

Draft Raporti i vlerësimit të jashtëm është i shtypur dhe mund të konsultohet nga kushdo ekspert dhe organet eprore të arsimit. Por situata na detyron të bëjmë edhe ne një farë komenti të "Komenteve" të A.I.

1. Për plotësimin e Standardit I.1, Kriteri 3, GVJ shprehet se:

"Përmbajtja e programit të studimit përputhet me qëllimin kryesor të AI për paisjen e studentëve me diplomën: "Teknikë e lartë dentare". Megjithatë në program mungojnë lëndë apo module që mundësojnë realizimin e plotë të misionit të AI si kryerja e kërkimeve të aplikuara në fushën e teknikës dentare dhe kryerja e studimeve dhe publikimeve në fushën e mjekësisë, fushë e cila del nga kompetencat e një Institucioni që ofron një program të vetëm studimi të lidhur ngushtësisht me fushën e Stomatologjisë."

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri;

Programi i studimit Bachelor në "Teknikë e Lartë Dentare" ofron mundësinë e kërkimit të aplikuar nëpërmjet njohurive teorike dhe praktike që ai ofron në lëndët kryesisht të vitit të dytë dhe të tretë si "Proteza e skeletuar", "Proteza totale e thjeshtë", "Protezat e kombinuara me atashmente", "Protezat e kombinuara me element në formë teleskopi", "Teknika dhe metoda në protezimin dentar", "Protezat mbi implante" etj., dhe laboratorëve profesionalë të mirëpajisur me aparatura dhe pajisje ekskluzivisht nga prodhuesit më cilësorë të tyre në botë si "Ivoclar Vivadent", "BEGO", "Max Stirl" etj. Pajisjen e laboratorëve dhe mundësitë për kërkim të aplikuar në to nga ana e stafit dhe studentëve, grupi i vlerësimit të jashtëm e vëzhgoi edhe gjatë vizitës. Në përfundim, bazuar në interpretimin e mësipërm, gjykojmë se konstatimi i GVJ del jashtë kontekstit të standartit I.1 dhe kriterëve respektive, që lidhen me fushën e veprimtarisë së institucionit, me misionin dhe qëllimin e tij që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. Për më tepër mendojmë se konstatimi "*mungojnë lëndë apo module që mundësojnë realizimin e plotë të misionit të AI si kryerja e kërkimeve të aplikuara në fushën e teknikës dentare dhe kryerja e studimeve dhe publikimeve në fushën e mjekësisë*" nuk mund të vlerësohet mbi ciklin e parë të studimeve bachelor.

Mendimi i GVJ në lidhje me këtë koment:

GVJ ka patur mundësinë të analizojë syllabuset e lëndëve "Proteza e skeletuar", "Proteza totale e thjeshtë", "Protezat e kombinuara me atashmente", "Protezat e kombinuara me element në formë teleskopi", "Teknika dhe metoda në protezimin dentar", "Protezat mbi implante" etj. Në asnjërën prej lëndëve nuk ka tema që japin njohuri mbi kërkimin shkencor. Për më tepër në program mungojnë lëndë me objektiv të mirëfilltë realizimin e kërkimeve shkencore. Nuk ka as ndonjë leksion apo modul që të paisë studentët me njohuri për kërkimin shkencor çka do të ishte e arsyeshme për këtë nivel studimi të ciklit të parë. Për sa më sipër, GVJ është referuar Statutit të Akademisë Ivodent, neni 4, pika D, ku në Misionin e tij, kjo akademi ka kryerjen e studimeve kërkimore-shkencore për të zhvilluar dhe tejçuar shëndetin dentar.

GVJ në lidhje me këtë koment rithekson: Programi që është në proces akreditimi i përket ciklit bachelor dhe është i vetmi program që AI ofron aktualisht.

2. Për përmbushjen e Standardit I.3, Kriteri 2, GVJ shprehet se "Mbështetur në Raportin e Vetvlerësimit, GVJ konstaton se vetë Institucioni është shprehur se ka bërë një studim tregu për vitin 2019. Në fakt, ky dokumentacion ka vetëm disa të dhëna, të dhëna të cilit GVJ mendon se nuk mund të jenë studim tregu."

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri;

Vlerësimi i tregut të punës në Shqipëri për teknikët dentarë është kryer dhe është paraqitur në formë tabelare në Aneks – Shtojcën e përmendur edhe në RVJ nr. 38 datë 2019-10-01. Vlerësimi është i plotë duke dhënë shifrat e marra nga organizmat shtetërorë kompetentë si Urdhëri i Infermierit, Urdhëri i Stomatologut apo INSTAT.

Ky vlerësim tregu në formë tabelare është i mjaftueshëm për të gjykuar mbi nevojën për teknikë dentarë në treg, specifikat e specialiteteve të nevojshme për tu pasqyruar në programin aktual të studimit, apo nevojën për të hapur programe të reja.

Në studim pasqyrohen shifrat “klasike” mbi numrin e teknikëve dentarë, laboratorëve dentarë, klinikave dentare, mjekëve stomatologë dhe kurorave të prodhuara në Shqipëri gjatë vitit 2018 të cilat japin nevojën për numrin e teknikëve të nevojshëm dentarë që njohin teknikat tradicionale të protezimit, i cili përllongaritet në mbi 50 në vit. Por në studim pasqyrohet qartë gjithashtu edhe tendenca drejt protezimeve të reja dentare si në fushën e implantologjisë, teknikave dixhitale në procesin e përgatitjes së protezave dhe protezimit ortodontik, që janë edhe zhillimet e reja në tregun e punës së teknikëve dentarë brenda dhe jashtë vendit. Mbi këtë bazë do të propozohen ndryshime në sylabuset e lëndëve dhe po punohet në hapjen e programeve të reja siç edhe ju është bërë prezent në draft programet e paraqitura në shtojcat 19.3 dhe 19.4.

GVJ në draft raport shprehet: Mbështetur në Raportin e Vetvlerësimit, GVJ konstaton se vetë Institucioni është shprehur se ka bërë një studim tregu për vitin 2019. Në fakt, ky dokumentacion ka vetëm disa të dhëna, të dhëna të cilit GVJ mendon se nuk mund të jenë studim tregu.

Aneks/shtojcë nr 38, datë 2019-10-01, Studimi i Tregut 2019

Mendimi i GVJ: GVJ ka parasysh një studim të mirëfilltë tregu për nevojat për laborantë dentarë dhe jo për të dhënate INSTAT (siç edhe vetë Ai konfirmon). Këto të dhëna mund ti aksesojë kushdo. GVJ nuk mund të pranojë si studim tregu të dhëna klasike siç është raporti Stomatolog/banorë apo stomatolog/teknik dentar. Këto janë shifra të cilat duhet të lexohen mirë dhe të analizohen nga Institucioni. GVJ shprehet se në dosjen e vetëvlerësimit me anekset përkatëse të saj nuk ka studim tregu të mirëfilltë për këtë program studimi. Ky studim u kërkua gjatë vizitës dhe GVJ ju prezantua se ky material është dhe do ngarkohet brenda ditës në sistem. Ky dokumentacion nuk ju vu në dispozicion GVJ. Ritheksojmë që edhe pse u kërkua gjatë vizitës nuk u dorëzua studim tregu.

3. IAL për përmbushjen e Standardit I.3, Kriteri 3, në koment shprehet: Lëndët “Fiziologji” dhe “Higjenë” janë pjesë e programeve të studimit Bachelor apo me karakter profesional që përgatisin teknikë dentarë. P.sh. në Universitetin e Umea, <https://ww.umu.se/en/education/programme-syllabus/oytat/rev/160/>, apo në Universitetin e Goteborg (Sahlgrenska Akademi) në Suedi, https://sahlgrenska.gu.se/digitalAssets/1345/1345738_utbildningsplan-tandtekn-2006.pdf. Për arsyet e mësipërme mendojmë se vlerësimi i dhënë në RVJ për përmbushje të Standardit I.3 “Përmbushet pjesërisht”, nuk reflekton realitetin e cilin ofrohet dhe zhvillohet programi i studimit në AI. Për më tepër programi është licensuar, akredituar nga MASH dhe APAAL sipas përmbajtjes aktuale.

GVJ në lidhje me komentin: Në draft GVJ shprehet se: “Ka në program lëndë edhe të formimit të përgjithshëm si Fiziologji, Higjenë të cilat i përkasin grup lëndëve të formimit të përgjithshëm pra jo të lidhura me profilin”. Në të gjitha materialet që përmban DVV e dorëzuar

nga IAL nuk pëfshihen referencat e përfshira në koment. Komenti ka shkëputur një sekuencë nga Draft RVJ, që e paraqitur kështu krijon përshtypjen se GVJ ka propozuar shmangjen e këtyre lëndëve nga programi. Diskutimi bëhet në kuadër të raportit të lëndëve të përgjithëshme me ato që kanë karakter formues dhe raportit më të harmonizuar midis tyre. Është praktikë e përsëritur e këtij komentit nxjerrja e frazave nga konteksti dhe interpretimi jo i saktë i tyre.

4. Për përmbushjen e standartit I.4, Në draft raport GVJ shprehet: "Njësia bazë që organizon këtë program studimi ka fushë akademike që i përshtatet profilit, 2 njësitë e tjera përbërëse të Fakultetit nuk përputhen plotësisht me profilin e studimeve në Teknikë e Lartë Dentare"

Mendimi I GVJ: GVJ konstaton se emërtimi njësisë së tretë, njësisë bazë, është i ndryshëm në dy dokumenta të ndryshme të paraqitura në Dosjen e Vetvlerësimit.

Kjo qëndër në organigramë titullohet Qendra e Studimeve Teknike, ndërsa në Rregulloren e Fakultetit emërtohet Qendra e Shërbimeve Dentare (neni 6, neni 12 i Rregullores)

Dok 18.1.Organigrama dhe personeli i AI.pdf, Dok 3. Rregullore Fakulteti_Ivodent.pdf

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti:

Mendojmë se ky standart përmbushet plotësisht për arsye se programi i studimit "Teknikë e Lartë Dentare" është plotësisht në përputhje me fushën Akademike të Fakultetit të Teknikave Dentare si dhe departamentit të protetikës si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi në Akademinë Ivodent. Të gjitha lëndët dhe objektivat e këtij programi janë në përputhje dhe specializojnë në fushën e protezimit dentar dhe teknikave dentare. Për këtë arsye gjykojmë që vlerësimi i ekspertëve të rishikohet.

Mendimi I GVJ: Vlerësimi për këtë Standard është: Standarti përmbushet kryesisht.

5. Për përmbushjen e standartit I.5 kriteri 1, Institucioni AI citonRVJku thuhet:

GVJ shprehet se: "Akademia përbëhet nga 2 departamente dhe një qëndër të zhvillimit të teknikave por programi i studimit realizohet vetëm nga Departamenti i Protetikës. Funkzioni dhe mënyra si bashkërendojnë dhe se çfarë realizojnë dy departamentet e tjera është vetëm se anëtarët e stafit aktivizohen në procesin mësimor"

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti:

Duke pasur parasysh faktin se personeli akademik efektiv i të tre njësive bazë është 10 vetë, përse i përket programit të vetëm të studimit ai funksionon si një departament dhe bashkërendimi dhe analiza e punës së tyre realizohet në disa organe të cilat mbledhen rregullisht si Asambleja e personelit akademik, Senati Akademik apo Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë siç duket në një shembull edhe nga "procesverbali i mbledhjes së Senatit dhe Asamblesë" i dërguar nëpërmjet AMS me dokumentat e kërkuara shtesë nga ekspertët në datën 12.11.2019. Për të dhënë një shembull të mëtejshëm të bashkëpunimit brenda strukturave të FTD për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit theksojmë se Dr. Ardita Fuga dhe Dr. Gani Kastrati janë anëtarë të NJSBC që vlerëson cilësinë e programit. (Aneksi 18.1 Organigrama dhe personeli i AI)

GVJ në lidhje me komentin: Dr G.K nuk është pjesë e personelit akademik në vitin 2018-2019 bazuar në dokumentin nr 11 të ngarkuar në AMS pas vizitës në AI. Në rrjeshtin eII-të të këtij komentit është thënë se: "personeli akademik efektiv i të tre njësive bazë është 10 vetë,

përsa i përket programit të vetëm të studimit ai funksionon si një departament.” GVJ nuk e ka të qartë se nëse është kështu siç vetë institucioni komenton , është departament apo Fakultet?, sepse Fakultet me një departament nuk ka.

6. **Për përmbushjen e standartit I.5, kriteri 2,**GVJ shprehet se:”*Institucioni disponon disa marrëveshje me Institucione homologe por nuk ka konkretizime. GVJ konstaton se njëri prej marrëveshjeve jo vetëm i ka mbaruar afati por edhe nuk i përket këtij Institucioni. (Dokumenti 36.1 në AMS). Gjithashtu edhe marrëveshja sipas dokumentit nr. 6 të ngarkuar në sistem, pas kërkesës së bërë gjatë vizitës së GVJ në Institucion nuk i përket kësaj Akademie”*

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti:
Akademia Ivodent ka marrëveshje bashkëpunimi me të tre Institucionet e Arsimit të Lartë që ofrojnë programe studimi në fushën e Teknikave Dentare, Universitetin e Mjekësisë së Tiranës (Fakulteti i Mjekësisë Dentare), Universitetin Aldent dhe Albanian University. Konkretizimet e këtyre marrëveshjeve janë të shumta si në organizim aktivitetesh shkencore të përbashkëta. Evidencë e këtyre konkretizimeve mund të vihet në dispozicion. Përsa i përket marrëveshjes së aneksin 36.1 midis ”Ivoclar Vivadent A.G.” dhe ”Ivoclar Vivadent & Partners” në vitin 2003 ajo ka qënë e vlefshme për një periudhë 5 vjeçare. Institucioni ”Ivoclar Vivadent & Partners” u shndërrua më vonë në Kolegjin Profesional Privat ”Ivoclar Vivadent & Partners” dhe më pas në Akademinë Ivodent. Kjo marrëveshje ka siguruar bashkëpunimin tonë me prodhuesin më të madh në botë të qeramikës dentare në periudhën kur këtë bashkëpunim nuk e mbulonte marrëveshja me përfaqësuesin e ”Ivoclar Vivadent A.G.” për Shqipërinë, Dorina Mele Co.

Marrëveshja me Dorina Mele Co. është nënshkruar në Vitin 2016 dhe prandaj është lidhur me Kolegjin Profesional privat “Ivoclar Vivadent & Partners”, që ishte edhe forma e mëparshme e funksionimit të Akademisë Ivodent në këtë kohë. Kjo marrëveshje është nënshkruar para noterit pranë të cilit është depozituar edhe ndryshimi i realizuar pas riorganizimit të Kolegjit Profesional Privat ”Ivoclar Vivadent & Partners” në Akademinë Ivodent në dhjetor 2016 duke e bërë këtë marrëveshje të vlefshme edhe ndërmjet Dorina Mele Co. dhe Akademisë Ivodent. Marrëveshja me Dorina Mele Co. i siguron studentëve të programit të studimit Teknikë e Lartë Dentare të paktën 6 ëorkshop-e në vit, siç del edhe nga dokumenti (35.3 Lista e trajnimeve të zhvilluara 17-19 AI) ku renditen 14 ëorkshope të dokumentuara edhe me certifikata në anekset 35.3.1-35.9.1. Këto trajnime kryhen nga profesionistë shumë të mirë të fushës që vihen në dispozicion nga qëndrat e edukimit të aktorëve prodhues më të mëdhenj të biznesit botëror të materialeve dhe aparaturave e pajisjeve dentare si ”Ivoclar Vivadent A.G., BEGO, RHEIN83, RENFERT, SCHEU Dental”. Ato jepen falas për studentët e këtij programi dhe shërbejnë për realizimin shumë cilësor të objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve. Si një provë të saj mund të shihni edhe shpalljen e Akademisë Ivodent si partneri për Shqipërinë i ”International Center for Dental Education” i kompanisë Ivoclar Vivadent A.G. (ivoclarvivadent.com/en/partner-of-icde)

Mendimi i GVJ në lidhje me komentin: GVJ ka një paqartësi në lidhje me përgjigjen e AI: Përderisa deklaroni se keni “marrëveshje bashkëpunimi me të tre Institucionet e Arsimit të Lartë që ofrojnë programe studimi në fushën e Teknikave Dentare, Universitetin e Mjekësisë së Tiranës (Fakulteti i Mjekësisë Dentare), Universitetin Aldent dhe Albanian University”, GVJ nuk pa apo nuk evidentoi asnjë ftesë a bashkëpunim me ndonjë nga këta Institucione. Në përgjigjen e tij Institucioni citon vetëm ëorkshopen e Ivoclar vivadent, të cilat vërtetë vinë në Shqipëri, por për të promovuar materialet dhe aparaturat e tyre. Në vendin tonë ka shkolla të

larta të konsoliduara që përgatisin teknikë dentar dhe stafe akademike plotësisht sipas kërkesave ligjore dhe do të ishte e dobishme të bashkëpunohet me to sidomos në fushën e mësimdhënies.

7. Për përmbushjen e standartit I.5, kriteri 3, GVJ shprehet se: *Nuk ka raporte që analizojnë përfitimet nga marrëveshjet.*

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Institucioni mendon se GVJ duhet të rishohë këtë vlerësim pasi standarti "Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit", si dhe Kriteri 3. "Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve", duhet të vlerësohen në kontekstin e kohës dhe mbi situatën aktuale në të cilën gjendet AI. Në raportet analitike të vëna në dispozicion, RVB fq 8, raportimet e bëra në MASR në kuadër të lidhjes së marrëveshjes si dhe gjatë vizitës në institucion, Akademia është fokusuar maksimalisht në lidhjen e marrëveshjeve të reja me partnerët e vet si Akademi dhenë këtë kontekst janë bërë përparime të mëdha. Sigurisht vlerësimi i përfitimeve nga këto marrëveshje është prioritet por sikundër është theksuar, viti akademik 2018 – 2019 ka qënë viti i parë ku AI funksionon me kapacitet të plotë dhe se shumica e marrëveshjeve me institucionet janë lidhur këtë vit akademik. Në këtë fazë të parë institucioni është fokusuar në realizimin e veprimtarive dhe është ende herët për të arritur në konkluzione analitike për përfitimet nga marrëveshjet e nënshkruara.

Mendimi i GVJ në lidhje me këtë koment: Nuk pranohet sugjerimi i AI në lidhje me rishikimin pasi ky proces akreditimi përfshin një periudhë 6 vjeçare, duke qënë se vetë Institucioni ka theksuar se është akreditim periodik. GVJ shprehet se për sa më sipër, sidoqoftë situata dhe fazat në të cilat vetë institucioni shprehet se ndodhet, parashikime të besueshme duhet të bëhen.

8. Për përmbushjen e standartit I.5 kriteri 4, GVJ shprehet se: "Në vitin akademik 2019 Institucioni ka parashikuar të fillojë organizimin e praktikave profesionale në laboratorë me të cilët ka marrëveshje, por nuk konstatohen të tilla. Pamvarësisht se sikurse u deklarua gjatë vizitës së GVJ në AI kjo praktikë do fillojë të aplikohet në vitin 2019 në AMS është ngarkuar dokumenti me nr 30.3 që dokumenton kryerjen e praktikës profesionale në periudhën 2018-2019"

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Akademia Ivodent ka një traditë të gjatë të bashkëpunimit me laboratorët dentarë privatë për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve të saj pranë tyre. Në këtë kuadër prej shumë vitesh Akademia ndërmjetëson studentët të kryejnë praktika jashtë realizimit të programit zyrtar, por shumë të ngjashme me praktikën e kryera në laboratorët e Akademisë. Shumë shpesh, dokumentimi i këtyre praktikave është kërkuar nga studentët të cilët kanë kërkuar njohjen e diplomave në vende Europiane, sepse orët e praktikës ishin të mangëta në programin e studimit të para 2018. Për këtë arsye, në vitin Akademik 2018-2019, pavarësisht se nuk është pjesë e programit të studimit, është kërkuar nga bashkëpunorët tanë që të plotësojnë një formular drejtuar Akademisë Ivodent si ai i aneksit 30.3. Në këtë mënyrë edhe studentët që kanë nisur studimet me programin e para 2018-ës do mundën të evidentojnë saktë orët e praktikës të kryera jashtë programit dhe ambjenteve të Akademisë Ivodent në rast se kjo do ju kërkohej. Ky dokument është përgatitur në Akademinë Ivodent për t'u përdorur gjatë realizimit

të praktikave profesionale brenda programit të studimit (lënda Praktikë Profesionale I) në subjektet dentare private me të cilat Akademia ka marrëveshje.

Mendimi i GVJ në lidhje me këtë koment: Orët jashtë programit nuk mund të jenë në dëshirën e studentëve dhe aq më tepër të rrisin në mënyrë artificiale ngarkesën e kërkuar në raste specifike si ato të permendura në koment për studentet që kanë kërkuar njohjen e diplomave. Fakti që orët e praktikës ishin të mangëta në programin e studimit para 2018 nuk përmendet në RVB ashtu sikurse ndryshimet e programit nuk paraqesin rritje të orëve të praktikës.

Për këtë arsye GVJ nuk pranon ndryshime të standartit.

9. **Për përmbushjen e standartit I.5 kriteri 5,** GVJ shprehet se: *"Në vitin akademik 2018-2019 janë realizuar disa ëorkshope për studentët aktuale dhe ata të diplomuar. Nuk dokumentohet si përfshihen këto aktivitete në ngarkesën e procesit mësimor"*

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Në të gjitha ëorkshop-et e listuara në aneksin 35.3, por edhe në të gjithë ëorkshop-et e realizuara në Akademinë Ivodent me lektorë të huaj (që prej vitit 2004 deri tani janë afërsisht 100 të tilla) janë ftuar dhe kanë marrë pjesë edhe studentë të diplomuar më parë në programin tonë të studimit dhe kjo vërtetohet me certifikatat e tyre të pjesëmarrjes. Në gjykimin tonë është e paqartë pse kërkohet përfshirja e këtyre aktiviteteve për të diplomuarit në ngarkesën e procesit mësimor kur të diplomuarit e kanë kryer atë të plotë dhe kanë nevojë për tematika të reja trajnimi dhe informimi përtej përmbajtjes së programit BSc. Për arsyet e sipërpërmendura mendojmë se shkalla e përmbushjes së standartit 1.5 nuk përputhet me realitetin në të cilën ofrohen këto trajnime (referuar kriterit 5). **Në përfundim të komenteve të mësipërme, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentet e mësipërme, mendojmë se shkalla e plotësimittë standarteve dhe kriterëve të Fushës 1, duhet të rishikohen nga GVJ.**

Mendimi i GVJ në lidhje me këtë koment: Nuk pranohet rishikimi i plotësimittë kriterit. Në RVB, AI për standartin I.5 kriteri 5, GVJ shprehet se: *"Në vitin akademik 2018-2019 janë realizuar disa ëorkshope për studentët aktuale dhe ata të diplomuar."* Bazuar në këtë GVJ kërkoi dokumentimin e përfshirjes së kësaj ngarkese me atë të studentëve aktualë. Ata që janë diplomuar dhe specialistë të tjerë të stomatologjisë bëjnë shumë mirë që i ndjekin ato për hesap të tyre. Për studentët aktualë është kërkuar sqarim këtu. Gjithashtu nuk dokumentohet cilët nga studentët e diplomuar ka marrë pjesë në këto ëorkshope dhe si është bashkërenduar me punëdhënësit.

KOMENTE LIDHUR ME FUSHËN II, "ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR"

1. **Për përmbushjen e standartit II.1 kriteri 3,** GVJ shprehet se: *"Programi i studimit ka një lidhje shumë të ngushtë me praktikën pra produkti është një teknik i lartë dentar me orientim vetëm praktik dhe jo akademik"*

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Në aneksin 16.2, programi mësimor 18-21 TLD dhe në aneksin 30, syllabuset e lëndëve TLD, jepen orët teorike dhe praktike të ngarkesës në auditor. Orët e leksioneve teorike dhe të seminareve, që përcaktojnë formimin akademik të këtij programi janë në përputhje me VKM nr.41 dt. 24.01.2018 "Për elementët e programeve...", programi është licensuar dhe miratuar nga MASH, akredituar nga APAAL në vitin 2013 me pothuaj të njëjtën përmbajtje. Për më

tepër theksojmë që në vitin 2013, pjesë e GVJ për akreditim ka qënë një eksperte ndërkombëtare e fushës e cila jo vetëm që ka vlerësuar programin dhe përmbajtjen e tij si të përshtatshme por edhe realizimin mjaft cilësor të tij. GVJ mund të kërkoj në ASCAL, RVJ të asaj periudhe, për të konfirmuar këtë konstatim. Nisur nga detyrimet që lindin nga përmbushja e VKM nr.41 dt. 24.01.2018, plani mësimor, raportet midis veprimtarive formuese, syllabuset e lëndëve si dhe konfirmimin e MASR pas heqjes së pezullimit, **është i paqartë konkluzioni i GVJ se orientimi i programit është jo-akademik.** Për më tepër ky vlerësim nuk përputhet me kërkesën e Standardit II.1 dhe Kriterit 3. *“Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës”.*

Mendimi i GVJ në lidhje me këtë koment:GVJ mendon se është i drejtë konkluzioni në lidhje me plotësimin e standartit. Referuar syllabuseve ato janë hartuar në përmbushje të VKM nr 41/2018, por sa i përket orëve teorike dhe atyre praktike nuk korrespondojnë me shtrirjen përgjatë 15 javëve që duhet të ketë një semestër akademik. Në lidhje me paragrafin përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit, të gjithë syllabuset përmbajnë aftësimin e studentëve për realizimin e punimeve të ndryshme protetike.

2. **Për përmbushjen e standartit II.1 kriteri 4,** GVJ shprehet se: *“Programi i studimit pais studentët me kompetenca profesionale praktike në fushën e teknikave dentare, konkretisht të procedurave që kryen një teknik dentar në kryerjen e punimeve të ndryshme protetike”*

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti:Ky program pajis studentët me aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën profesionale të teknikave dentare të cilat mundësojnë zgjidhjen e rasteve komplekse të protezimeve dentare sidomos kur kërkohet zgjidhje e kombinuar e protezave. Programi aftëson studentët që në bashkëpunim me mjekun stomatolog t’i propozojnë pacientit disa zgjidhje për protezimin e tij dentar. Synimi për të arritur këtë aftësim dhe mënyra se si kjo arrihet jepet në aneksin 16, dosja e programit të studimit 2018-2021.

Në lidhje me komentin GVJ shprehet: Megjithëse është thënë më përmbledhtas është e njëjta gjë, është pohuar se ky standart në draft RVJ nuk bie ndesh me objektivin formues të programit të studimit në Teknikë e lartë dentare. Plan i mjekimit gjatë mjekimit protetik të pacientëve është detyrë e mjekut stomatolog.

3. **Për përmbushjen e standartit II.2 kriteri 1,**GVJ shprehet se: *“Që prej vitit 2016 AI deklaroi 50 kuota të reja pranimit referuar aneksin nr. 68.”*

Vlerësimi i AI ndaj kësaj reference të shprehur në RVJ:Në aneksin 6.1, (kriteret & miratim kuotash 2019), theksohet fakti se janë miratuar 50 kuota pranimesh për Vitin Akademik 2019-2020. Në vitet e mëparshme numri i kuotave ka qënë më i ulët. Rritja e kuotave në vitin 2019-2020 korrespondon me shtimin e hapësirave në funksion të procesit mësimor me 137 m².

Në lidhje me këtë koment: GVJ rikonfirmon përmbajtjen e draft RVJ-së pasi referuar dokumentit nr. 31 në AMS për funksionimin normal të Institucionit numri maksimal i studentëve nuk duhet ti kalojë 72 studentë.

4. **Për përmbushjen e standartit II.2, kriteret 2-5** GVJ shprehet se: *“Referuar detyrimeve të nenit 25, pika 4 e ligjit 80/2015 AI ka nënshkruar një marrëveshje me MASR dhe përjashtohet nga detyrimi për numrin minimal të PAE”*

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Në aneksin 28 që nënkupton marrëveshjen ndërmjet MASR dhe AI "Për përcaktimin e numrit të personelit akademik me kohë të plotë, në njësitë bazë, në Akdeminë Ivodent" nr. prot. 5969, dt. 06.06.2019 përcaktohet se;

"1. Departamenti i protetikës, departamenti i ortodoncise dhe qendra e studimit të teknikave, që janë njësi bazë të Fakultetit të Teknikave Dentare do të kenë të paktën nga një personel akademik, me kohë të plotë, që zotëron gradë shkencore apo titull akademik

2. Institucioni i arsimit të lartë Akademia Ivodent të ketë në përbërje të secilës njësi bazë minimalisht mjaftueshëm personel akademik me kohë të plotë në mënyrë që këta të fundit të mbulojnë 70 % + të ngarkesës mësimore në secilën njësi bazë."

Këto kushte të marrëveshjes dhe ato të pikës 4, të nenit 25 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", janë përmbushur dhe përmbushen plotësisht dhe janë në përmbushje të marrëveshjes së lidhur midis AI dhe MASR. Për këtë arsye, mendojmë se gjykimi mbi shkallën e përmbushjes së kriterëve të mësipërme, duhet të rishikohet.

Në lidhje me këtë koment: Grupi i vlerësimit të jashtëm mendon se konstatimi në Draft RVJ është i drejtë, pasi kërkesat në përmbushje të kriterëve nuk kanë të bëjnë vetëm me përmbushjen e marrëveshjes me MASR.

5. Për përmbushjen e standartit II.4, kriteri 4 GVJ shprehet se: "Një numër të madh kreditesh, 20 kredite, kanë lëndë të lidhura me materialet dentare me të cilat studentit do ti duhet të punojë, por këto lëndë nuk mund të kenë sasi pothuajse të barabartë me praktikën profesionale që ka 19 kredite. Dhe nga biseda me studentët u paraqit që preferonin të kishin më shumë praktikë. Referuar RVB faqe nr 15 ky program studimi përafrohet me programe të ngjashme ndërkombëtare por nuk përmendet cilit program dhe cilit shtet.."

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri: Në programe të ngjashme të Universiteteve të Umea-s dhe Goteborg-ut në Suedi, lëndët e lidhura me materialet dentare janë të vlerësuara me rreth 20 kredite. Në programin tonë të studimit ato parashikohen me 20 kredite ose 240 orë në auditor. Ndërsa, lëndët e praktikave profesionale I dhe II kanë gjithsej 19 kredite, por parashikohen 440 orë ose 18 javë mësimore. Nëse do të llogarisnim edhe kreditet dhe orët e praktikave mësimore të pavaruara në laboratorët e Akademisë Ivodent, atëherë kreditet dhe orët e praktikave, së paku do të dyfishoheshin. AI ka eksperiencë të gjatë në ofrimin e këtij programi dhe falë kësaj eksperience si dhe feedback të dhënë vazhdimisht nga të diplomuarit, shkallën e tyre të punësimit, përmbajtja e programit dhe raportet e veprimtarive, është në nivelin e kërkuar brenda kuadrit ligjor.

Në lidhje me këtë koment GVJ shprehet se: e konsiderojmë të drejtë vlerësimin e dhënë në draft RVJ. Në asnjë nga dokumentet e përfshira në DVV nuk kemi patur mundësinë e njohjes me programet e dy Universiteteve që përmenden në komentin e GVJ. Tregu suedez ka hapësirë të gjerë në prodhimin e materialeve dentare dhe bën politikën e tij. Tek ne ky treg akoma nuk njihet dhe mund të jetë detyrë e së ardhmes. Tek ne ka përparësi formimi klinik i specialistëve. Sa i përket ekuivalentimit të krediteve në orë sipas VKM 41/2018, 20 kredite janë 500 orë (në auditor dhe punë e pavarur) dhe jo 240 orë në auditor sikurse përmendet në koment.

Sa i përket orëve të praktikës profesionale ka 19 kredite si lëndë më vete dhe i jemi referuar duke e konsideruar të tillë.

6. Për përmbushjen e standartit II.4, kriteri 6 GVJ shprehet se: "Programet e lëndëve nuk kanë pësuar përditësime. Literatura është kryesisht cikël leksionesh të cilat AI jua vë në dispozicion studentëve disa prej të cilave si Fizilogji, Histologji, Ortodonci janë krijuar për vitin akademik 2017-2018. Nuk kishte kopje në bibliotekë."

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri: Programet e lëndëve të formimit karakterizues përditësohen kryesisht në pjesën e tyre praktike, në varësi të materialeve, pajisjeve, apo procedurave të prodhimit të protezave dentare dhe përditësimi i tyre vërehet në modernizimin e materialeve dhe pajisjeve në laboratorët e AI (shih Aneksi 37, Raporti i Infrastrukturës 2016-2019). Literatura është e përditësuar me libra të 5 viteve të fundit (shih aneksin 30, Sylabuset e lëndëve TLD) të cilat ju vihen në dispozicion studentëve në bibliotekë si hard-copy ose nëpërmjet librarisë on-line R4L, të cilën studentët mund ta përdorin edhe në kompjuterat e tyre personalë. Ciklet e leksioneve ju shpërndahen falas studentëve në fillim të vitit akademik. Referuar numrit të studentëve dhe mundësive të ofruar në literature (botime, cikël leksionesh, libraria on line), mendojmë se vlerësimi i dhënë nga GVJ duhet të rishikohet veçanërisht për Standardin II.2, Standardin II.4 dhe Standardin II.5. Referuar argumenteve të mësipërme dhe informacioneve të vëna në dispozicion, mendojmë se vlerësimi tërësor për shkallën e përmbushjes së fushës 2, duhet të rishikohet.

Në lidhje me këtë koment dhe mendimin për rishikimin tërësor të shkallës së përmbushjes së fushës 2 GVJ refuzon me argumentin: Nuk ka asnjë dokument që të evidentojë përditësimet e programeve të lëndëve. Sa i përket komentit: "Literatura është e përditësuar me libra të 5 viteve të fundit (shih aneksin 30, Sylabuset e lëndëve TLD) të cilat ju vihen në dispozicion studentëve në bibliotekë si hard-copy ose nëpërmjet librarisë on-line R4L, të cilën studentët mund ta përdorin edhe në kompjuterat e tyre personalë. Ciklet e leksioneve ju shpërndahen falas studentëve në fillim të vitit akademik" nga vëzhgimi i syllabuseve janë 6 tekste në total prej të cilëve 2 të vitit 2014, të tjerët 2006, 2008, 2009. Tekste mësimore në hard-copy në bibliotekë nuk gjetëm.

KOMENTE LIDHUR ME FUSHËN III, "MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT"

1. Për përmbushjen e standartit III.3 kriteri 5, GVJ shprehet se: "Nuk ka evidenca të lidhura me nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mësimdhënies". Në RVB fq 20, anekse 14, 15 si dhe gjatë vizitës në institucion, është theksuar që AI inkurajon zhvillimin dhe zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies. Disa nga veprimtaritë e deklaruara përfshirja e stafit të huaj etj, janë edhe në funksion të përmirësimit të mësimdhënies.

Mendimi i GVJ: Në lidhje me këtë koment GVJ dëshiron të vërë në dukje se nuk pranon ndryshime pasi nuk ka konstatuar në asnjë material të dorëzuar me DVV që të argumentojë dhe dokumentojë çfarë konkretisht është realizuar.

2. Për përmbushjen e standartit III.3 kriteri 1, GVJ shprehet se: "GVJ gjatë vizitës në Institucion pa me kujdes infrastrukturën në funksion të programit. Hapësirat janë të rregullta dhe të pastra. Në vite ka pasur përmirësime të infrastrukturës. Aktualisht kanë 4 laboratorë:

- 1) Laboratori funksional me sipërfaqe 54 m²,
- 2) Laboratori i protezës fikse me 57 m²,

3) Laboratori i protezës së lëvizëshme 15 m²,

4) Laboratori i teknikave dixhitale 28 m²,

Gjithashtu Institucioni ka edhe sallë leksionesh që ka sipërfaqe 33 m², sallë për seminare 35 m².”

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri: Në hapësirat në funksion të mësimit duhet të llogaritej edhe Salla e konferencave (30 m²) e cila përdoret për leksione të hapura me lektorë shqiptarë e të huaj, pjesën teorike të çorkshopeve që në AI zhvillohen të paktën 7 herë në vit siç shprehet qartë me fjalë dhe foto në aneksin 37 (Raporti i Infrastrukturës 2016-2019). Të gjitha hapësirat në funksion të mësimdhënies janë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi mbi ndriçimin, lartësinë e ambjenteve, higjenën dhe sipërfaqen në dispozicion të studentëve (Aneksi 31.2 Verifikimi i Kapaciteteve_MASR) dhe janë objekt i vlerësimeve të vazhdueshme nga MASR.

Në lidhje me këtë koment GVJ thekson: Salla e konferencave (30 m²) është një aset i AI që edhe pse nuk është përfshirë në draft RVJ nuk çënon plotësimin e standarteve. Për këtë arsye GVJ nuk shikon të domosdoshme ndryshime në draft.

3. Për përmbushjen e standartit III.3 kriteri 2, GVJ shprehet se:”Laboratorët janë të paisur me të gjitha aparaturat e domosdoshme për një laborator dentar. Ndër paisjet që disponojnë përfshihen: 3 furra porcelani, mikroskop, aparat pastrimi sablozë, 5 mikromotora, trimera, furrë për derdhjen e metalit, aparat për skanimin e modeleve, 2 kompjutera për dizenjimin e modeleve etj.”

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri: Pajisjet laboratorike dhe cilësia e tyre është një nga prioritetet kryesore të akademisë dhe ka marrë ndoshta investimet më të mëdha. Bazuar në kërkesat e partnerëve e të cilët AI bashkëpunon, **laboratorët aktualë janë në nivelin më të mirë në vendin tonë.** Ky vlerësim vjen nga partnerët vendas ku studentë të Fakultetit të Mjekësisë Dentare vijnë për të kryer praktikat laboratorike në mjediset e laboratorëve tona në kuadër të marrveshjes së nënshkruar. Gjithashtu, vlerësimi i pajisjeve në laboratorët ku kryhet pjesa praktike e programit është jo i plotë. Aparaturat, instrumentat, pajisjet dhe materialet laboratorike të paraqitura në Aneksin 37 janë vetëm të prodhuesve më cilësorë botërorë si Ivoclar Vivadent (Litenshtein), BEGO (Gjermani), Renfert (Gjermani), ASA Dental (Itali), Max Stirl (Itali), TAVOM (Itali), Dentialfarm (Itali) dhe KOMET (Gjermani). Pajisja me to i është mundësuar AI nga këto kompani me cmime shumë të favorshme indirekt, nëpërmjet marrveshjes me përfaqësuesin e tyre në Shqipëri Dorina Mele Co. (Aneksi ”Marrveshja Dorina Mele Co. datë 12.11.2019), dhe pavarësisht nga oferta, investimi vetëm në aparatura i kalon 150.000 eurot (Shiko Aneksi 37).

Nuk është përmendur në vlerësim që sallat e leksionit, konferencës dhe seminarit janë të pajisura me sisteme Videocasting audio dhe video që lejojnë komunikim në distancë dhe ofrimin e leksioneve online (e-learning) (Aneksi 37). Në sallën e konferencave sistemi Videocasting është i lidhur edhe me klinikën pranë laboratorit të Protetikës Fikse që lejon realizimin e leksioneve dhe trajnimeve me ilustrim të drejtpërdrejtë të proceseve që kryhen në gojën e pacientit (shiko Aneksi 37).

Pajisja e laboratorëve me vetëm ”3 furra porcelani, mikroskop, aparat pastrimi sablozë, 5 mikromotora”, nuk shpreh realitetin e pasqyruar në Aneksin 37 dhe atë që vlerësuesit duhet të kishin konstatuar gjatë vizitës në AI. Në laboratorët e AI disponohen 36 mikromotorë, 5 furra porcelani dhe 3 aparatura pastrimi me rërë.

Nga ana tjetër mbeten pa u përmendur aparaturat e domosdoshme për plotësimin e programit të lëndëve të mëposhtme: "Proteza Totale" dhe "Proteza totale biofunktionale" (Sistemet IVOCAP dhe IVOBASE, të prodhuesit Ivoclar Vivadent); "Protezat e kombinuara me atashmente" dhe "Protezat me elementë në formë teleskopi" (Parascop M (1 cope) dhe paralelometra (10 copë), Laser Dentar LYNX (1 cope), Be Ce Turbine (1 cope) të prodhuesit BEGO); "Proteza fikse pa metal" (Sistemi EMPRESS i presimit të qeramikës, i prodhuesit Ivoclar Vivadent). (Të gjitha këto janë të dhëna me foto dhe përshkrim në Aneksin 37). Së fundmi, plotësimi i standardit III.3 bie ndesh edhe me vetë gjykimin e GVJ ku nga njëra anë vlerësojnë që programi ka orientim praktik dhe nga ana tjetër gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike enevojshme për realizimin e këtyre veprimtarive, nuk është në nivelin e duhur. Ne mendojmë që GVJ, referuar numrit të programeve, numrit të studentëve, nivelit të laboratorëve dhe infrastrukturës të vënë në dispozicion, mund të rishohë vlerësimin e vet mbi këtë standard.

GVJ në lidhje me këtë koment duke kundërshtuar opinionin e AI shprehet: AI disponon paisjet e mjaftueshme dhe ndër to ka përmendur disa. Mos përmendja e të gjithë paisjeve nuk mund të ekuivalentohet me mungesën e paisjeve. Gjithashtu në lidhje me pretendimin se: "Nuk është përmendur në vlerësim që sallat e leksionit, konferencës dhe seminarit janë të pajisura me sisteme Videocasting audio dhe video që lejojnë komunikim në distancë dhe ofrimin e leksioneve online (e-learning) (Aneksi 37)", GVJ shprehet se AI nuk ofron studime në distancë.

Në lidhje me pretendimin se: "Në sallën e konferencave sistemi Videocasting është i lidhur edhe me klinikën pranë laboratorit të Protetikës Fikse që lejon realizimin e leksioneve dhe trajnimeve me ilustrim të drejtpërdrejtë të proceseve që kryhen në gojën e pacientit (shiko Aneksi 37)", GVJ nuk ka patur ansjë dokument ilustrues të të tilla aktiviteteve. Nga çfarë AI paraqet në koment, GVJ nuk ka ndonjë kundërshti, por ne jemi shprehur në mënyrë të përmblendhur. Është në të drejtën e Institucionit që të shënojë markat e aparatrave që disponon, por kjo i ka marrë shumë hapësirë komentit. Ne pranojmë se kemi harruar të shënojmë se: "laboratorët aktualë janë në nivelin më të mirë në vendin tonë", që AI e konsideron kështu. GVJ mendon pak më ndryshe, pasi kemi patur rastin të vizitojmë edhe laboratore të tjere të cilat janë pjesë e Institucioneve të Arsimit të lartë që ofrojnë programe në këtë fushë. Në takim me personelin e Institucionit AI, me gojën e vet Rektorit I. M., na u tha se jemi të përgatitur për të pranuar 24 studentë dhe se një post studentit kushton shumë. Kjo është krejt e vërtetë, por nuk e kemi shënuar pasi e vlerësojmë shumë sinqeritetin dhe komunikimin konfidencial të tij. Komenti kaq i gjatë për këtë çështje është bërë në RVB, ndaj ndoshta mund të ishte më i kursyer.

GVJ nuk ka bërë ndonjë vërejtje në Draft RVJ por edhe gjatë vizitës për cilësinë e aparatrave.

4. Për përmbushjen e standartit III.3 kriteri 3, GVJ shprehet se: "Institucioni ka mbulim me Ëi-Fi."

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Institucioni ka mbulim me Ëi-Fi dhe 12 poste pune me kompjutera me softëare të licensuar të Microsoft office, të lidhura me internet të shpejtë 30 Mb/s në dispozicion të studentëve në ambientet e bibliotekës. AI ka dy faqe interneti (ivodent.org dhe ivodent.edu.al ku studentët shkarkojnë materiale mësimore apo info që lidhen me procesin mësimor) siç jepen në aneksin 37.

Standarti III. 3 "Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor."

Për plotësimin e këtij standarti GVJ shprehet: "Institucioni ka mbulim me E-i-Fi". AI nuk disponon sisteme të veçanta informatike për realizimin e procesit mësimor.

Në lidhje me këtë koment GVJ rikonfirmon qëndrimin e mbajtur në draft raport.

5. Për përmbushjen e standartit III.3 kriteri 4, GVJ shprehet se: "Literatura e detyruar është kryesisht cikël leksionesh për shumicën e lëndëve. Gjatë vizitës së GVJ nga drejtuesit na u tha se Institucioni jua siguron tekstet studentëve."

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Pajisja e secilit student me literaturën e detyruar është një detyrim i domosdoshëm kontraktual i AI (ankesi 34) për realizimin e të cilit GVJ ka patur mundësi ta konfirmojë edhe me studentët e programit.

GVJ në konstatimin e bërë është bazuar në pohimet e marra gjatë vizitës në Institucion.

6. Për përmbushjen e standartit III.3 kriteri 5, GVJ shprehet se: "Biblioteka është vënë në funksion në vitin 2019. Nuk ka një listë të librave që disponon. U kërkua gjatë vizitës por nuk u ngarkua në AMS. Referuar RVB faqe 26 dhe asaj që na u tha gjatë vizitës në bibliotekë gjenden kopjet fizike të cikleve të leksioneve por gjatë vizitës në bibliotekë nuk patëm mundësi të shohim ndonjë kopje të ciklit të leksioneve"

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Biblioteka është në funksion prej vitit 2018. Lista e librave u ngarkua në datën 14.11.2019 në sistemin AMS (vizita e GVJ u krye në 7 dhe 8.11.2019 (e enjte, e premte)) pasi u kërkua që të pasurohej me atë pjesë të librarisë online R4L që ka lidhje me programin e studimit. Ky selektim i literaturës nuk ishte i gatshëm dhe kërkon kohën e vet të përgatitjes. Një numër i cikleve të leksioneve të menduara për të qëndruar në bibliotekë (pasi pjesa më e madhe ishte printuar dhe ju ishte shpërndarë studentëve në tetor 2019) ishin në kohën e vizitës së GVJ në fazën e pas printimit dhe për këtë arsye gjendeshin ende në sekretarinë e AI.

Mendimi dhe argumenti i GVJ në lidhje me mospranimin e këtij komenti: Gjatë vizitës në AI na u tha që Biblioteka ka filluar në vitin 2019. GVJ kërkoi një listë të librave të Bibliotekës por nuk u ngarkua në AMS. Theksojmë se që ditën e parë të vizitës, GVJ kërkoi që brenda asaj dite (e enjte dt 7.11.2019) të ngarkoheshin dokumentat. Në lidhje me përgatitjen e listës me pjesën e librarisë Online të lidhur ngushësisht me programin AI pretendon se: "Ky selektim i literaturës nuk ishte i gatshëm dhe kërkon kohën e vet të përgatitjes".

7. Për përmbushjen e standartit III.3 kriteri 6, GVJ shprehet se: "Institucioni ka një kontratë me bibliotekën online Hinari nëpërmjet së cilës studentët dhe stafi akademik mund të kenë akses nëpër revista të ndryshme, kryesisht të karakterit mjekësor. Në lidhje me këtë kontratë, GVJ konstaton se dokumenti nr 11.1 nuk përmban datë dhe afat kontrate."

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: AI ka një kontratë me bibliotekën online Research for Life (R4L) e cila ka 5 kategori sic tregohet në Aneksin 37. Për studentët e programit dhe stafin akademik e ndihmës janë me interes pëveç publikimeve të HINARI edhe ato të kategorive të tjera ARDI, AGORA, OARE dhe GOAL. Kjo kontratë (aneksi 11.1) ka në faqen 5 edhe afatin e përfundimit të saj 31 dhjetor 2025. Në përfundim, bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion të GVJ, situatës aktuale në të cilën ofrohet programi i studimit, kohës së shkurtër të funksionimit të institucionit si Akademi, AI mendon

se GVJ ka të gjithë informacionin e nevojshëm për të rishqyrtuar shkallën e përmbushjes mbi këtëfushë vlerësimi.

Në lidhje me këtë koment GVJ pranon të bëjë ndryshim në draft duke paraqitur afatin e përfundimit të kontratës.

Komente lidhur me fushën IV: BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT.

1. Për përmbushjen e standartit IV.1 kriteri 4, që është kundërshtuar energjikisht nga institucioni, ne jemi shprehur se: “Për vetë historikun e institucionit nuk ka qenë përherë e mundur që të plotësohen kriteret specifike që kërkohen për personelin akademik të këtij program studimi. Nga diskutimi i vëmendshëm i këtij problemi u konkludua se nuk ka qenë për herë e mundur të sigurohen specialistë të fushës përkatëse dhe nënspecialitete që kanë lidhje direkte me këtë program studimi, siç janë specialistët e protetikës dentare. Kjo ka bërë që disa lëndë të specialitetit të jepen nga specialistë të fushave të përafërta si stomatologë të përgjithshëm, mjekë të përgjithshëm dhe disa here specialistë të fushës së Kimisë. Kriteret e përgjithëshme, lidhur me shkallën e kualifikimit të personelit dhe titujt shkencore janë plotësuar më mirë e kjo sidomos për PAK”.

Mendimi I GVJ: Institucioni AI në një koment të gjatë përpiqet të na argumentojë vlerat pedagogjike dhe shkencore të specialistëve të fushës së Kimisë që ka angazhuar në këtë program (Komente f.14). As kush nga ne si GVJ, as me gojë dhe as me shkrim, nuk ka shfaqur rezerva ndaj tyre. Specialistë si zoti Ilo e Altin Melo, Gani Kastrati etj. janë shumë të nderuar në fushat e tyre të studimit dhe kanë mjaft eksperiencë pedagogjike e tituj shkencor në Kimi. Por problemi është se fusha e studimit nuk është për teknologë kimie, por për teknikë dentare. Përpjekjet e mëtejshme se si interferon lënda e Kimisë në këtë program studimi I konsiderojmë të tepërta, pasi si për këtë program ashtu edhe programe të ciklit të dytë në fushë të stomatologjisë, kanë marrë mjaftueshëm njohuri në Kimi gjatë studimeve parauniversitare. Meqë janë përpjekur tëna sjellin përvoja të kompanive të huaja, detyrohem të kujtojmë se asnjë shkollë tjetër e lartë në vendin tonë, bile as ata me te sukseshmit, nuk e kanë një praktikë të tillë. **Në standartin I.1, Kriteri 2. është theksuar se:** “Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare”. Ligji për arsimin e lartëi përcakton qartë kërkesat për krijimin e departamenteve, numrin e antarëve e fushat përkatëse si dhe titujt shkencor që duhet të kenë. Në konsideratën tonë bazuar në ligjin përkatës, në këtë program studimi duhet të dominojnë specialistët e fushës së stomatologjisë, bile mundësisht edhe me nënspecialitete të fushave të mësimdhënjes. **Në këto rrethana vlerësimin e bërë për plotësimin e standartit IV.1, kriteri 4 e konsiderojmë objektiv.**

2. Për përmbushjen e Standardi IV.1, kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimin dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit. GVJ është shprehur se: Për një kohë jo të shkurtër, që ka lidhje me një pezullim të mëparshëm dhe riorganizimin e institucionit, nuk janë bërë rekrutime të reja. Kështu nuk u bë e mundur që të shqyrtojmë ndonjë praktikë konkrete rekrutimi të 2-3 viteve të fundit.

Institucioni paraqet si argumenta se: “Një praktikë konkrete rekrutimi e një PA në Departamentin e Ortodoncisë u vu në dispozicion të GVJ nëpërmjet sistemit AMS, vetëm në datë 19.11.2019”.

Sqarojmë se vizita në institucion ka përfunduar më datën 8 /11/2019 dhe deri më datën 19 /11 kur bëhet fjalë kanë kaluar 11 ditë dhe materiali ishte hartuar, kështu konstatimi i bërë nga ana

jonë është i saktë. Më duhet të theksoj që edhe për disa probleme të tjera u kërkuan dokumenta shtesë që na u tha se ishin të gatëshme, por për këtë ose atë arsye do të na dërgoheshin nëpërmjet sistemit AMS të nesërmen. Kaluan disa ditë dhe këto dokumenta nuk u dërguan, pra ose nuk ishin të gatëshme siç na u tha, ose pati mos korektesë në veprimet e Institucionit. Ne që raportuam shpesh në ASCAL për ecurinë e përgatitjes së materialit, ishim të detyruar të ecnim përpara. Pasi kaluan 24 orët e para, ne nuk e dinim sa duhet të presim akoma, ndaj vazhduam punën. Në këto rrethana, vlerësimi i bërë për këtë standart del i qartë.

3. Për përmbushjen e standartit IV.2 kriteri 4, Institucioni konteston mendimin e shprehur nga ana jonë që është si më poshtë: *"Lidhur me specialitetin e stomatologjisë, pjesmarja e tyre në këtë program studimi, sidomos ajo e specialistëve të ngushtë të fushës së protezave dentare duhet të ishte më e mirë. Sidoqoftë, bashkëveprimi i specialistëve të fushave të ndryshme, kimistë, mjekë të përgjithshëm, stomatologë të përgjithshëm e ka zbutur disi problemin, shoqëruar kjo dhe me përkushtimin e organizatorëve, ka bërë që studentët të ndjehen në rrugën e duhur për realizimin e programit."*(RVJ, f. 26)

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri thekson: Në vendin tonë janë shumë të rrallë mjekët stomatologë me specializim protetikë dentare, që aq më tepër kanë eksperiencë në mësimdhënie, e aq më tepër të jenë specializuar në një fushë të ngushtë të protetikës dentare si proteza dentare e lëvizshme, fikse apo e kombinuar ose e skeletuar. Këto nuk ofrohen si specializime në Shqipëri, por janë shumë të rralla edhe në universitetet perëndimore.

GVJ shpreh mendimin se: Se pari si specialist i fushës së stomatologjisë për mbi 50 vjet dhe specialist në protetikë rreth 40 vjet, që kam hartuar dy programe studimi të arsimit të lartë dhe kam vlerësuar 8 programe të tilla deri më sot, pa patur deri tani asnjë kontestim (gjithmonë ka një herë të parë), më duhet të prononcohem se nuk është kështu. Së pari në vendin tonë ka specialistë të protetikës dentare ose të stomatologjisë me eksperiencë të gjatë në fushën e protezave, pasi kanë ushtruar me dhjetvjeçare këtë specialitet. Së dyti, në vendin tonë ka disa shkolla të larta që përgatisin specialistë për laborant dentar dhe unë kam patur rastin të bëj vlerësimin e tyre, e kam konstatuar se nuk kanë konflikt me kërkesat e ligjit për këtë problem, ndaj dhe janë të suksesshëm e janë akredituar. Institucioni AI, pa dashur ti jap mendje unë, mund të bashkëpunojë me Institucione të tjera brenda vendit, me Institucione të këtij lloji jashtë vendit dhe të bëjë zgjedhje konformë kërkesave të ligjit, ose të presë apo të ofrojë programe të tjera.

Edhe sikur të jetë e vërtetë se nuk ka specialistë në vendin tonë, kjo nuk është shkak për të shkelur ligjin "Për arsimin e lartë..." dhe shumë akte të tjera që lidhen me të. Problemi kërkon zgjidhje e jo justifikime aq më pak fajsimin e të tjerëve .

Sa i perket mendimit se edhe në vendet perëndimore nuk ka specialistë të fushës së protezave dentare dhe preferohet ti reforohet me shumë eksperiencës së huaj se sa asaj të vendit, dua të sqaroj se Stomatologjia është ndarë në specialitete në fillimet e shekullit të kaluar, së pari Ortodoncia (1900) e Kirurgjia stomatologjike dhe me pas protetika dhe degët e tjera të saj dhe ky proces është definuar sic është sot në gjysmën e parë të shekullit të shkuar.

4. Për përmbushjen e standartit IV.3 kriteri 3, GVJ shprehet se: *"Lidhur me sipërfaqet në dispozicion të programit mund të bëhet një objeksion i tillë: Nëse sipërfaqja totale është 676 m², sipërfaqja në funksion të procesit mësimor (labororet, sallat dhe biblioteka) është 282 m². Mbetet që diferenca prej 394 m² të jetë sipërfaqe ndihmëse. Një raport i tillë, ku rreth 60% të sipërfaqes e zënë hapësirat ndihmëse do të ishte më mirë të ishte i inversuar në favor të*

sipërfaqes në funksion të procesit mësimor. Në sipërfaqe ndihmëse ishte llogaritur edhe një hapësirë midis pallateve, me sipërfaqe afro 300 m², për të cilën na u tha se përdoret nga studentët në kohën e lirë dhe për argëtim. Për sipërfaqen në dispozicion të procesit mësimor dhe numrin e studentëve që vijojnë studimet në këtë program, raporti rezulton të jetë 5 m² për një student.”(f.28).

Institucioni AI ka bërë objeksionin e vet. Ai thekson se :

Ambjentet e vëna në dispozicion nga Dorina Mele nuk janë përshkruar me foto dhe përshkrim në aneksin 37, pasi janë në përdorim dhe jo të marra me qera, si pjesa tjetër e ambienteve të AI, por janë llogaritur në shumën prej 676 m² (shiko Marrveshja me Dorina Mele Co, ngarkuar në AMS në datën 12.11.2019).

Sqarojme se: Siç është paraqitur në Raport GVJ nuk ka bërë matje, por kemi marrë të mirqena të dhenat e RVB dhe deklaratimet e institucionit. Të dhëna që thuhet se nuk janë përfshirë në përshkrim dhe as deklaruar me gojë ne nuk kemi patur mundësi ti paraqesim nëdraft RVJ. Në këto rrethana vlerësojmë se analiza jonë lidhur me sipërfaqet e bërë me të dhënat e paraqitura nga Institucioni deri më 8/11/2019, është korekte.

5. Për përmbushjen e standartit IV.3, Lidhur me kete standart ne komente thuhet se jemi shprehur :“*Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit*”. Për këtë arsye Institucioni konkludon se nuk është dakort me GVJ ku jepet vlerësimi se: “*Standardi IV.3 “plotësohet kryesisht”*”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm sqaron se: Së pari nuk jemi shprehur kështu.

Së dyti: Në f.29 të Draft raportit kemi thënë pikërisht kështu:“Në këtë institucion ka infrastrukturë të nevojshme, mjaftueshëm për numrin e studentëve që ka regjistruar dhe që vijojnë në të tre vitet e studimit. Kushti i ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” që përcakton se për Institucionet e tipit Akademi duhet të jenë të përgatitur për të përballuar një numur deri në 300 studentë, momentalisht nuk plotësohet. Mjediset për zhvillimin e praktikave profesionale dhe praktikave e veprimtarive të tjera janë të posaçme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit për këtë kontigjent studentësh që vijojnë aktualisht studimet”.

Ne mendojme se ky interpretim është i qartë dhe i saktë.

6. Për përmbushjen e standartit IV.4 kriteri 1, Institucioni citon dhe konteston thënjen tonë (f.29) të formuluar: “*Biblioteka ka kushte normale dhe orar të aksesueshëm nga studentët. Ka lidhje me internet dhe mundësinë e përdorimit online të një bibliotekë të huaj të fushës së mjekësisë. U kërkua që të aksesohet ndonjë revistë e huaj e profilit të stomatologjisë dhe e fushës së protezave dentare gjë që nuk u arrit të realizohej.*” dhe sjellë argumentin e mëposhtëm
Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri: Shtëpitë publikuese dhe revistat që ofrohen online në kuadër të kontratës me bibliotekën Research for Life (HINARI, AGORA, OARE, ARDI dhe GOAL) janë të specifikuara në kontratë (aneksi 11.1 Librari online ..). Aksesimi i tyre në bibliotekën e AI është gjithnjë i mundur dhe nuk i njohim specifikat e rastit që përmendet nga ekspertët.

Grupi i vlerësimit të jashtëm sqaron përsëri se:

1. U kërkua të aksesohet një revistë e profilit të protetikës dentare dhe kjo nuk u realizua.

2. U kërkua të printohej një listë me titujt e revistave që mund të shfrytëzohen nga studentët në këtë program, por na u tha se ka mbi 1.5 milion tituj revistash mjeksore dhe kjo ishte e pa mundur të bëhej.

3. Me insistimin tonë për të patur vetëm revista të stomatologjisë dhe të protetikës dentare që lidhet me programin e ofruar, na u premtua se një liste e tillë do të përgatitej dhe dërgohej më pas. Ramë dakort, por ajo nuk erdhi kurrë.

7. Për përmbushjen e standartit IV.4 kriteri 2, Në komente citohet RVJ(f.30); "*Aksesi që Akademia ka online në bibliotekën e huaj Hinari i përket fushës së mjekësisë, ndaj dhe u kërkua një listë e revistave të specialitetit të stomatologjisë dhe kryesisht e Protetikës dentare që mund të shfrytëzohen prej saj dhe që ka lidhje direkte me këtë program studimi. Kjo listë GVJ nuk ju vu në dispozicion.*"

Vlerësimi i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri:Lista e kërkuar nga GVJ me revistat dhe librat elektronikë të bibliotekës online R4L që kanë lidhje të ngushta me programin e studimit Teknikë e Lartë Dentare", nuk ishin të gatshme në AI dhe duhej të përgatiteshin. Për arsye edhe të shumë dokumentave të tjera të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në AI, kjo listë u ngarkua në sistemin AMS në datën 18.11.2019.

Mendimi i GVJ: Lidhur me këtë objeksion të Institucionit AI, sapo u spjeguar në pikën 6. Shtojmë se po në këtë standart, kriteri 2 (f.29) kemi paraqitur edhe se: "Literatura hard copy që disponohet në bibliotekën e institucionit është modeste. Nuk patëm rastin të aksesonin tekste bazë apo dhe tekste ndihmës të mjaftueshem në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj". Ne kemi thënë është "modeste" për të mos përdorur fjalën "fare". Për këtë institucioni nuk ka bërë asnjë koment. Pse?

8. Për përmbushjen e standartit IV.6 kriteri 1, Institucioni ka kontestuar paraqitjen e Raportit të VJ për këtë standart (f. 30) ku thuhet: "*Pezullimi i realizuar përkohësisht nga MASR dhe numri i kufizuar i studentëve nuk i kanë dhënë mundësinë e duhur këtij institucioni për të patur burime të mjaftueshme financiare nga të ardhurat që lidhen direkt me aktivitetin e tij. Këtë fakt e kanë njohur hartuesit e RVB dhe e pranoi me sinjeritete vetë Rektori i Akademisë. Ai paraqiti si një nga mundësitë e financimit edhe Kompaninë e njohur Ivoclar Vivadent e cila ka marrëdhënie me këtë institucion, e ndjek dhe mbështet atë dhe ka qënë mbështetja e saj që në krye të herës që ka nxitur hapjen e një shkollë për laborantë dentar që në fillimet e aktivitetit të Kompanisë sonë me sistemin dyvjeçar. Me një veprim të tillë ajo ka patur si synim të promovojë materialet që prodhohen e tregtohen prej saj dhe teknikat e përdorimit të tyre edhe në vendin tonë. Përveç pohimit me gojë të Rektorit, në Institucion nuk ka ndonjë kontratë të rinovuar lidhur me këtë problem.."*

Sqarim i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri: Mbështetja e shoqërisë Ivoclar Vivadent A.G. vazhdon e pandërprerë dhe e fuqizuar tashmë nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Shqipëri Dorina Mele shpk. (Marrveshja me Dorina Mele Co. e ngarkuar në sistemin AMS në datën 12.11.2019).

Grupi që hartoi Draft RVJ plotëson: Në RVB nuk kishte një të dhënë për këtë problem. Më datë 7/11/2019, kur u krye vizita në Institucion patëm këtë përgjigje që kemi dhënë në Raport. Nëse një marrveshje e tillë ishte prezente mund të na ishte vënë në dispozicion. Nëse nuk ishte e gatshme dhe është dashur të hartohet rishtas, në rastin më të mirë mund të thuhet se institucioni nuk ishte i përgatitur për vizitën që do të kryhej aty. Është e pa qartë për GVJ pse duhet të mungonte kjo praktikë, aq më tepër kur Znj. Dorina është edhe pjesë e PAE në këtë Institucion.

Pjesa tjetër për burimet e brendëshme është pa koment, pra konkluzioni i grupit të VJ është i drejtë.

KOMENTE LIDHUR ME FUSHËN V: “STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE”

Për përmbushjen e standartit V.1 Institucioni i referohet Draft Raportit të hartuar prej GVJ (f.38) duke nënvizuar se GVJ ka dhënë vlerësim *“përmbushet kryesisht”*

Sqarim i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: Bazuar në përshkrimin e kritereve 1-6 të standartit V.1, GVJ nuk ka identifikuar ndonjë konstatim ose mosplotësim të tyre. Mendojmë se mund të jetë një gabim teknik në përzgjedhjen e këtij gjykimi dhe në vlerësimin final të rishikohet nga GVJ.

Grupi që ka hartuar Draft RVJ sqaron: Nuk ka asnjë gabim teknik në këtë vlerësim të bërë nga ana jonë. Në Draft RVB, gjatë vizitës në Institucion, sidomos gjatë takimit disa orësh me studentët dolën disa probleme dhe kishte paqartësi. Ne i trajtuam me kujdes ato dhe bëmë sugjerimet tona, plotësisht në dobi të punës së institucionit dhe të ecurisë së programit. Mos shënimi i tyre hollësisht në raport ka të bëjë me filozofinë tonë për të mos konsideruar gjëra që ne i diskutuam dhe ramë dakort se do të zgjidheshin, ca më shumë për të mos errësuar aspak punëne bërë deri tani. Vlerësimi ynështë i tillë se ne si grup i konstatuam ato, është i tillë edhe pse në të drejtën e vlerësimit që ka kushdo ekspert i fushës, GVJ nuk mendon akoma se AI është më miri në Ballkan (sic dikush u shpreh gjatë vizitës) për probleme të veçanta. GVJ tha se AI është në fillim të një rruge që është e gjatë dhe këtë e kemi shkruar edhe në Draft RVJ.

Për përmbushjen e Standardi V.2, me përmbajtje: *“Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program” dhe kritereve nga 1- 5.*

Në komente citohet Raporti i VJ (f.38) ku thuhet se: *“Në RVB është theksuar se: “kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës janë përcaktuar qartë në Rregulloren e Fakultetit të Teknikave Dentare, por programi i studimit Bachelor në “Teknikë e lartë dentare” nuk parashikon punimin e temës së Diplomës nga studentët” (f.48). Duke qenë se në këtë Fakultet ky program studimi është i vetmi program që është ofruar aktualisht, atëhere lind pyetja për kë janë rregullat e qarta në rregullore. Në rregullore është parashikuar se Dekani i Fakultetit përcakton temat e diplomës si dhe udhëheqësit e Diplomave, por RVB thotë se nuk ka tema diplome për këtë program. Nga diskutimi me studentët dhe personelin akademik u konsiderua si më e arsyeshme që për këtë program studimi të ketë një punim praktik diplome dhe pas tij një provim teorik formues.*

Sqarim i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standarti: GVJ ka vlerësuar se standarti V.2 plotësohet pjesërisht kur i vetmi koment i dhënë për të gjitha kriteret është si ai më sipër i cili në fakt nuk përbën konstatim problematik. Statuti dhe Rregullorja e përgjithshme, janë aktet kryesore të menaxhimit dhe funksionimit të akademisë sipas statusit që duhet të ketë në përputhje me LAL 80/2015. Aktualisht AI ofron vetëm një program BSc por në të ardhmen institucioni do të ofrojë edhe programe të ciklit të dytë dhe të tretë të studimit të cilat parashikojnë provim final ose mbrojtje diplome. Referuar komentit të mësipërm, Rregullorja e programit të studimit, neni 11, pika 2 parashikon provim diplome çka i jep përgjigje paqartësisë së GVJ. Nga sa më sipër, mednojmë se shkalla e vlerësimit të standarti V.2 duhet të ndryshojë nga pjesërisht në plotësisht.

Hartuesit e Draft Raportit të VJ plotësojnë: Ky fakt që është cituar, është një nga ato konstatime që dolën në takimin me studentët. Mund të mos konsiderohet problematik, por

studentët nuk ishin fare të qartë për këtë problem, siç edhe për disa probleme të tjera të programit. Ne i kemi referuar ballafaqimit me atë që është shkruar në RVB e rregullore dhe në këtë ballafaqim mendimesh jemi të qartë. Pretendohet se ato që thotë RVB janë për programet e tjera të ciklit të dytë e të tretë që do të hapen në të ardhmen. GVJ ishte për të vlerësuar një program konkret, që është ofruar aktualisht dhe nuk kemi tagër për më shumë. Urojmë sinqerisht të realizohen këto ide, por nuk jemi aq futuristë që të parashikojmë të ardhmen. Konstatimi yne është konkret dhe aktual.

Për përmbushjen e standartit V.4, GVJ ka dhënë vlerësim “*përmbushet pjesërisht*”. Institucioni AI ka bërë këtë objeksion:

Sqarim i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standardi: Bazuar në përshkrimin e kriterëve 1-5 të standartit V.4, GVJ nuk ka identifikuar ndonjë konstatim ose mosplotësim të tyre. Mendojmë se mund të jetë një gabim teknik në përzgjedhjen e këtij gjykimi dhe në vlerësimin final të rishikohet nga GVJ.

Grupi i Draft RVJ sqaron se: Në paraqitjen e materialit me shkrim kemi qënë të kursyer në renditjen e mangësive (edhe pse të tilla ka) për dy arsye: Së pari sepse disa prej tyre u konsumuan gjatë takimeve direkte dhe mendojmë se mund të ndreqen në proces. Se dyti se një material i tillë mbetet i shkruar dhe kemi dashur të jemi sa më të kursyer në kritikën me shkrim. Nëse kjo konsiderohet e metë e punës sonë, sigurisht që mund të korigjohet. Lidhur me vlerësimin tonë nuk ka ndonjë gabim teknik, por ka qasje në vlerësim ndryshe nga Institucioni, që me vetkënaqësi e konsideron vehtën plotësisht të realizuar dhe ka dhënë për vehte vlerësimin maksimal në të gjitha standartet dhe kriteret (Shih RVB f.1-64).

Për përmbushjen e standartit V.5, GVJ ka dhënë vlerësim “*përmbushet pjesërisht*”. Për këtë standart Institucioni AI në Komentet e tij është shprehur:

Sqarim i AI ndaj opinionit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standardi: Bazuar në përshkrimin e kriterëve 1-5 të standartit V.5, GVJ nuk ka identifikuar ndonjë konstatim ose mosplotësim të tyre përveç komentit: “*GVJ mendon se ka vend të diskutohet më shumë midis mundësisë formale të angazhimit të studentëve në realizimin e programit e cila në dokumenta është e pasqyruar dhe mundësisë reale të tyre e cila shpesh ka vend për diskutim. Nëse studentët trajtohen si pjesë e pandarë e plotësimit të këtij programi dhe u hapet horizont e u propozohen varjante gjatë diskutimeve, pjesëmarrja e tyre në to jo vetëm do të jetë aktive, por me përfitime konkrete e frutdhënëse*”, të kriterit 3, konstatim i cili në fakt lidhet me garantimin e përfshirjes së studentëve në jetën akademike të AI. Kjo përfshirje garantohet në të gjitha aktet rregullatorë të institucionit. Nga sa më sipër, mendojmë se GVJ duhet të rishohë gjykimin mbi shkallën e përmbushjes së këtij standardi dhe vlerësimin përfundimtar të fushës 5.

Grupi i hartimit të Draft RVJ sqaron se: Institucioni thekson se: “Kjo përfshirje garantohet në të gjitha aktet rregullatore të institucionit’ dhe kjo është e vërtetë. Prandaj ne kemi thënë midis mundësisë formale (të siguruar në dokumentacion) dhe mundësisë reale (dmth. Të sigurimit të saj në praktikë). Në këto kushte ky vlerësim nuk ka ndonjë kontradiktë. Lidhur me pjesën tjetër të Komentit vlejné argumentat e paraqitura në piken e mëparshme.

KOMENTE LIDHUR ME FUSHËN VI: SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Institucioni AI ka cituar në komentetin e tij një pasazh të RVJ (f.48) ku thuhet:

Për përmbushjen e standartit VI.1 kriteri 2, GVJ shprehet se: "AI në zbatim të kërkesave të ligjit e të udhëzimeve të MASR ka ngritur dhe e ka funksionale atë, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi drejtohet nga E. N. me profesion kimiste. Antarët e saj kanë mandate 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Lëvizjet e paparashikuara të personelit akademik kanë bërë që struktura e saj të ndryshojë në afate më të shkurtra kohore. Në rregullore janë të përcaktuara hapat që duhen ndjekur për SBC, por ka edhe formulime të përgjithëshme si "NJSBC – ja rregullisht fton çdo fakultet dhe çdo department për të zhvilluar kërkime për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë" (neni 7). Kuptohet se janë fraza të shkëputura nga udhëzime e akte nënligjore për këtë problem dhe që nuk janë koherente për këtë institucion që ka vetëm një fakultet. Në RVB (f.55) thuhet se gjatë vitit akademik 2019-2020 akademia do të vlerësojë performancën e personelit akademik në lidhje me zbatimin cilësor të programit të studimit, pra pranohet se është një detyrë që pritet të realizohet. Në NJSBC është i aktivizuar edhe një student i vitit të tretë i cili ka vazhduar studimet me programin e mëparshëm. Nuk u konstatua që në këtë proces të rëndësishëm të jetë aktivizuar ndonjë ekspert i jashtëm siç udhëzimet për këtë problem e parashikojnë."

Objeksione të AI ndaj vlerësimit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri: AI ka ngritur një Komitet të Sigurimit të Cilësisë / Njësi të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në ndihmë të tij funksionon edhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Bashkëpunimeve (shiko Aneksi 18.1 Organigrama dhe personeli.). Dr. Ardita Fuga është kryetare e NJSBC ndërsa MSc. Enida Nushi drejton zyrën e Sigurimit të Cilësisë dhe Bashkëpunimeve. Përbërja e e NJSBC nuk ka ndryshuar që prej vitit 2016 me përjashim të antarit student, i cili gjithashtu është i njëjti që prej 2017. Fakti që ai programi i studimit ka pësuar ndryshime në rreth 10% të tij nuk krijon asnjë vështirësi në gjykimin e studentit mbi cilësinë e realizimit të programit të studimit, dhe nga ana tjetër ekzistenca e studentit nga viti i fundit i studimeve përmirëson aftësinë vlerësuese të tij sepse rrit shkallën e njohjes së programit. Shprehja në faqen 55 të RVB është keqkuptuar pasi aty informohet mbi kryerjen edhe të vlerësimit të performancës të PA në ngritjen e nivelit të kërkimit shkencor të lidhur me programin e studimit në AI. Por vlerësimi i performancës së PA është kryer edhe në vitet 17-18 dhe 18 – 19 sic mund të shihet në anekset 14 dhe 15.

Grupi i hartimit të Draft RVJ sqaron se: Në Ligj dhe në RVB është e përcaktuar kjo strukturë si Njesia e SBC-së, në komente flitet për komitet e zyre të sigurimi të cilësisë, pra përmenden terma të tjerë. Kjo mund të krijojë dhe konfuzion, siç edhe po ndodh. Para ekspertëve të vlerësimit të jashtëm dhe 2 specialistëve të ASCAL-it si personi përgjegjës për sigurimin e cilësisë u paraqit Enida Nushi. Ky fenomen na ka ndodhur më shumë se një herë në Institucion, kur njëherë paraqitej një person, pastaj një tjetër dhe mendimet e tyre nuk ishin të unifikuara. Lidhur me pasazhin që përmendet në f.55 të RVB është thënë shprehimisht kështu: "Gjatë vitit 2019-2020, akademia do të zhvillojë dhe vlerësojë performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik në lidhje me zbatimin cilësor të programit të studimit jo vetëm në aspektin mësimdhënës, por...". Nuk është e qartë se çfarë nuk shkon gjatë vlerësimit tonë në Draft RVJ, kur i kemi referuar pikërisht RVB.

Për përmbushjen e standartit VI.2, Institucioni ka konstatuar si me poshte: GVJ shprehet se: *Në përfundim vlerësohet se në programin "Teknikë e Lartë Dentare të Akademisë IVODENT ky standard "Përmbushet pjesërisht"*

Objeksione të AI ndaj vlerësimit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij standardi: Në vlerësimet e dhëna në të 5 kriteret përpërës të këtij standardi RVJ ekspertët shprehen pozitivisht për përmbushjen e tij bazuar në anekset 14 dhe 15 si edhe në RVB. Është e paqartë nga ana

jonë se si GVJ ka arritur në vlerësimin përfundimtar se standardi VI.2 “përmbushet pjesërisht”. Për këtë arsye mendojmë që ky vlerësim mund të rishikohet.

Grupi i ekspertëve që hartoi Draft RVJ nuk gjeti ndonjë aktivitet specifikisht të lidhur me sigurimin e cilësisë, përveç disa pyetësorëve që u ishin drejtuar studentëve lidhur me performancën e personelit akademik gjatë procesit mësimor gjë që është evidentuar prej nesh në raport. Meqë kërkohen shembuj prej nesh dhe institucioni i mëshon idesë së tij se i ka realizuar të gjitha, po paraqesim vetëm një:

Më datën 8/11/2019 gjatë ditës së dytë të vizitës në Institucion, kaluam nëpër klasat ku zhvillohej praktikëprofesionale. Ishim 3 vetë (2 GVJ dhe një përfaqësues i ASCAL) dhe pyetëm me kë bënëin mësim. Na thanëemrin e pedagogut , por ai mungonte dhe mësimi bëhej me laborantët. Për çudi në të dy klasat na thanë të njëjtin emër pedagogu dhe ai nuk u gjet në asnjërën klasë. Ne e konsumuam gojarisht dhe nuk e paraqitem rastin nëdraft raport. Për këtë kërkojmë ndjesë, por fakti qëndron pikërisht kështu. Nëse institucioni ka dëshirë për argumente, GVJ mund të gjejë edhe ndonjë argument tjetër.

Për përmbushjen e standartit VI.4, kriteri 1,Institucioni AI ka konstatuar :

GVJ shprehet se:*Lidhur me aktivizimin e faktorëve të jashtëm në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm ka përpjekje, por ato janë të rastësishme dhe sporadike. Në aktivitete të ndryshme ku ka pjesëmarrje të aktorëve të interesuar, janë kërkuar dhe janë dhënë mendime lidhur me cilësinë e përgatitjes së kontigjenteve të mëparshme dhe propozime për përmirësimin e saj dhe ka vëmendje për ti kthyer ato në programe pune e realizuar më tej në këtë program studimi.*

Objeksione të AI ndaj vlerësimit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri:Në AI kryhen kontrole të vazhdueshme të cilësisë së përgatitjes së studentëve në lëndë të ndryshme nga lektorë/trajnuet të jashtëm që vihen në dispozicion nga qendrat e edukimit dentar të kompanive Ivoclar Vivadent A.G., BEGO, Renfert, Scheu Dental nëpërmjet marrveshjes së bashkëpunimit me përfaqësuesin tyre në Shqipëri Dorina Mele Co (shiko Marrveshja e bashkëpunimit me Dorina Mele Co , ngarkuar në sistemin AMS në datë 12.11.2019). Gjatë workshopëve që kryhen të paktën 4 herë në vit falas për studentët e AI (shiko aneksin 35.3 Lista e trajnimeve të zhvilluara 2017-2019 AI), lektorët e jashtëm (shiko aneksin 35.4 Lista e stafit lektorëve të huaj&ftuar) kanë mundësinë të vlerësojnë fomimin teorik dhe praktik të studentëve pasi në 2-3 ditë studentët kryejnë një punim protetik të ri në kuadrin e ëorkshop-it. Në përfundim të workshop-it studentët marrin ose jo certifikimin në bazë të cilësisë që ato shfaqin (shiko anekset 35.7, 35.8, 35.9, 35.9.1, 35.9.2). Gjatë workshopit që kryhet me një numër maksimal prej 15 studentësh, lektori/tranuesi ka mundësinë të pyesë dhe të vlerësojë saktë nën këndvështrimin e tij prej profesionisti ekselent, përgatitjen teorike-praktike të studentëve. Mbi bazën e rezultateve të arritura në ëorkshope personeli akademik dhe ndihmës përmirëson punën dhe programin e studimit në bashkëpunim me strukturat e sigurimit të cilësisë në AI.

Grupi i hartimit të Draft RVJsqaron si më poshtë: 1. Së pari kur flasim për aktivizim të faktorëve të jashtëm duhet të kuptojmë fillimisht faktorët e jashtëm vendas. Në vendin tonë ka 5 Institucione të arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi për laborantë dentarë, shumë prej tyre me eksperincë disa vjecare dhe të licensuar sipas ligjit e te suksesshëm në treg. Me to duhet bashkëpunuar, mendojme ne, fuqimisht dhe GVJ nuk gjeti ndonjë të dhënë as në RVB dhe as në komentet e fundit. Kjo sepse janë shkolla të një vendi ku flitet gjuha jonë, kanë sistemin e tyre shkollor dhe fizionominë e arsimit tonë.

2. Së dyti, i mëshohet workshopeve dhe bashkëpunimit me kompanitë e huaja. GVJ nuk e mohon kurrësesi dobinë e tyre. Por, duhet ta pranojmë të vërtetën se këto workshope shpesh janë për promovime materialesh, aparatesh apo metodash pune të reja, më të dobishme për specialistët e sektorit sesa për studentët që janë në fazën e marrjes së njohurive bazë. Këto aktivitete nuk mund të zëvendësojnë as procesin mësimor dhe përmirësimin e cilësisë së tij të studentët, ashtu sic nuk mund të njihen as si specializime të mirëfillta për personelin akademik. Qëllimi i kompanive që i kryejnë këto aktivitete në vendin tonë për ne si specialistë të fushës është i qartë, pa e mohohuar dobinë e tyre, por dhe pa pranuar se ato mund të zëvendësojnë protokollin tona për edukimin e brezit të ri.

Për përmbushjen e standartit VI.4, kriteri 5, GVJ shprehet se: *“Thirrja e ekspertëve të jashtëm për të shqyrtuar programin e studimit, cilësinë e hartimit dhe implementimit të tij sigurisht që është një sfidë. Pa vënë në diskutim aftësitë e dëshirën e askujt për të realizuar me sukses një program studimi, përfshirë edhe këtë program, një ekspert që vjen nga jashtë dhe është i pa mësuar me të metat me të cilat një i brendshëm edhe mund të ambjentohet, do të reagojë më shpejt e efektivisht. Ekspertë të tillë duhet të thirren shpesh, si ata të fushës së profesionit por edhe të fushës pedagogjike, ku institucione të tilla kanë praktikisht vështirësi. Në RVB (f.61), vetë hartuesit e dokumentit janë shprehur se “rekomandohet të ketë ekspertë të jashtëm që ofrojnë informacione dhe orientime përkatëse mbi zhvillimet aktuale të programit, partnerë programi nga institucione me të cilat ka marrveshje bashkëpunimi (nëse ka)”. Pra vetë institucioni e vë në diskutim praninë e marrëveshjeve të tilla me ekspertë të jashtëm dhe në një gjykim të paanshëm kur hartuesit e brendshëm të dokumentit thonë “nëse ka”, çdo lexues i jashtëm e ka të drejtën ta lexojë se “nuk ka”. Pra është një çështje që kërkon të përmirësohet në dobi të cilësisë së këtij programi studimi që Institucioni AI po realizon aktualisht, por dhe një kërkesë që do të vlente për çdo program studimi (Aneksi 16,17).*

Objeksione të AI ndaj vlerësimit të shprehur në RVJ mbi plotësimin e këtij kriteri: Lektorët e ëorkshopeve të kryera të paktën 4 herë në vit pranë AI (shiko Aneksat 35.3 dhe 35.4) janë specialistë shumë të mirë të njohjes së edukimit në profesionin e teknikut dentar pasi marrin pjesë me ëorkshopen e tyre në shumë programe studimi të universiteteve në të gjithë botën dhe në aktivitetet më të rëndësishme të edukimit dentar. Këta ekspertë janë prezent disa herë në vit në AI dhe sjellin kontributin e tyre në përmirësimin e cilësisë së programit në bashkëpunim me NJSBC.. Shprehja në fq. 61 të RVJ: *“rekomandohet të ketë: ekspertë të jashtëm që ofrojnë informacione dhe orientime përkatëse mbi zhvillimet aktuale të programit, partnerë programi nga institucione me të cilat ka marrveshje bashkëpunimi (nëse ka), por që mund të mos kenë një program të tillë studimi, dhe jo të gjitha IAL shqiptare me të cilat ka parasysh vetëm ato institucione partnere me të cilat AI ka marrëveshje bashkëpunimi. Aq më pak të insinuojë se specialistë të tillë nuk ka jashtë AI.*

Pas përfundimit të analizës në përmbajtje të draft RVJ, Grupi i vlerësimit të brendshëm falenderon ekspertët e vlerësimit të jashtëm për evidentimet dhe konstatimet e pasqyruara në raport të cilat do të jenë objekt i veprimtarive në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së programit të studimit.

Grupi i hartimit të Draft RVJ për këtë çështje shton se: Problemi i workshopeve u sqarua në pikën e mëparshme mbi komentet rreth standartit VI.4, kriteri 1. Lidhur me ekspertët e jashtëm kemi parasysh në radhë të parë ata vendas, më pas edhe ata të huaj. Në komentet e tij vetë grupi i vlerësimit të brendshëm ka thënë: “Këta lektorë vihen në dispozicion nga

kompanitë më të mira prodhuese të aparaturave dhe materialeve dentare”. Por këtu jemi duke folur për cilësinë e mësimdhënies dhe jo për aparatura e materiale dentare. **Është jo e pëlqyeshme tendenca për të marrë copëza fjalish nga Draft RVJ dhe për ti nxjerrë nga konteksti e stisur argumenta me qëllimin e vetëm për të paraqitur pa probleme veprimtarinë mësimore të Institucionit.**

Në pjesën e dytë të komentit thuhet : “...ka parasysh vetëm ato institucione partnere me të cilat AI ka marrëveshje bashkëpunimi, por që mund të mos kenë një program të tillë studimi, dhe jo të gjitha IAL shqiptare me të cilat AI ka marrëveshje”. Përsëri e njëjta llogjikë dhe lojë me fjalët, por GVJ këtu nuk flet për të gjitha marrëveshjet, por për një problem konkret që lidhet me programin e studimit.

GVJ shprehet se: Në fund të analizës dhe komenteve që ka paraqitur, grupi i vlerësimit të brendshëm falenderon ekspertët e vlerësimit të jashtëm për evidentimet dhe konstatimet e paraqitura në raport . I pranojmë ato me kënaqësi dhe theksojmë se që nga viti 2014 e deri më sot (përsa kohë ushtrojmë këtë detyrë), kemi marrë në të gjitha ratet e mundëshme, pa kusim të tilla falenderime me gojë e me shkrim dhe pa komente. Sinqerisht i urojmë suksese institucionit AI në punën e tij dhe misionin fisnik që perpiqet të realizojë.

Konkluzione të GVJ:

Pas analizës së imponuar që paraqitëm më lart, pa dyshim që kemi arritur në disa përfundime.

1. Edhe pas përfundimit të përgjigjeve në lidhje me komentet e bëra në Draft RVJ, GVJ akoma e ka të paqartë dhe nuk mori një përgjigje nga drejtuesit kryesorë të njësisë kryesore dhe njësisë bazë se si konsiderohej akreditimi i këtij programi.

2. Institucioni AI në raport me ekspertët e vlerësimit të jashtëm ka mbajtur qëndrim të shumfishtë. Po japim vetëm një shembull dhe nëse ndokush ka interes mund të sjellim disa të tillë. Lista e personelit akademik për vitin 2019-2020 që është paraqitur në RVB, rezultoi me ndryshime gjatë vizites në Institucion dhe ka ndryshime edhe në listën e ngarkuar në sistem dhe ardhur me vonesë tek ne. Bile për të njëjtën gjë, në të njëjtën datë (7/11/2019), burime të ndryshmebrenda institucionit kanë paraqitur të dhëna të ndryshme, nuk kishin qëndrim unik për të njëjtin problem brenda vetë institucionit. Kjo e ka vështirësuar punën tonë dhe cilësinë e procesit

3. Tendanca e vetëkënaqësisë ishte e dukshme. Gjatë dy ditëve që punuam aty, u hasëm me mendime si: “Jemi më të mirët në Ballkan”, “ne krenohemi me këtë”, “kemi surpriza për ju” dhe ndonjë surprizë nuk hasëm. Në komentet që kanë paraqitur është shtuar dhe një tjetër “jemi të parët në Shqipëri” etj.

Tendanca e vetëkënaqësisë është shprehur edhe në RVB ku në të gjitha fushat, në të gjitha standartet dhe kriteret është dhënë vlerësimi “Përmbushet plotësisht”, cka nuk është as reale dhe as etike. Këtë konstatim e kemi paraqitur në raport, por në komente nuk është thënë asnjë fjalë për këtë çështje kaq madhore, por janë komentuar copëza fjalish, nxjerrë nga konteksti.

4. Ka një uri të madhe për vlerësim të shkallës superiore. Kjo i ka harxhuar një kohë të çmuar Institucionit duke u marrë me komente për RVJ, në vend që të ishte marrë me përgatitjen e procesit dhe paraqitjen në nivel më të lartë.

Ne nuk e konsiderojmë veten (dhe punën tonë), as të pa gabueshëm dhe as të pa korigjueshëm. Kemi punuar me seriozitetin e duhur dhe mundësitë e aftësitë që kemi të cilat nuk na i ka kontestuar ndokush deri sot, si me dokumentacionin që na u vu në dispozicion, gjatë vizitës në institucion dhe pastaj gjatë hartimit të Draft Raportit, ku kemi diskutuar cdo detaj e vlerësim. Jemi perpjekur të jemi sa më realë dhe objektivë.

Me konsideratë , Ekspertë të jashtëm :

1. Prof. As. Nazmi Koci; 2. Dr. Elona Kongo

